

KOSOVA: SFIDA E TRANZICIONIT

Raport për Evropë numër 170 – 17 shkurt 2006

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIMET	i
I. SI QËNDROJNË PUNËT	1
A. DERI KU KA ARRITUR PROCESI.....	1
1. Hapësira për manovrim e Ahtisaarit	1
2. Gjetja e thelbit të procesit	2
B. DITARI I NOTAVE I UNMIK-UT: KOSOVA NËN LLUPË	3
1. Standardet	3
2. Sistemi politik	4
3. Ekonomia dhe institucionet	5
4. Policia	6
5. Marrëdhëniet ndër-etnike dhe siguria	8
II. PROTAGONISTËT	12
A. BASHKËSIA NDËRKOMBËTARE	12
1. Si të arrihet deri te zgjidhja.....	12
2. Realizimi në praktikë i marrëveshjes	15
B. SHQIPTARËT E KOSOVËS	20
C. BEOGRADI	23
1. Çfarë statusi?	24
2. Decentralizimi.....	27
3. Prona	29
D. SERBËT NË KOSOVË	30
1. Bërja komunitet	31
2. Kisha Ortodokse në Kosovë	32
III. KONKLUZION	34
SHTOJCAT	
A. HARTË E KOSOVËS.....	35
B. HARTË E VERIUT TË KOSOVËS.....	36
C. PËRMBLEDHJE E SHKURTICAVE DHE E AKRONIMEVE	37

KOSOVA: SFIDA E TRANZICIONIT

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIMET

Çështja kryesore në procesin e përcaktimit të statusit është krijimi i një Kosove që do të ketë gjasat më të mëdha për të pasur stabilitet dhe zhvillim. Ndonëse, teoretikisht, pajtimi mes Beogradit dhe Prishtinës mbetet i dëshirueshëm, vështirë se qeveria serbe do ta pranojë vullnetarisht ndonjë formë të pavarësisë, pa marrë parasysh se sa e kufizuar apo e kushtëzuar të jetë, kusht ky i nevojshëm për të pasur një zgjidhje që do të sjellë stabilitet afatgjatë. Bashkësia ndërkombëtare, e sidomos Emisari Special i OKB-së i angazhuar të udhëheqë procesin e statusit, Martti Ahtisaari, duhet të jenë gati ta imponojnë paketën e pavarësisë së Kosovës, pa marrë parasysh se nga ana diplomatike, mund të jetë i rëndë ky hap, shiquar në një afat të shkurtë, e jo të shpresojnë se do të zhidhen dallimet në mes Prishtinës e Beogradit për një zgjidhje ambiguoze (të paqartë, me shume kuptimësi), apo me një zgjidhje tjetër ku elementet kryesore do të lihen për t'u sqaruar më vonë.

Asnjë nga këto nuk e heq përgjegjësinë e shumicës shqiptare në Kosovë. Këta duhet të ofrojnë një paketë të drejtash për serbët e Kosovës dhe pakicat tjera në së paku tri sfera: përfaqësimin në institucionet qendrore, decentralizimin dhe trashëgiminë fetare e kulturore. Detajet e përfshirjes dhe përfaqësimit në institucionet kryesore qeverise, me aranzhmane për inkudrimin e vendeve amë gjegjëse në sferat siç janë kultura, arsimit e ndoshta edhe sfera tjera, duhet të negociohen jo vetëm me pakicën serbe në Kosovë por edhe me turqit, boshnjakët dhe të tjerët. Një marrëveshje për decentralizimin, që në instancën e parë, do të arrihet nga Ahtisaari dhe ekipi i tij, do të mund të implementohet më pas nën mbiqkyrjen ndërkombëtare në një afat trevjeçar, siç është bërë me Marrëveshjen e Ohrit në Maqedoni. Negociatorët e Prishtinës, poashtu, duhet që menjëherë të fillojnë negociatat e drejtpërdrejta me Kishën Ortodokse Serbe në Kosovë rreth një pakete me aranzhmane (mekanizma) për mbrojtjen e saj dhe pronës së saj. Vetëm kur kjo punë të jetë kryer në terren, Grupi i Kontaktit duhet të tregojë gatishmërinë e vet që të ndëmarrë hapa të bashkërenduar, formal, drejt njohjes së pavarësisë së Kosovës.

Paketa e pavarësisë që bashkësia ndërkombëtare, do ta vendos për Kosovën, duhet ta ketë si prioritet zhvillimin

shoqëror e ekonomik. Përpilimi i këtij plani duhet t'i jep rast Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare të tij, që të shtojnë përkushtimin, përfshirë këtu edhe resurset, ndaj Ballkanit Perendimor në përgjithësi. Një asistencë zemërgjërë për zhvillimin e arsimit, si dhe libelarizimi i vizave janë më se të nevojshme, njësoj si edhe asistenca për zhvillimin rural. BE-ja nuk duhet të përfundojë duke shpenzuar më tepër për misionin e vet që do të vihet në Kosovë pas statusit, se sa për fondet për anëtarësim të vendit të ri.

Edhe pse një rezolutë e re e Këshillit të Sigurimit të OKB-së do të jetë e nevojshme që të vëjë Kosovën në rrugën e pavarësimin nga Serbia, çfarëdo misioni i ri ndërkombëtar që do të vihet këtu do të ishte e dëshirueshme që të bëjë këtë në marrëveshje me shtetin e ri, ndërsa më së miri do të ishte që kjo të përcakohet edhe me kushtetutë. Prezenca ndërkombëtare duhet të ketë më pak fuqi se Përfaqësuesi i Lartë në Bosnjë. Institucionet e BE-së me të drejtë e theksojnë se dëshirojnë të shohin një Kosovë që do të trajtohet gati në të gjitha aspektet si një vend normal, me politikanë që i përgjigjen zgjedhësve të tyre. Por, është një pikë në të cilën bashkësia ndërkombëtare duhet të mendojë të ketë një mision më të angazhuar: Kosova veriore, veçanërisht Mitrovica, ku strukturat paralele serbe e sfidojnë hapur UNMIK-un si edhe qeverinë e përkohshme (IPVQ-në). T'i lihet qeverisë së Kosovës së re që të riintegrojë veriu, do të thotë që të lejohet shpërthimi i dhunës. Një autoritet ndërkombëtar kalimtar i vendosur atje është përgjigjja më e mirë.

REKOMANDIMET

Për ekipin negociator të shqiptarëve të Kosovës:

1. Përpiloni një plan për krijimin e një identiteti shtetëror gjithëpërfshirës, shumë-etnik, për Kosovën, si një mjet me të cilin do të tërhiqni bashkëpunimin e komuniteteve pakicë si dhe të Bashkimit Evropian.
2. Kërkoni mundësitë – si për shembull: publikimi i dokumentit Parimet Themelore të Kishës Ortodokse – që ti përfshini në negociata edhe

serbët e Kosovës, e jo të shfrytëzohet anashkalimi që u bën atyre Beogradi si arsye për pasivitet.

Për ekipin negociator serb:

3. Negocioni:
 - (a) Shkallë më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të serbëve në Kosovë;
 - (b) Më shumë ndihmë zhvillimore për serbët e Kosovës dhe Serbinë; dhe
 - (c) marrëveshje me bashkësinë ndërkombëtare dhe shqiptarët e Kosovës për një spektër të duhur të lidhjeve institucionale mes Serbisë dhe serbëve të Kosovës..
4. Përmbajuni nga retorika senzacionaliste dhe nacionaliste.

Për serbët e Kosovës:

5. Filloni të zhvilloni strukturat nëpërmjet të cilave do të veproni si një komunitet politikisht i vetmjaftueshëm në kuadër të Kosovës së pavarur, si dhe kërkon mbështetje ndërkombëtare për këtë.

Për UNMIK-un:

6. Derisa misioni ec drejt përfundimit të mandatit të tij, mbani – e, edhe më mirë, shtoni – stafin dhe resurset në rajonin e Mitrovicës dhe inkuadroni Grupin e Kontaktit dhe Bashkimin Evropian në planet për një autoritet të ri ndërkombëtar, tranzicional, për Kosovën veriore.

Për Emisarin Special të OKB-së, Martti Ahtisaari:

7. Prezantoni para OKB-së, sa më herët, e jo më vonë, rekomandimin për imponimin e paketës së

pavarësisë së kushtëzuar, nëse shqiptarët e Kosovës në mënyrë të ndërgjegjshme u kanë bërë oferta të mira pakicave, përfshirë këtu pjesëmarrjen në institucionet qendrore, decentralizimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë fetare, në vend se të kërkonin një zgjidhje jo mjaft të qartë, apo një zgjidhje në të cilën elementet kryesore janë lënë pa u prekur me qëllim që Beogradi të mbahet në bord.

Për Grupin e Kontaktit:

8. Përgatituni që të ndikoni në atë se si do të pavarësohet Kosova, duke përfshirë këtu edhe atë se si do të mund të implementohet kjo në rast se Beogradi refuzon të pranojë dhe pasi që shqiptarët të kenë bërë oferta serioze për pakicat, duke i inkuadruar ata që të përfshihen në institucionet qendrore, në çështjen e decentralizimit dhe mbrojtjen e trashëgimisë fetare.
9. Diskutoni dhe bëni plane për një autoritet ndërkombëtar tranzicional në veri të Kosovës.

Për Bashkimin Evropian:

10. Bëni plane për zhvillimin social e ekonomik të Kosovës pas përcaktimit të statusit, me theks të veçantë në arsim dhe liberalizim të vizave si dhe zhvillimin e bujqësisë, e jo vetëm, të miratoni një agjendë të pastër politike e të sigurisë.

Prishtinë/Beograd/Bruksel, 17 shkurt 2006

KOSOVA: SFIDA E TRANZICIONIT

I. SI QËNDROJNË PUNËT

Angazhimi i Prishtinës dhe Beogradit në procesin e menaxhuar nga OKB-ja, që do të përcaktojë statusin e Kosovës është një fillim i mbarë.¹ Por, është vështirë të shihet se si do të arrijnë ndonjë kompromis këto dy palë pasi asnjëra nuk duket e gatshme për këtë. Paraqitja e tyre duket si një “sfilatë bukurie” ku gjashtë vendet e Grupit të Kontaktit² janë juria, dhe nuk është negociim i mirëfilltë, siç shpjegon një zyrtar kosovar.³ Edh epse sponsori i këtij procesi, Grupi i Kontaktit, në nëntor 2005 ka qartësuar se kur të fillojë procesi, ai “nuk mund të bllokohet dhe duhet të përfundojë”,⁴ rezultati megjithatë do të mund të përcaktohej ashtu që njëra palë do të largohet nga tavolina, pa u arritur ndonjë zgjidhje kompromisi. Serbia mund të refuzojë ta pranojë pavarësinë, pa marrë parasysh se në çfarë “pakete” do të ofrohet, të mbajë të drejtën që të ri-okupojë Kosovën “kur të ndërrojnë rrethanat” dhe të kërkoj kompenzim territorial kudo andej që mundet. Shqiptarët e Kosovës mund ta refuzojnë çfarëdo pakete që shtyen pavarësinë dhe të provojnë të marrin vet në dorë sa ma shumë pjesë të provincës duke dëbuar administratorët e OKB-së.

Prioritet i menjëhershëm i bashkësisë ndërkombëtare është që të evitohet ekzodin e ri të serbëve, përlëshjet e reja shqiptaro-serbe apo një valë të re të djegieve të shtëpive e kishave. Pas kësaj i duhet, që së paku, të marrë pajtimin e heshtur të Prishtinës dhe Beogradit

¹ Më 24 tetor 2005, Këshilli i Sigurimit i OKB-së autorizoi Sekretarin e Përgjithshëm që ta emërojë emisar special ish-Kryetarin e Finladës, Martti Ahtisaari, që të fillojë procesin politik për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Formalisht provincë e Serbisë, Kosova është qeverisur nga misioni i OKB-së (UNMIK) që nga qershori 1999, nën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, deri në zgjidhjen përfundimtare. Shumica shqiptare e Kosovës dëshiron pavarësi të cilën Serbia e kundërshton.

² Grupi i Kontaktit, i themeluar më 1994, përbëhet nga vendet kryesore të interesuara për Ballkanin: Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia.

³ Intervistë e Grupit të Krizave me Clarisse Pasztory, këshilltare ndërkombëtare e Ministrisë për qeverisje lokale në qeverinë e Kosovës, Prishtinë, 18 janar 2006.

⁴ Parimet Bazë të Grupit të Kontaktit për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

për një marrëveshje, ashtu që stabiliteti në Ballkan të jetë e qëndrueshme pa intervenim nga jashtë. Asnjë nga aktorët imediatë – shqiptarët e Kosovës, serbët e Kosovës apo Serbia – nuk po ndihmojnë. Serbia dhe shumë serbë të Kosovës në mënyrë implicite bëjnë shantazh, duke kërcënuar me ekzod, nëse Kosova pavarësohet. Si duket, të paaftë që të sigurojnë partneritet të plotë ndërkombëtar, duke krijuar një ambient të sigurtë dhe mikpritës për pakicën serbe, shumica shqiptare e Kosovës lëvizë herë më afër e herë më largë shpalljes unilaterale të pavarësisë.

Përfundimisht, statusi final i Kosovës duhet t’i shërbejë nevojave të vendit për zhvillim shoqëror, ekonomik dhe institucional që, në njëfarë mënyre, janë mbajtur peng për gjashtë vite. Bashkësia ndërkombëtare me të drejtë kërkon pajtimin e Prishtinës e Beogradit rreth elementeve kryesore të marrëveshjes por duhet edhe të krijojë një kornizë të qëndrueshme, në të cilën këto elemente do të zbatohen si dhe të marrë përgjegjësinë për të avokuar pavarësinë e kushtëzuar si rezultatit e vetëm të pranueshëm. Duhet të sigurohet që procesi të mos kthehet në një seri të kërkesave të Serbisë për pagesë dëmshpërblimi si shkëmbim për sovranitetin mbi Kosovën dhe të ndihmojë në krijimin, sa më të shpejtë, të një shteti demokratik e të qëndrueshëm. Modeli i misionit që do të pasojë UNMIK-un, në të cilin institucionet e BE-së do të luajnë rol kryesor, duhet që të bazohet në nevojat reale për zhvillim të Kosovës e jo në kompromisin më të lehtë diplomatik.

A. DERI KU KA ARRITUR PROCESI

1. Hapësira për manovrim e Ahtisaarit

Emisarit special të OKB-së, i emëruar që të negociojë statusin e Kosovës, Maarti Ahtisaari, i është dhënë hapësirë e konsiderueshme për manovrim nga ana e Grupit të Kontaktit.⁵ Ai dhe zëvendësi i tij, Albert Rohan,

⁵ Ahtisaari, i cili ishte Kryesues i Bordit të Grupit Ndërkombëtar të Krizave nga viti 2000 deri më 2005, i kundërshtoi idetë e hershme që t’i caktohen zëvendës nga SHBA-ja, BE-ja, Rusia dhe NATO. Ai mori mbështetje eksplicite nga Grupi i Kontaktit për autonominë e tij si mediator në takimin e 13 dhjetorit 2005, në Paris.

kanë refuzuar caktimin e “afateve artificiale” ndonëse kanë bërë të ditur se procesi mund të zgjasë deri në fund të vitit 2006. Ata kanë selinë në Vjenë, me personel diplomatik prej 40 personave (me kontrata një-vjeçare) dhe do t’i bëjnë bashkë ekipet nga Prishtina dhe Beogradi, për bisedat e para të drejtpërdrejta, më 20 shkurt 2006.

Në tavolinën e Ahtisaarit janë një varg parimesh e përcaktimesh për procesin dhe rezultatin e tij. Nga këto, siç pranon edhe ai vetë, më të rëndësishmet janë (dhjetë) Parimet Bazë të Grupit të Kontaktit, të dakorduara në fillim të nëntorit të vitit 2005. Këto përcaktojnë elementet që duhet të përmbajë dhe promovojë marrëveshja, siç janë stabiliteti rajonal dhe multi-etniciteti “i qëndrueshëm”, si dhe theksojnë se hapat unilateralë dhe dhuna janë të papranueshme.

Edhe pse Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së mandaton procesit për caktimin e statusin, parimet e Rambouillet⁶ që përmend rezoluta si udhërrëfyes për zgjidhjen përfundimtare – vullneti i popullit, mendimet e autoriteteve relevante, angazhimi i secilës palë në implementimin e marrëveshjes dhe Akti Final i Helsinkit – kësaj radhe iu është kushtuar shumë pak vëmendje. Megjithatë, këto parime ende paraqesin një përmbledhje të asaj se me çfarë ka të bëjë procesi. Tri parimet e para të Rambouillet më tepër do të qojnë kah pavarësia e kushtëzuar dhe e mbikqyruar – edhe pse mbetet të shihet se si do të angazhohen në terren secila palë gjatë këtij viti – me pranimin e zgjidhjes nga ana e Serbisë si faktor pëmblyës.

Ardhja e Ahtisaarit në rajon, menjëherë pasi ishte emëruar në nëntor 2005, dha impulsin e duhur për të kompensuar mungesën e një definicioni më të qartë nga ana e Grupit të Kontaktit për atë se kah duhet të shkojë procesi. Ai dhe zëvendësi i tij, i cili e bëri edhe një vizitë tjetër në dhjetor, nxitën Prishtinën dhe Beogradin që të përgatisin dokumente më të detajuara të pozicioneve të tyre. Garancat për pavarësinë u janë dhënë privatisht shqiptarëve të Kosovës me qëllim që këta të inkurajohen të marrin qëndrime më të sinqerta dhe më zemërgjëra. Ahtisaari zgjodhi decentralizimin si temën e parë që do të prekej në fillimin e bisedimeve Prishtinë-Beograd.

Prishtina dhe Beogradi i paraprinë vizitës së Ahtisaarit me rezoluta parlamentare diametralisht të kundërta, që

⁶ Këto parime janë të radhitura në preambulën e draftit të marrëveshjes së negociuar në Rambouillet afër Parisit, në fillim të vitit 1999, gjatë përpjekjeve diplomatike për të evituar luftën në Kosovë. Delegacioni i shqiptarëve të Kosovës nënshkroi këtë draft por jo edhe delegacioni serb. Parimeve në mënyrë eksplicite ju referohet Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

mandatonin respektivisht përjashtonin pavarësinë si zgjidhje. Ekipi i Prishtinës i prezentoj Ahtisaarit edhe një manifest dhjetë-pikësh për shtetin e pavarur e sovran. Në javët që pasuan, secila palë përgatiti dokumentet e veta për çështjen e decentralizimit, ndërsa shqiptarët e Kosovës filluan të punojnë edhe në kushtetutën e re që do të zëvendësonte Kornizën Kushtetuese të UNMIK-ut nga viti 2001, ndërsa Beogradi u përqëndrua në pretendimet e saj pronësore, në asete, miniera e xehe në Kosovë e në të njëjtën kohë duke elaboruar argumentet legale kundër pavarësisë.

2. Gjetja e thelbit të procesit

Dy elemente përbëjnë thelbin e procesit: pazari, që do të thotë se shqiptarët e Kosovës duhet të japin diçka në këmbim të sovranitetit që mban Serbia; dhe formalizimi dhe kompletimi i tranzicionit të Kosovës në vetëqeverisje, që ka filluar që nga viti 1999, nën administrimin e OKB-së. Raporti i të dërguarit të OKB-së Eide, në tetor 2005, për atë nëse Kosova është gati për procesin për statusin final⁷ e nxiti Serbinë që të hyjë në pazar, pasi rekomandonte që komunat me shumicë serbe, të kenë policinë dhe gjyqësinë e tyre si dhe të jenë të lidhura me njëra tjetrën edhe me Beogradin. Këtë, Serbia e pa si një rast që të sigurojë ndarjen e qetë të Kosovës, duke mbajtur një pjesë të territorit dhe duke ua lënë shqiptarëve pjesën tjetër.⁸ Ahtisaari është duke u munduar që të zhvendosë vëmendjen në elementin e dytë, duke i shtyer të dyja palët të shohin rezultatin përfundimtar, si realizim të programit Standardet për Kosovën, që do të garantojë të ardhme për serbët e Kosovës dhe pakicat tjera në një shtet funksional dhe demokratik.⁹ Nëse Beogradi vazhdon të këmbëngulë në kompensim territorial për humbjen e Kosovës, dy elementet e lartpërmendura do të vazhdojnë të bëjnë garë për supremaci. Por, nëse Beogradi luan me letrën e sigurimit të një pozite sa më të avancuar për serbët në Kosovën e pavarur, këto dy elemente do të bëhen komplementare, sidomos pasi një angazhim më i madh për këtë do të detyronte shumicën shqiptare që të jepte garancione më reale e më të mëdha për standardet.

⁷ Raporti dhe rekomandimet e Eide-s - “Vlerësim i përgjithshëm i gjendjes në Kosovë” (S/2005/635, 7 tetor 2005) – përbëjnë bazën e vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Këshillit të Sigurimit, të marrë në tetor 2005, për fillimin e procesit për zgjidhjen e statusit të ardhshëm të Kosovës.

⁸ Ambasadori Eide insiston se kjo nuk është fare pikëpamje e tij dhe se qëllimi i tij ka qenë që komunat të marrin mjaft kompetenca sa të ndihen të qeta nën Prishtinën. Intervistë telefonike e Grupit të Krizave, 14 shkurt 2006.

⁹ Vendimi i Këshillit të Sigurimit që të nisë procesin për statusin e ardhshëm/final vjen pas dy raporteve të diplomatit norvegjez, Kai Eide, përpilimi i të cilëve qe nxitur nga trazirat e përgjakshme të marsit 2004. Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave Numër 155, “Kolapsi në Kosovë”, 22 prill 2004.

Tani për tani duket se Beogradi favorizon kompensimin territorial apo ndoshta pasjen e një kontrolli më të madh mbi territorin në të cilin do të jetojnë serbët.

Ka pikëpamje të ndryshme për atë se si të renditen problemet si edhe për vetë rezultatin e procesit. Privatisht, të gjitha vendet e Grupit të Kontaktit e shohin pavarësinë e kushtëzuar apo të monitoruar si të vetmën zgjidhje të mundshme; Serbia ka mbetur e vetmuar në kundërshtimet e saj. Por këta pajtohen me Serbinë për rendin e bisedimeve. Derisa shqiptarët e Kosovës dëshirojnë që menjëherë të njihet pavarësia e pastaj të sqarohen çështjet më të rënda siç është decentralizimi, bashkësia ndërkombëtare dëshiron që së pari të shohë plane dhe hapa konkretë në çështjen e decentralizimit dhe të akomodimit të pakicës serbe. Serbia poshtu kërkon që së pari të zgjidhen këto çështje, një nga një. Por, derisa bashkësia ndërkombëtare e sheh këtë si hapje e dyerve për pavarësinë e kushtëzuar, Serbia i sheh këto çështje si leva me të cilat do t'ia heqë duart Prishtinës nga disa pjesë të territorit të Kosovës dhe realizimin e kësaj si arritje të zgjidhjes. Duke ia pasur frikën strategjisë serbe, shqiptarët e Kosovës ngurrojnë që të bëjnë koncesione, edhe pse shenjat inkurajuese që po u dërgohen tash së fundi pritet të nxisin reagim më konstruktiv. Përndryshe, mund të hyjmë në një pat-zhikim që do të na kthente në pengesën e pakalueshme të quajtur standardet para statusit.

Procesi nuk duhet të jetë i gjatë sepse derisa zgjat ky proces, në Kosovë nuk do të ketë zhvillim. Ndonëse marrëveshjet për aranzhmane (mekanizma) të qëndrueshme demokratike, nuk duhet as të nxitohen por as të lihen anash për shkak të kërcënimeve implicite me dhunë, është fakt që nëse procesi fillon të zhagitet, do të shtohet edhe mosdurimi i shqiptarëve të Kosovës sikur edhe rreziku që ekstremistët do të shkaktojnë një kollaps sikur ai i parë në trazirat e marsit 2004. Ndërkombëtarët e shohin çerekun e fundit të vitit 2006 si periudhë kur është i mundshëm përfundimi i procesit, me statusin e ri të Kosovës dhe aranzhmanet tjera të fillojnë të vëhen në zbatim në janar 2007.¹⁰

¹⁰ Në nëntor 2005, Ahtisaari në mënyrë simbolike ia ofroi punën e tij cilitdo që do të arrinte rezultate brenda tre apo katër muajve siç pretendonin disa komentatorë. Ai sqaroi se komenti ka qenë më tepër shaka dhe se shpreson se zgjidhja do të mund të arrihej në më pak se 13 vite sa u deshën në Namibi, ku kishte punuar edhe ai. Vendet perëndimore anëtare të Grupit të Kontaktit shprehën dëshirën që zgjidhja të arrihet gjatë vitit 2006. Rusia kundërshtoi vetëm duke thënë se: "Ministrat besojnë se të duhet të bëhen të gjitha përpjekjet që të arrihet një zgjidhje e negociuar gjatë vitit 2006".

B. DITARI I NOTAVE I UNMIK-UT: KOSOVA NËN LLUPË

Ahtisaari e ka filluar punën duke bashkëpunuar ngushtë me UNMIK-un. Duke këmbëngulur se statusi është i lidhur jo vetëm me negociatat por edhe me shpejtësinë e përmbushjes së standardeve, ai i ka dhënë një shtytje kësaj politike të çalë por edhe ka sinjalizuar se institucionet e përkohshme qeverisëse të ngarkuara me përmbushjen e këtyre standardeve do të mbesin kryesisht kështu siq janë; zgjidhja e statusit nuk do të vëjë në pikëpyetje formën e tyre.

Por, sa është bërë që Kosova të mund të qëndrojë në këmbët e veta? Deri në çfarë shkalle, bashkësia ndërkombëtare mund të presë nga qeveria e përkohshme (IPVQ) që të ndërtojë një shtet funksional e jo një shtet që shkon kah dështimi? Mos është duke e lënë bashkësia ndërkombëtare Kosovën përplot me gracka siç është qyteti i ndarë i Mitrovicës?¹¹

1. Standardet

Politika e standardeve, me 109 pikat vepruese, me gjashtë grupet punuese, me vlerësimet rresht-përrresht tremujorëshe, është mjet për ta inkurajuar dhe shtyrë Kosovën drejt qeverisjes funksionale dhe akomodimit ndër-etnik. Por, do të ishte gabim të besohet se kjo politikë mund të arrijë këtë. Programi nuk është mjaft i thellë, i detajizuar dhe efikas, sa të pengojë gërryerjen e institucioneve nga korrupsioni dhe krimi i organizuar; ndërtimi i institucioneve kërkon më shumë se sa lyerja e numrave me ngjyra. Kapacitetet qeverisëse në nivelin qendror dhe në atë lokal mbeten të dobëta, sikur edhe lidhjet mes tyre dhe elektoratit. Poashtu, standardet nuk janë ilaç për mardhëniet në mes të shqiptarëve e serbëve në Kosovë, sidomos kur shumica e serbëve të Kosovës refuzojnë të angazhohen. Përparim real do të ketë vetëm atëherë kur edhe në terren do të ketë vullnet politik që të përvetësohet agjenda e vënë nga jashtë.

Gjatë mbledhjes së informatave për të bërë vlerësimin gjithëpërfshirës të përmbushjes së standardeve për Sekretarin e Përgjithshëm, Kai Eide injoroi zyrtarët e UNMIK-ut e të IPVQ-së të ngarkuar me realizimin e standardeve.¹² Ai më tepër u përqëndrua në aspektin politik. Ai vuri në pah dështimin e politikës që të vëjë bazat e një shoqërie multi-etnike, të mbjellë sundimin e ligjit dhe në rolin e Serbisë në pengimin e implementimit

¹¹ Raporti për Evropë i Grupit të Krizave numër 165, "Zgjidhje për Mitrovicën, jo ndarje për Kosovën", 13 shtator 2005.

¹² Intervista të Grupit të Krizave me zyrtarë të UNMIK-ut dhe IPVQ-së, dhjetor 2005.

duke nxitur bojkotim të pjesërishëm të IPVQ-së nga ana e serbëve të Kosovës.¹³

Me koordinatorët e standareve të IPVQ-së, të demoralizuar për shkak se Eide i anashkaloi ata¹⁴, dhe me qeverinë që angazhohej më pak, pas përfundimit të raportit të Eides, UNMIK-u dhe Ahtisaarit u desh që në dhjetor dhe janar ta shtojnë presionin, që këta përsëri të angazhohen, edhe pse e tërë kjo në të vërtetë ishte një pranim implicit se kjo politikë është e humbur në mes kërkesave për të gjetur shkas për të nisur procesin e statusit dhe mes ndërtimit të institucioneve, përfshirë edhe perspektivën e largët të anëtarësimit në BE.

Një gjë që nuk çmohet shumë në Prishtinë e as në Beograd është se Komisioni Evropian dhe Serbia tanimë e kanë vënë Kosovën në rrugë të veçantë drejtë anëtarësimit në BE. Serbia dhe Mali i Zi janë pajtuar që të negociojnë Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim, pa Kosovën. Kur Komisioni publikoi raportin vjetor për përparimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, në nëntor 2005, janë përpiluar tri dokumente të ndryshme, një për Serbinë, një për Malin e Zi dhe një për Kosovën. Dokumenti për Partneritetin Evropian, i miratuar në dhjetor 2005, i ndan hapat që duhet ndërmarrë në Serbi e Mal të Zi dhe ata në Kosovë në dy kapituj të veçantë.¹⁵

Në gjysmën e parë të vitit 2006, qeveria dhe UNMIK-u do të punojnë së bashku që ti kthejnë standardet në plan veprues për standardet evropiane që do të jenë në përputhje me kërkesat e partneritetit evropian. Takimet e mbajtura në Prishtinë çdo tre muaj me zyrtarët e Komisionit që të dokumentojnë përparimin sipas Mekanizmit për Vlerësimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit (STM), janë duke tërhequr gjithnjë e më shumë, vëmendjen e qeverisë. Nëse qeveria ende nuk është në gjendje që të ndërmarrë iniciativa për shtim të kapaciteve, për vetë rëndësinë që kanë këto, atëherë këtë mund ta nxitë perspektiva evropiane. Një zyrtar i UNMIK-ut shprehet: “Argumentimi se “kjo ju duhet për të ardhmen tuaj” nuk bënë shumë punë këtu. Karrota e BE-së është argumenti shtesë i nevojshëm”.¹⁶

2. Sistemi politik

Disa dyshojnë nëse Kosova ka elitë politike e shoqërore që mund të krijojë dhe zhvillojë një shtet funksional.¹⁷ Demokracia e brendshme e brishtë që haset te partitë politike, së bashku me vendimin e UNMIK-ut për sistemin zgjedhor të aplikueshëm, kanë kufizuar përgjegjësinë e politikanëve para votuesve. Sistemi me lista të mbyllura vetëm sa forcon hierarkitë e partive dhe monopolin mbi të ardhurat qeveritare dhe përfitimet nga këto të ardhura të njerëzve partiakë që veprojnë prapa skenës. Ndoshta rol edhe më të madh në mbajtjen e skenës politike, të ngërthyer në sistemin patron-klient luan dështimi që në gjashtë vitet e fundit Kosova t'i afrohet një ekonomie moderne, duke bërë kështu që të devalvohen idetë dhe politikat. Viti i fundit i UNMIK-ut duhet të shfrytëzohet, që të korrigjohet vendimi i gabuar i cili favorizonte listat e mbyllura, me qëllim që të krijohej pak më tepër hapësirë demokratike, të pengohet thellimi i kleptokracisë si dhe të inkurajohet përfshirja në sistem e gjakut të ri politik, përfshirë edhe grupet relativisht të marginalizuara siç janë gratë dhe rinia.

Profesionistët e paktë që janë në Kosovë, e kanë të vështirë që të mbeten krejtësisht jashtë tërheqjes gravitacionale të fraksionalizmit politik. Stafit lokal në institucionet e UNMIK-ut siç janë Shërbimi Doganor dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm frikësohen se “do t'i hanë ujtit” kur të shkojnë ndërkombëtarët. Gradualisht, sekretarët permanentë të ministrive po zëvendësohen me njerëz lojal ndaj rrejtës të brendshëm të partisë më të madhe, LDK-së. Strukturat e nëntokës dhe zbulimit, që janë karakteristikë e partive më të mëdha, nuk mund të pranojnë që të mbeten jashtë luftës për të kontrolluar institucionet. Përbrenda LDK-së, boshti i formuar rreth shefit të intelegjencës, Ramë Maraj, po fokusohet në konsolidimin e pushtetit përbrenda partisë dhe në ministrinë kryesore, si dhe në mbajtjen e PDK-së larg parave dhe pushtetit, tani që epoka e Presidentit të ndjerë Rugova ka përfunduar. Maraj po përpiqet që si ministër të brendshëm të vëjë një njeri të tij, duke alarmuar PDK-në dhe duke ia “lënë pa bukë”¹⁸ shërbimin e zbulimit, SHIK-un e Kosovës.

Të dy strukturat e zbulimit të partive politike janë “të lira”, nuk i japin llogari askujt dhe nuk janë të gatshme që të tregojnë prej nga marrin fonde.¹⁹ SHIK, që kryesohet

¹³ Shih dokumentin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (në gjuhën angleze) S/2005/635, 7 tetor 2005, në: <http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N05/597/68/PDF/N0559768.pdf?OpenElement>.

¹⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të Zyrës së Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), Prishtinë, 14 dhjetor 2005.

¹⁵ Mund të gjendet në: http://europa.eu.int/comm/enlargement/report_2005/index.htm.

¹⁶ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të shtyllës së BE-së të UNMIK-ut, Prishtinë, 16 dhjetor 2005.

¹⁷ Gazetari nga Kosova që raporton nga Brukseli, Augustin Palokaj, i intervistuar në janar 2006 për filmin dokumentar televiziv të BIRN “Does anyone have a plan?” (“A ka dikush një plan?”)

¹⁸ Bisedë telefonike e Grupit të Krizave me një zyrtar të lartë të SHIK-ut të Kosovës, Prishtinë, dhjetor 2005.

¹⁹ Intervistë e Grupit të Krizave me Ramë Maraj, 16 shtator 2006, dhe Kadri Veseli, 17 nëntor 2005.

nga Kadri Veseli, është rritur së bashku me UÇK-në, duke filluar nga mesi i viteve 90. Qeveria e Përkohshme e liderit të opozitës, Hashim Thaçi, në vitin 1999, i dha zyre në qendër të Prishtinës dhe i gëzohej institucionalizimit të saj të plotë. Megjithatë, ajo mbeti vetëm një organ në hije pasi LDK-ja fitoi të gjitha zgjedhjet që u mbajtën, ndërsa kompetencat për sigurinë i mbetën në duar UNMIK-ut dhe KFOR-it. Ky shërbim ka një staf profesional prej 70 deri 80 personave, kryesisht në Prishtinë, por edhe në disa qytete tjera të Kosovës. Në LDK, Maraj pretendon se legjitimiteti i Institutit për Hulumtime Strategjike dhe të Opinioneve Publik (IHPSO), i regjistruar në UNMIK si OJQ, me seli në Bregun e Diellit në Prishtinë, rrjedh nga lidhjet që ka pasur me “Ministrinë e mbrojtjes” të pafrytshme të “Republikës së Kosovës” në të nëntëdhjetat. Duket se në krye të organizatës ka njerëz relativisht profesionistë, por me një bazë të gjërë e të larmishme të zhvilluar që nga lufta, disa nga të cilët punojnë nëpër autoritetet komunale në komunat e udhëhequra nga LDK-ja. Derisa SHIK-u ia ka dalë që të distancohet sado pak nga PDK-ja dhe kontrolli institucional, IHPSO është ngritur përbrenda LDK-së dhe presidencës që prej vrasjes së Tahir Zemajt, të fortit nga Kosova perendimore, më 2003.²⁰

LDK-së ndoshta do t'i duhet të punojë më shumë tani që ka humbur atraktivitetin gjysmë-religjioz të ikonës Rugova. Thaçi, që ka filluar të profilizojë PDK-në opozitare si parti social-demokratike, parasheh se “tani do të fillojë demokracia në Kosovë... beteja në mes të barabartëve”.²¹ Pas më tepër se një viti në opozitë, PDK ka filluar që të marrë veten nga tronditja që kishte pësuar pas shpërndarjes së koalicionit të gjërë dhe të përqëndrohet në çështjet afatgjate. Pas një fillimi të zhurmshëm, bashkëpunimi qeveri-opozitë në përgatitjet për negociatat për statusin, tani ka zënë vend. Nën udhëheqjen e Rugovës është krijuar ekipi i përbashkët negociues që ka themeluar më pas grupin punues politik. Që nga takimi i hidhur, në fund të tetorit 2005, i grupit negociator, harmonia, përqëndrimi dhe puna janë shtuar gradualisht, për të rezultuar me angazhimin në fillim të vitit 2006 për të detajuar dokumentin për decentralizimin. Procesi tani mund të vazhdojë, pasi me lehtësi është zgjedhur pasuesi i Rugovës, Sejdiu, gjë që duket se ka forcuar strukturën politike të Kosovës.

3. Ekonomia dhe institucionet

Sipas disave, Kosova, që ishte pjesa më e pazhvilluar dhe më e varfër e Jugosllavisë, nuk do të mund të ketë ekonomi të qëndrueshme si shtet i pavarur. Por, alternativa tjera nuk ka. Serbia nuk është në pozitë, dhe as

nuk është e disponuar, që të transferojë kapitalin e saj në Kosovë; në të vërtetë, mes viteve 1989 e 1999 ajo e ka shfrytëzuar sundimin e drejtpërdrejtë mbi këtë territor që të ndërmarrë disa valë të shpronësimit. Papunësia në provincë është rreth 35 %, e cila vetëm sa po shtohet; Prodhimi i përgjithshëm kombëtar (GDP) për kokë banori është më i vogli në rajon, me 1.565 dollarë²²; eksporti mbulon vetëm 4 për qind të importit; shtimi ekonomik është i ngadalshëm dhe nuk ka deflacion. Megjithatë, aktivitetet vendore janë duke kompensuar zvogëlimin e asistencës së përgjithshme nga jashtë; investimet janë në nivel të respektueshëm, në 28 për qind të GDP-së dhe celulat e një ekonomie të vogël, kryesisht në formë të vijave të prodhimit ushqimor dhe ndërtimtar, kanë filluar të zëjnë vendin e importeve dhe shënojnë përparim në krahasim me investimet pa plan të diasporës që, për shembull, e kanë mbushur Kosovën me 1.400 pompa karburantesh që kryesisht shkaktojnë humbje.²³

Natyrisht, janë shumë faktorë që e pengojnë Kosovën, përfshirë këtu edhe indiferencën e menaxhmentit ekonomik të UNMIK-ut dhe mungesën e “personalitetit” legal ndërkombëtar. Kosova ka rezerva të mëdha të linjtit dhe qindra miliona euro janë derdhur në termocentralin e vjetër në gjashtë vitet e fundit, por nuk është ndërtuar një termocentral i ri që do të plotësonte nevojat për energji. Që nga dhjetori 2005, pagesa e faturave të energjisë së shpenzuar është shtuar në mbi 40 për qind duke iu falenderuar politikës së re të KEK-ut që të aplikojë orar të ndryshëm të reduktimit të energjisë për zonat ku pagesa është më e mirë siç është Prishtina (ku rrallë ka ndërprerje të rrymës) dhe zonat me pagesë më të dobët siç janë fshatrat e zemrës së UÇK-së, Drenicës, apo rajonet serbe, që kryesisht refuzojnë të paguajnë (e që gjatë dimrit kanë pasur reduktime gjysmën e ditës apo edhe më tepër). Por, monopolet e shtrenjta çfare janë ndërmarrjet publike KEK-u, PTK-ja dhe Aeroporti të cilat janë një barrë e madhe ekonomike me fuqi të stërngarkuar punëtore dhe me paga tejtet të fryera. UNMIK-u ka krijuar një shërbim civil tepër të madh, me 68.000 të punësuar, të cilëve IPVQ-ja ua ka shtuar edhe 7.000 të tjerë prej kur ka marrë përgjegjësinë për përpilimin e buxhetit, në vitin 2004. Me një popullatë të ngjashme, Sllovenia ka 20.000 shërbyes civilë. Por, në Kosovë, shërbimi civil është pjesë e skemës së sigurimit social. Edhe pse paga mujore mesatare prej 200 Euro është shumë më pak se sa paguajnë ndërmarrjet publike, kjo është shumë më tepër se sa shuma prej 120 Euro që FMN vlerëson të jetë reale krahasuar me nivelin

²⁰ Intervistë e Grupit të Krizave me Ramë Maraj e Genc Kelmendi, 16 shtator 2005.

²¹ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 2 shkurt 2006.

²² Shih faqen për Kosovën të Bankës Botërore në www.worldbank.org.

²³ Efekti anësor i konkurrencës së vogël është se karburantet e shitura në Kosovë rregullisht përzihet me ujë, duke shkatërruar motorët e veturave dhe duke ua ulur efikasitetin e punës.

e të ardhurave të përgjithshme, gjë që pengon edhe shtimin e punësimit në sektorin privat.²⁴

Menaxhimi i buxhetit nga IPVQ-ja është përmirësuar në vitin 2005, ndërsa më 2 nëntor, u ka dërguar donatorëve një letër me të cilën njofton për synimin që të kufizojë shpenzimet në tri vitet e ardhshme. Përkundër kësaj, duket se korrupcioni është duke u shtuar, në të dy nivelet, atë qendror dhe lokal (në komuna). Suspendimet e paradokohshme si dhe ndjekjet penale kundër drejtorëve në komunën e Gjakovës kanë zbuluar keqpërdorime serioze, që sigurisht janë prezente edhe në komunat tjera. Miqësitë duket se i tregojnë qeverisë, se cilët kandidatë janë propozuar për t'u zgjedhur në bordet e reja të ndërmarrjeve publike dhe organet rregullative. "Qëndrimi i tyre është problematik", thotë një zyrtar i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.²⁵ Ndodhë shpesh që ministrat të shfaqin dëshirë që, si në kohën e komunizmit, të kontrollojnë distribuimin e resurseve dhe të shfaqin mosdurim me politikën dhe legjislativën që ka caktuar UNMIK-u. Derisa Ministria e minierave, energjisë dhe mineraleve kërkon që të përvetësojë Komisionin e Pavarur për Minierat dhe Minerat të UNMIK-ut, i themeluar që të mbikqyrë dhënien e licencave, një anëtar i komisionit tërheq vërejtjen: "Nëse kësaj pune do t'i vijë vetëm era përzjerje e Ministrisë, askush nuk do të investojë".²⁶ Gjendjes nuk i ndihmon as paqartësia që mbretëron rreth pronave.

Megjithatë, pengesa më e madhe për zhvillimin ekonomik, mund të dalë të jetë standardi i ulët në arsim dhe izolimi gjeografik. Numri i madh i të rinjve mund të jetë përparësi por vetëm nëse këta kanë arsim të mirë, ndërsa këtu kjo mungon. Të diplomuarit në Universitetin e Prishtinës, nuk janë të përgatitur mirë për punësim dhe nuk janë të kalibrit të duhur për të udhëhequr me institucionet shtetërore. Nuk ka integritet të studentëve shqiptarë e serbë: ekzistojnë dy sisteme paralele. Inovacionet afariste dhe tregu i brendshëm do të mbeten të shkreta nëse nuk do të përmirësohet arsimi. "Ne kemi nevojë për një sistem arsimor që do të krijojë edhe punëdhënës, jo vetëm punëtorë", thotë një përfaqësues i Bankës Botërore.²⁷ Donatorët në përgjithësi, BE-ja në veçanti, duken të padisponuar për të ndihmuar në këtë fushë. Edhe pse përfaqësuesi i Komisionit Evropian në Prishtinë sheh nevojën që të përmirësohet drastikisht liria e lëvizjes së qytetarëve të Kosovës në Evropë dhe që "20.000 studentë të Kosovës të shkojnë në universitetet

evropiane",²⁸ vendet anëtare nuk duken të gatshme që të lehtësojnë marrjen e vizave për qytetarët e Ballkanit Perëndimor.²⁹ Asnjë nga projektet e BE-së për asistencë Kosovës nuk shkon në arsim.³⁰

Një fushë tjetër në të cilën BE-ja do të mund të ndihmonte dukshëm është zhvillimi rural. Pjesa më e madhe e tokës bujqësore në Kosovë nuk shfrytëzohet në mënyrë adekuate. Deri vonë, bujqësia e nivelit të ulët ka punësuar 30 deri 40 për qind të fuqisë punëtore të Kosovës, që është më tepër se sa kudo tjetër në Evropë, përveç Shqipërisë. Shumica e serbëve të Kosovës dhe të kthyerit potencialë janë nga zonat rurale. Qasja e tyre në treg është veçanërisht e kufizuar për shkak të lirisë së kufizuar të lëvizjes.

Në të vërtetë, politikën e BE-së vetëm sa bëjnë dëm në këtë sferë: Kosova ka marrëveshje për tregti të lirë me gati të gjitha vendet e rajonit, që u mundëson bujqëve nga jashtë të që shesin më lehtë prodhimet e tyre në tregun e Kosovës; por, prodhuesit e saj nuk kanë infrastrukturën dhe përvojën që të bëjnë gara me sukses madje edhe në tregun e tyre. Bujqit nga vendet kandidatë për anëtarësim – Rumania, Bullgaria, Kroacia, Turqia e së shpejti edhe Maqedonia – përfitojnë nga ndihma bujqësore të BE-së për vendet që janë para anëtarësimit; Kosova dhe vendet tjera të Ballkanit perëndimor që ende nuk janë kandidatë për anëtarësim kanë më tepër nevojë për këto ndihma por nuk gëzojnë të drejtën t'i marrin ato.³¹ Zyrtarët e Komisionit nuk janë shumë optimistë sa i përket thithjes së donacioneve për Kosovë, kur kihet parasysh buxheti i shtrënguar i BE-së për vitet 2007-2013, e veçanërisht nuk shohin gjasa për hapa në çështjen e vizave, arsimin dhe zhvillimit rural.³²

4. Policia

Edhe pse UNMIK-u mban të rezervuara përgjegjësitë për policinë dhe drejtësinë, në dhjetor 2005, krijoi bërthamat e ministrive të reja, atë të drejtësisë dhe të punëve të brendshme të cilave gradualisht do t'ua delegojë përgjegjësitë. Shërbimi Policor i Kosovës, i ri në moshë, me 7.400 oficerë të trajnuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka marrë mbi vete të

²⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me Marc Auboin, përfaqësues i FMN-së, Prishtinë, 19 dhjetor 2005.

²⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 14 dhjetor 2005.

²⁶ Intervistë telefonike e Grupit të Krizave, Prishtinë, 19 dhjetor 2005.

²⁷ Intervistë e Grupit të Krizave me Kanthan Shankar, Prishtinë, 20 dhjetor 2005.

²⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me Giorgio Mamberto, Prishtinë, 15 dhjetor 2005.

²⁹ Shih raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 168, "Vizat e BE-së dhe Ballkani Perëndimor", 29 nëntor 2005.

³⁰ Një problem që pengon orientimin e asistencës së BE-së kah ky sektor është se institucionet e BE-së kanë pak përvojë dhe pak kompetenca në arsim. E njëjta vlen edhe për sektorin e shëndetësisë, po ashtu shumë pak i zhvilluar në Kosovë.

³¹ Të dhënat nga raporti i Iniciativës Evropiane për Stabilitet, "BE dhe Ballkani Perëndimor: Rugët Përpara", i prezantuar në një seminar në Bruksel më 8 shkurt 2006.

³² Intervista të Grupit të Krizave, Bruksel, 5 janar 2006.

gjitha detyrat e rëndomta nga duart e Policisë së UNMIK-ut që tani ka 2.000 policë, e cila po zvogëlohet gradualisht. Të gjitha stacionet rajonale, përveç në Mitrovicë, dhe të gjitha stacionet nëpër komuna janë vënë nën kontrollin e SHPK-së, ndërsa komisioneri i policisë së UNMIK-ut është duke u përgatitur që para mesit të vitit 2006 të emërojë një oficer të lartë të SHPK-së që do të marrë kontrollin operacional, e që do t'i raportoj atij dhe ministrit të ri të brendshëm.

SHPK-ja bën punë të mirë në kryerjen e detyrave themelore policore dhe mund të jetë forca policore më pak e korruptuar në rajon. Megjithatë, ajo pëson nga niveli i ultë i arsimit dhe mungesa e përvojës. Mungojnë aftësitë profesionale që kërkojnë një dekadë apo më tepër përvojë në detyrë. Femrat përbëjnë 15 për qind të SHPK-së e poashtu edhe jo-shqiptarët (dy të tretat e tyre serbë) përbëjnë 15 për qind të forcës. Oficerët nga komunitet që janë pakica në komuna, tani po dërgohen të shërbejnë në të gjitha stacionet policore komunale. Transferimi i policisë në kontrollin kryesisht shqiptar do të jetë sfidë edhe në kuptim të ruajtjes së standardeve dhe integritetit si dhe të mbajtjes së oficerëve serbë të shërbejnë në kuadër të kësaj force.

UNMIK-u thotë se do të ketë rregulla strikte në kalimin e kontrollit operacional të policisë në duart e Ministrisë së brendshme: "Nëse shohim se ka dominim të një etnie dhe monopol të LDK-së në Ministri, nuk do të ndërmarrim hapin e dytë".³³ Një vlerësim i përgjithshëm nga ana e UNMIK-ut e punës së Ministrisë në emërimin e kuadrove, transparencë, respektim të rregulloreve, sjelljes dhe të ngjashmeve, pritet të fillojë nga muaji mars e tutje. UNMIK-u është duke folur shumë edhe për nevojën që strukturat e zbulimit të partive politike dhe rrjetet e krimit të afërta me qeverinë të shkatërrohen para transferimit të plotë të kompetencave.³⁴ "Kur flasim për krimin e organizuar në Kosovë, atëherë më së shumti kemi të bëjmë me politikanët, (dhe) ministrat", thotë një zyrtar i lartë i Policisë së UNMIK-ut.³⁵

UNMIK-u kishte planifikuar që të shpërbëjë rrjetin rreth presidentit Rugova, i cili kishte fillin në shefin e tij të sigurisë, Ramë Maraj, para se të themelojë ministrinë, por nuk e ka bërë këtë.³⁶ E nxitur nga dosja me ato që pretendohet të jenë fakte, që PDK-ja e ka dorëzuar në muajt mars e prill 2005, UNMIK-u ka ngritur një task force (grup hetues) për të hetuar korrupsionin dhe

krimin e organizuar në nivelin më të lartë të IPVQ-së.³⁷ Duke u dhënë detyra të caktuara hetuesve, shefi i policisë dhe drejtësisë, Jean Dussourd i kërkoi një gazete që ta gjykojnë punën e tij vetëm në bazë të rezultateve dhe atë para fundit të shtatorit 2005³⁸, por arrestimet e pritura të profilit të lartë nuk u materializuan asnjëherë. Derisa në njërin anë komisionari i policisë i përqeshte përpjekjet për të dekretuar rezultatet,³⁹ Dussourd, i frustruar, e zëvendësoi shefin e departamentit të drejtësisë. UNMIK-u tani është i zhytur mes dy zjarreve të papajtueshme: në njërin anë është duke i numëruar ditët kur do të dorëzojë kontrollin mbi SHPK-në në duart e Ministrit të brendshëm që pak a shumë do të zgjidhet nga Maraj, dhe në anën tjetër duke vazhduar të punojë të mbledhë mjaft fakte që të shkatërrojë rrjetin e reketimeve të LDK-së me anë të arrestimeve. "E kemi ditur gjithmonë se do të jetë kështu", vëren një zyrtar i UNMIK-ut nga shtylla e policisë dhe drejtësisë.⁴⁰

Kur SHPK-ja të shohë se kush do të jetë shefi i saj, atëherë do t'i përshtatet atij. Edhe pse UNMIK-u e ka ndarë rolin e ministrisë në politikë-bërje nga komanda operationale mbi policinë, tradita lokale politike e policore do të bëjë që ministria dhe SHPK-ja të kenë marrëdhënie shumë më të afërta. Kolonelët e rangut më të lartë të SHPK-së kanë tendencë që të mendojnë politikisht e taktikisht e jo të kenë mendim strategjik.⁴¹ Policët e ri kanë potencial por kanë nevojë për udhëheqës, mbikëqyrës dhe për kohë që të konsolidohen.⁴² Atyre, në mënyrë të butë, eprorët u bëjnë me dije që të rrinë larg "të mëdhenjve". Njëri nga ata ankohet se hetimet për narkotikë shpesh janë penguar nga njerëz që janë në gjendje të tregojnë kartelat identifikuese të ministrive apo presidencës, e të cilët pengonin kontrollet.⁴³ Ndjenja e nënshtrimit para atyre që kanë pushtet politik vërehet qartë. Në Prishtinë, për shembull, policia nuk heton interesat e dyshimtë afaristë të një zyrtari të lartë komunal e madje edhe e ruajnë shtëpinë në të cilën raportohet se prodhohen CD e DVD pirate.⁴⁴

³³ Intervistë e Grupit të Krizave me Jean Dussourd, shef i shtyllës së UNMIK-ut përgjegjëse për polici dhe drejtësi, 31 gusht 2005.

³⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me PSSP-në Soren Jessen-Petersen, 30 gusht 2005.

³⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 31 gusht 2005.

³⁶ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të policisë e drejtësisë të UNMIK-ut, dhjetor 2005.

³⁷ Kjo është njësia hetuese e vetme që nuk ka oficerë të SHPK-së pasi që Policia e UNMIK-ut konsideron se kjo punë është "tepër e rrezikshme" për ta. Intervistë e Grupit të Krizave me zyrtarë të lartë të Policisë së UNMIK-ut, Prishtinë, 19 dhjetor 2005.

³⁸ "Zëri", 11 gusht 2005.

³⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 19 dhjetor 2005.

⁴⁰ Bisedë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 11 janar 2006.

⁴¹ Intervista të Grupit të Krizave me zyrtarë të Policisë së UNMIK-ut të cilët në dhjetor 2005 vërejtën përparim në planifikimin strategjik në gjysmë e dytë të vitit.

⁴² Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 31 gusht 2005.

⁴³ Intervistë e Grupit të Krizave, 19 korrik 2005.

⁴⁴ E vërtetuar nga Grupi i Krizave. Shtëpia ndodhet afër rezidencës së të ndjerit Presidentit Rugova, në lagjen Velania të Prishtinës dhe, siç raportohet, është e regjistruar si çerdhe fëmijësh. Shih: "Çerdhja e Piratëve", *Express*, 13 shtator 2005.

Tani kur Kosova po i afrohet shtetësisë, sjellja e SHPK-së do të ketë ndikim të madh në zhvillimin e saj politik e shoqëror. Policët janë “mësuesit më të mirë të vlerave shoqërore”.⁴⁵ Nëse SHPK-ja është arbitrare, brutale, mban distancë nga opinioni publik dhe është e afërt me qeverinë e ditës, Kosova nuk do të jetë stabile.⁴⁶

Policia e UNMIK-ut shikon kah BE-ja si padron të ri, pas statusit, që do të mbajë disa nga resurset që ka tani, si dhe disa nga prerogativat.⁴⁷ Edhe pse BE-ja ka bërë të ditur se është e gatshme të ndërmarrë një mision monitorues në sferën e drejtësisë dhe policisë si dhe të jetë mentor i SHPK-së e të marrë kontroll ekzekutiv mbi hetimet në fushën e krimit të organizuar, korrupsion, krimet e luftës dhe krimet e rënda ndër-etnike, si dhe në çështjen e njëjësive të inteligjencës, armëve dhe taktikave speciale (SWAT) e të mbrojtjes së dëshmitarëve,⁴⁸ megjithatë BE-ja kërkon që të përpilojë planin e misionit të saj sipas kushteve të saj, e jo t'i ofrojë çek “blanko” Policisë së UNMIK-ut.⁴⁹

Është me rëndësi që të mendohet dhe matet mirë se deri ku do të shtrihet roli i bashkësisë ndërkombëtare në të ardhmen. Një rol më i madh, duke mbajtur shumicën e pozitive dominante, mund të bëhet burim i pakënaqësisë së shqiptarëve të Kosovës, të pengojë avancimin dhe maturimin e profesionistëve vendas për çështjet e sigurisë dhe të zhysë administratën e përkohshme ndërkombëtare në një aranzhman afatgjatë, neo-kolonialist. Një rol më i vogël, duke mbajtur distancë të tepruar, mund të bëjë që vizioni i një Kosove demokratike, gjithpërfshirëse e multi-etnike të vyshket në duart e vendorëve. Siç qëndrojnë tani punët, UNMIK po ia lë punën e shpërbërjes së strukturave të krimit të organizuar qeverisë dhe rezikon që t'ia lëjë BE-që përgjegjësitë ekzekutive, që ndoshta do të duhet t'i realizojë në një ambient jo edhe aq miqësor (armiqësor).

5. Marrëdhëniet ndër-etnike dhe siguria

Dy të tretat e serbëve që ende jetojnë në Kosovë, jetojnë në rrethe të ndryshme dhe të ndara gjithandej në jug të lumit Ibër, ku dominojnë shqiptarët. Një e treta tjetër jetojnë në trekëndëshin me shumicë serbe që ndodhet mbi lumin Ibër e ku ata kanë fjalën kryesore (dominojnë) në raport me shqiptarët.⁵⁰ Serbët në jug po zhduken nga zonat urbane dhe po mbesin vetëm në fshatrat e largëta apo në komunën malore të Shtërpcës. Ata do të mbeten dominantë në tri komunat në veri të Mitrovicës, ndonëse marrja nga ana e tyre e pjesës veriore të qytetit, pas luftës, mbetet fakt që nuk pranohet nga shqiptarët. Beogradi inkurajon mospranimin e autoritetit të UNMIK-ut dhe IPVQ-së këtu, ndërsa Koordinatorja për Kosovë e qeverisë së Serbisë, Sanda Rashkoviç-Iviç, ka propozuar që kjo pjesë edhe formalisht të bëhet qytet i ri, “Mitrovica Veriore”.⁵¹

Serbët i shohin trazirat e marsit 2004, si përpjekje të organizuar të shqiptarëve për t'i dëbuar ata nga pjesa qendrore e Kosovës dhe gjasat për përsëritje të këtyre ngjarjeve si pjesë përbërëse e kalkulimeve të të gjithë aktorëve në përcaktimin e statusit final.⁵² Shumë shtëpi të rindërtuara u janë shitur shqiptarëve, duke bërë që të shpejtohet procesi i cili që nga viti 1999 ka parë serbët të largohen nga arteriet kryesore dhe zonat e përziera urbane. Shumica e serbëve e kufizojnë lëvizjet e tyre nëpër Kosovë dhe ndihen nën presion që të shpërngulen, qoftë për shkak të dominimit demografik të shqiptarëve, qoftë për shkak të mundësive të pakëta për punësim në ambientin shqiptar, apo për shkak të kërcënimeve dhe dhunës. Megjithatë, 84 për qind prej tyre udhëtojnë rregullisht jashtë vendbanimit të tyre dhe vetëm 10 për qind prej këtyre e bëjnë këtë nën përcjellje.⁵³ Shkalla e krimit ndër-etnik është dukshëm më e lartë në komunat

⁴⁵ Shih: David H. Bayley, *Patterns of Policing: A Comparative International Analysis* (New Brunswick, 1985) (Modelet e Policisë: Analizë Komparative Ndërkombëtare), fq. 197.

⁴⁶ Por, edhe një polici e mirë mund të ndikojë në përmirësimin e karakterit kombëtar. Disa argumentojnë, për shembull, se policia britanike është treguar më e moderuar, me sens të mirë humorit dhe e paanshme pas hyrjes në fuqi të “Politikave të reja” të Robert Peel, më 1829, që qetësuan opinionin publik britanik deri atëherë të dhunshëm e të parregullt. Ibid.

⁴⁷ Intervista të Grupit të Krizave, Prishtinë, gusht dhe dhjetor 2005.

⁴⁸ Shih dokumentin e përbashkët të Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian (Solana-Rehn): “Roli dhe kontributi i ardhshëm i BE-së në Kosovë”, 6 dhjetor 2005.

⁴⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, Bruksel, 5 janar 2006.

⁵⁰ Shih raportin e Grupit të Krizave *Zgjidhje për Mitrovicën, jo ndarje për Kosovën*, op.cit.

⁵¹ Fjalimi në konferencën “Mitrovica 1999-2005, pjesa veriore”, pjesa veriore e Mitrovicës, 23 shtator 2005.

⁵² Për detajet e trazirave të dhunshme që lanë 19 të vdekur, gati 900 të plagosur, mbi 700 shtëpi të serbëve, ashkalinjve e romëve të dëmtuara apo të shkatërruara, diku 10 ndërtesa publike dhe 30 kisha serbe e 2 manastire, dhe përafërsisht 4.500 njerëz të zhvendosur, shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 155 *Kolapsi në Kosovë*, 22 prill 2004.

⁵³ Sipas disa informatave të marrura në dhjetor 2005, UNMIK-u vazhdon anketimet në zonat minoritare. Nga ata që udhëtojnë jashtë zonave të tyre, vetëm 1 për qind thanë se kanë përjetuar krim në gjashtë muajt e fundit të vitit 2005: tre në Mitrovicë dhe dy në Pejë. 62 për qind ndihen të sigurt të udhëtojnë nëpër Kosovë, që është rënie nga 74 për qind sa ishte në nëntor 2005. Proporcionalisht, më shumë respondentë nga rajoni i Prishtinës dhe ai i Gjilanit mendojnë se nuk është e sigurt që të udhëtojnë. Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të UNMIK-ut, dhjetor 2005.

ku pakica përbën më pak se 15 për qind të banorëve.⁵⁴ Sipas anketave, saktësisht gjysma e serbëve theksojnë mungesën e sigurisë publike e personale si brengë kryesore. Deri në shtator 2005, një numër i vogël por gjithnjë në rritje, ishin të gatshëm që të pranojnë se gjendja po përmirësohej. Por, çdo vrasje e re, si vrasja e dy të rinjve serbë derisa po udhëtonin me veturë, në afërsi të Shtërpcës, në fund të gushtit 2005, si dhe incidentet tjera sikur shpërthimi në tregun e Shtërpcës në nëntor 2005, menjëherë largojnë besimin e ndërtaur ngadalë me muaj të tërë.⁵⁵ Edhe pse serbët hyjnë në SHPK, ata shumë pak i besojnë kësaj force. Disa e pranojnë prezencën ndërkombëtare të sigurisë si garantuesin më të mirë që mund të kenë, ndërsa të tjerët dëshirojnë kthimin e forcave serbe apo të drejtën që të kontrollojnë vet forcën policore në zonën e tyre. Duke lënë anash kthimin e forcave serbe të sigurisë, një prezencë afatgjatë ndërkombëtare, ushtarake e civile, për shumicën e serbëve është garantuesi më i mirë i sigurisë dhe i të drejtave të tyre.

Policia e UNMIK-ut këmbëngul se vetëm 15 deri 25 e mesatarisht 60 pretendimeve për krim ndër-etnik, që ndodhin çdo muaj janë të vërteta dhe theksojnë trendin në ulje që ka vazhduar gjatë vitit 2005.⁵⁶ Statistikat zyrtare tregojnë se krimi me motive etnike ka rënë por edhe se krimi i përgjithshëm – të shtënat dhe shpërthimet në veçanti – kanë shënuar rritje të dukshme në vitin 2004 dhe ky trend vazhdon.⁵⁷ Një anketë e pavarur që ka bërë bashkë të dhënat e disa agjencive ka konkluduar se 9 deri 10 për qind e të gjitha krimeve që nga vitit 2002 janë me motive etnike, dhe se përqindja e këtyre krimeve që kanë të bëjnë me pronën dhe vjedhjet është shtuar, duke treguar se oportunitizmi dhe goditja e më të dobët gradualisht kanë zëvendësuar urrejtjen, si motiv.⁵⁸ Fshatarët serbë në Kosovën qendrore dhe atë juglindore ankohen se presioni që t'ua shesin pronën e tyre shqiptarëve shihen nga sulmet me bomba dhe armë të zjarrit, të cilave u nënshtrohen herë pas here.⁵⁹ Rezultatet e frikësimit dhe ngacmimit janë të dukshme: Serbët nuk mund të shkojnë në pronat e tyre dhe punojnë në tokat e tyre, ku disa nga këto prona,

heshturazi janë marrë nga shqiptarët.⁶⁰ Në veri të lumit Ibër, ku ndodh e kundërta, veturat me regjistrim të Kosovës janë të kërcënuara nga sulmet; shqiptarët që guxojnë të kalojnë urën dhe të qarkullojnë në rrugët e pjesës veriore të Mitrovicës rrezikojnë të rrihen dhe maltetrohen dhe janë nën presion që të shesin shtëpitë e tyre, së paku në një lagje.⁶¹

Që ta afrojë policinë më afër pakicave dhe nevojave e tyre, UNMIK ka themeluar nën-stacione të policisë në katërmbëdhjetë enklava gjatë vitit 2005, ku shërbejnë oficerë ndërkombëtarë të cilët në fund duhet të zëvendësohen nga oficerë të komunitetit të enklavës, të jenë plotësisht të integruar në zinxhirin komandues lokal të policisë. Që nga viti 2004, komunat janë inkurajuar që të themelojnë komitetet për siguri. Këto komitete mund të veprojnë që të pengojnë thashethemet destruktive,⁶² por këto rrezikojnë që të lihen anash duke u shikuar si mekanizma që “dinë të të lënë në baltë”. Kur në muajin gusht 2005, në Shtërpcë, vrasja e dy serbëve bëri që të shtohen tensionet, komiteti për emergjencë i komunës “nuk i thirri shqiptarët (në mbledhje) sepse nuk dëshironte që të provokonte një efekt të kundërt në popullatë”.⁶³ Ngjashëm, asnjë komitet nuk funksionon në komunën veriore me popullatë kryesisht serbe, në Zubinpotok⁶⁴ –

⁵⁴ Të dhëna të sistematizuara nga “Collaborative for Development Action” (CDA) (*Aksioni për Bashkëpunim për Zhvillim*) të marra nga burime zyrtare dhe të prezantuara nga Diana Chigas në një seminar në të cilin u shqyrtuan metodat e hulumtimit të procesit të ndërtimit të paqes në Kosovë, Prishtinë, 16-17 nëntor 2005.

⁵⁵ Shih anketat tremujore të UNDP/Rinvest, <http://www.kosovo.undp.org/publications/publications.asp>.

⁵⁶ Intervista të Grupit të Krizave me zyrtarë të lartë, Prishtinë, 19 dhjetor 2005.

⁵⁷ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të UNMIK-ut, dhjetor 2005.

⁵⁸ Të dhënat e sistematizuara nga *Aksioni për Bashkëpunim për Zhvillim*, CDA, op. cit.

⁵⁹ Intervista të Grupit të Krizave, gusht-tetor 2005.

⁶⁰ Në fshatrat e Klinës serbët janë ankuar se ata nuk mund të punojnë tokën e tyre për shkak të frikës nga fqinjët e tyre shqiptarë të cilët i gjuajnë me gurë, ua vjedhin bagëtinë, traktorët dhe makinerinë tjetër. Fshatarët shqiptarë thanë se ata vetëm po e kullotnin bagëtinë në tokën e palëvruar serbe, e as nuk po e punojnë dhe as uzurponjnë atë. CDA op.cit. Në disa vende tjera, kriminelët shqiptarë kanë ndikim të madh. Më 2005, disa vëllezër shqiptarë me një reputacion të tillë, e blenë një motel në një vendbanim me shumicë serbe në juglindje të Kosovës. Njëri nga ta që arrestuar për pjesëmarrje në trazirat e vitit 2004. Serbët lokalë dyshojnë se ata janë të përzier në zhdukjen e një fqinji të tyre serb. Që prej kur e kanë blerë motelin, vëllezërit kanë filluar të bëjnë presion mbi serbët përreth dhe kanë filluar të ndërtojnë në pronën e njërit prej tyre. Intervistë e Grupit të Krizave, tetor 2005.

⁶¹ Raporti i Grupit të Krizave *Zgjidhje për Mitrovicën, jo ndarje për Kosovën*, op. cit.

⁶² Iniciativat e tilla në vendet tjera të botës kanë ndihmuar në uljen e konflikteve ndërmjet komuniteteve. Në qytetin e njohur për trazira, Bhiwandi, në Indi, iniciativa e policisë për të vënë një rrjet të komisioneve hindu-myslimane për ndërtimin e besimit bëri që gjatë dhunës ndër-komunale në Indi mes viteve 1988-1993, në këtë qytet të mos kenë asnjë jetë të humbur. Ashutosh Varshney, *Ethnic Conflict and Civic Life: Hindus and Muslims in India* (New Haven & London, 2002) (*Konflikti Etik dhe Jeta Qytetare: Hindusët dhe Myslimanët në Indi*), fq. 293-297.

⁶³ Intervistë e Grupit të Krizave me Radica Janjicëviq, shef i ekzekutivit në komunën e Shtërpcës, 6 shtator 2005.

⁶⁴ Shih Raportin e Grupit të Krizave *Zgjidhje për Mitrovicën, jo ndarje për Kosovën*, op. cit., fq. 5-6, për të parë një përshkrim të ambientit në të cilin punon policia në komunën veriore me shumicë serbe.

për shkak, siç thonë autoritetet komunale, të krimit ndër-etnik.⁶⁵

Në dhjetor 2005, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), Jessen-Petersen, pranoi se UNMIK-u ka dështuar të bëjë integrimin adekuat të pjesës veriore të Mitrovicës dhe pjesës përtej nën qeverisjen kosovare por propozoi që këtë t'ua lejë të tjerëve ta zgjidhin, në kuadër të negociatave për statusin.⁶⁶

Dhe, edhe pse asnjëra palë nuk dëshiron që ta prishë qetësinë gjatë procesit, Mitrovica mbetet esencialisht jostabile. Dialogu është i paktë, i ngadalshëm dhe i nivelit të ulët, që nuk mund të parandalojë që ky problem të zgjidhet dhunshëm ose që të bëhet plagë që do të pengojë Kosovën e pavarur që të bëhet shtet funksional. Bisedimet janë të kufizuara në nivel rajonal dhe kanë të bëjnë kryesisht me çështjet e furnizimit me ujë dhe me energji elektrike. Këto bisedime kryesohen nga përfaqësuesi rajonal i UNMIK-ut, në të njëjtën kohë kur UNMIK-u është duke zvogëluar personelin dhe po zhvendoset në veri.⁶⁷ Mungesa e sinjaleve apo përgatitjeve qoftë nga Grupi i Kontaktit apo nga BE-ja për një mision tranzitor pas statusit pengon përmirësimin e gjendjes.

Në nëntor 2005, Policia e UNMIK-ut dërgoi një epror të lartë të SHPK-së, serb i Kosovës, dhe një hetues rus nga Prishtina që të “pengojnë eskalimin” në Shtërpcë⁶⁸ që po rrezikonte të bëhej Mitrovicë veriore e dytë, këtë herë në jug të Kosovës. Të shtënat dhe shpërthimet që nga gushti 2005 kanë ngritur tensionet atje. Derisa Prishtina dyshon se në këtë ka gisht Beogradi, ndërsa shumica e serbëve të Shtërpcës janë të bindur se dhuna zbulon qëllimin e shqiptarëve që t'i dëbojnë të gjithë kur Kosova të bëhet e pavarur. Ata frikësohen se shqiptarët do ti heqin autonominë lokale, do ti marrin institucionet komunale dhe do ti shfrytëzojnë ato që të promovojnë blerjen e tokës dhe pronës nga shqiptarët. Serbët e Shtërpcës i rezistojnë sidomos sub-ordinimit të qendrës rajonale fqinje të dominuar nga shqiptarët, Ferizajit, dhe kërkojnë që të hiqet Njësia Mbështetëse Operacionale Rajonale e SHPK-së e themeluar pas vrasjeve të gushtit.⁶⁹ Aparati i sigurisë në këtë komunë

është arna-arna. Kryetari i komunës ka lidhje të afërta me të vetëshpallurin udhëheqës i Lëvizjes së rezistencës së armatosur serbe; shefi i policisë është nga Gjilani për të cilin thuhet se pothuajse çdo ditë, në orën 3 pas dite, udhëton 50 kilometra për në shtëpi dhe i cili nuk gëzon shumë besim tek banorët lokalë; thuhet se kryetari i komunës ka kërcënuar se do të “djegë stacionin e policisë” nëse ndodhë edhe një incident; ndërsa kontingjenti ukrainas i KFOR-it është jokomunikativ, duke e lënë komandantin amerikan të Brigadës Shumëkombëshe Lindje të keqinformuar për situatën.⁷⁰

SHPK-ja mund të ballafaqohet me presion edhe më të madh ndër-etnik gjatë vitit 2006, gjatë procesit për statusin. Në shtator 2005, koordinatorja e Serbisë për Kosovën u ka thënë serbëve të Graçanicës që të lëshojnë SHPK-në dhe institucionet qeverisëse të Kosovës.⁷¹ Në nëntor, në Shtërpcë dhe veri të Mitrovicës ka pasur manifestime armiqësore kundër njërive të SHPK-së që dominohet nga shqiptarët.⁷² Dy javë pasi një serb ishte emëruar që të udhëheqë një prej gjashtë komandave rajonale të SHPK-s, ai është plagosur në jug të Kosovës, më 28 shtator 2005.⁷³ Për këtë mund të jenë përgjegjës edhe serbët edhe shqiptarët që nuk dëshirojnë të shohin një serb në postet udhëheqëse në SHPK. Si reagim, serbë të zemëruar u tubuan para stacionit policor në Shtërpcë duke kërcënuar që të hyjnë me dhunë brenda dhe të sulmojnë oficerët shqiptarë të cilët mbroheshim nga kolegët e tyre serbë.⁷⁴ Një turmë tjetër e zemëruar është tubuar para stacionit, më 13 shkurt 2006, të udhëhequr nga një fshatar serb i liruar një ditë më parë e i cili kishte pasur një përleshje me një oficer të SHPK-së. Të shqetësuar për shkak të dominimit shqiptar, oficerët nga pakica serbe e komunës së Lipjanit qenë kërcënuar që pasivisht do të japin dorëheqje kur stacioni të kalojnë nën kontrollin e SHPK-së, derisa nuk morën garanci të

⁶⁵ Intervistë e Grupit të Krizave me zyrtarë të Policisë së UNMIK-ut dhe të drejtësisë, 12 dhjetor 2005.

⁶⁶ Konferencë për gazetarë, 21 nëntor 2005.

⁶⁷ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të UNMIK-ut në Mitrovicë, 3 shkurt 2006.

⁶⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me komisionarin e Policisë së UNMIK-ut, Kai Vittrup, Prishtinë, 20 dhjetor 2005.

⁶⁹ Intervistë e Grupit të Krizave në Shtërpcë, më 24 e 29 nëntor 2005. Së pari e vendosur në rrugët kryesore dhe në zonat e banuara me shqiptarë, njësia filloi të operojë edhe në, dhe rreth fshatrave serbe, në tetor 2005, duke pranuar shumë ankesa se po e frikësojnë popullatën. Njësia përbëhet krejtësisht nga shqiptarët pasi që serbët nuk pranojnë të zënë vendet e ndara për

ta, duke mos dashur të punojnë në ambient shqiptar çfarë është ai në Ferizaj. Si ilustrim për mungesën e komunikimit adekuat, serbët e Shtërpcës e keq-emëruan atë në njësia speciale “rose” (e kuqe), duke e krahasuar me forcat paramilitare të para në Ballkan si “Tigrat” apo “Luanët”.

⁷⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, Shtërpcë, 24 e 29 nëntor 2005.

⁷¹ “Rashkoviç-Iviç paralajmëron ndërrime në politikën e Qendrës Koordinuese të Kosovës”, agjencia e lajmeve “VIP”, 23 shtator 2005.

⁷² Një mini-trazirë shpërtheu në veri të Mitrovicës pasi një njësi speciale nga pjesa jugore e arrestoi një të dyshuar për trafikim narkotikësh në rrugën Mbretin Peter.

⁷³ Një organizatë paramilitare serbe, deri atëherë e panjohur, e sigurisht imagjinare, morri përgjegjësinë për pritën e organizuar mirë, e ekzekutuar me AK-47 në një pikë mbi rrugë, afër një fshati shqiptar.

⁷⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar ndërkombëtar në Gjilan, 20 tetor 2005. Disa oficerë serbë ishin gati t'i bashkoheshin turmës.

mjaftueshme nga monitoruesi kryesor, policia e UNMIK-ut.⁷⁵

Në vitin 2005, UNMIK-u ka filluar Shqyrtimin e Sektorit të Sigurisë së Brendshme (i njohur sipas akronimit në gjuhën angleze, ISSR – Internal Security Sector Review) që ka për qëllim të themelojë institucione të qëndrueshme, demokratike, të sigurisë që do të shërbejnë në Kosovën multi-etnike të pas-statusit. Metodologjia është zhvilluar dhe përdorur që nga fillimi i viteve 90 nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar për të ri-dizajnuar sektorin e sigurisë të vendeve, kryesisht afrikane, nëpërmjet konsultimeve me qytetarët dhe grupet tjera të interesuara.⁷⁶ Një nga ata përgjegjës thotë: “Presim që propozimet që po dalin nga shqyrtimi i sigurisë së brendshme të shtrohen para atyre që bisedojnë për statusin final”.⁷⁷

Por, UNMIK-u ka pasur probleme që të fillojë punën e ISSR-it. Është dashur të fillojë një apo dy vite më parë, ndërsa vendimet për ministrinë e brendshme dhe për strukturën e policisë janë duke u implementuar të parat. Edhe pse ka marrë bekimin e Sekretariatit të OKB-së në mesin e vitit 2005, i ka munguar përkrahja nga nivelet e larta të Këshillit të Sigurimit, Grupit të Kontaktit dhe NATO-s. Gjetja e fondeve për sekretariatit e ISSR-së ka qenë e vështirë. Iniciatorët e saj trimërohen me konsultimet e para që duket se kanë filluar të nxisin një mënyrë të re të menduarit: “Disa kanë filluar të vënë lidhje mes sistemit zgjedhor me lista të mbyllura me lojalitetet e policisë dhe me rrezikun që të mos ndihen përgjegjës para opinionit publik; pra, të mendojnë se sistemi zgjedhor aktual do të sjellë probleme të sigurisë”.⁷⁸ Por, përkrahja e vogël brenda vendit është pasqyrë e mungesës së përkrahjes ndërkombëtare. Siq ka mundur të merret me mend, përfaqësuesit politikë e religjiozë të serbëve të Kosovës nuk kanë zënë vendet e

tyre në komitetin drejtues të ISSR-së, por këtë nuk e kanë bërë as partitë opozitare të shqiptarëve të Kosovës.

Shqiptarët dhe serbët ende pretendojnë se Kosova është e tyre. Derisa nuk vendoset statusi final, ndarja etnike do të mbetet tepër e thellë që të mundësojë hapa të vendosur, gjithëpërfshirës, drejt ndërtimit të shtetit. Se çfarë do të bëjnë serbët e Kosovës kur ajo të bëhet e pavarur – do të rirreshtohen, do të ikin apo do të bëjnë rezistencë në veri – kjo mbetet të shihet. Nëse vendimi ua mundëson serbëve në veri dhe Serbisë që të refuzojnë të pranojnë autoritetin e Prishtinës dhe nëse nuk vë një autoritet ndërkombëtar tranzitor në veri të lumit Ibër, Kosova do të përballlet me një të ardhme jostabile. Qëndrimi dhe politika e Beogradit ndaj Kosovës së pas-statusit do të jenë esenciale qoftë për lejimin e krijimit të një qeverisje funksionale qoftë edhe për vënien e një pengese të madhe në rrugën përpara.

⁷⁵ Intervistë e Grupit të Krizave me një oficer të policisë së UNMIK-ut, 12 tetor 2005.

⁷⁶ Të tetë hapat, të menduar të shtrihen në një periudhë kohore prej një viti, janë: 1) shqyrtimi i ambientit strategjik në Kosovë; 2) identifikimi i kërcënimeve për sigurinë në Kosovë; 3) disajnimi i një rrjeti të institucioneve të sigurisë; 4) disajnimi i institucioneve individuale të sigurisë; 5) “analizimi i nevojave” për të përcaktuar se sa punë zhvillimore është e nevojshme për të transformuar institucionet e sigurisë; 6) përpilimi i strategjive për të arritur këto transformime; 7) llogaritja e resurseve të nevojshme për arkitekturën e re të sigurisë; 8) implementimi i strategjive pasi të jenë siguruar konsensusi dhe mbështetja e donatorëve.

⁷⁷ Rod Evans, anëtar i Ekspicit Këshillëdhënës Britanik për Zhvillimin e Sektorit të Sigurisë, dhe Iain Smailes, shef i Njësisë Këshillëdhënëse për Siguri të UNMIK-ut, konferencë për gazetarë, Prishtinë, 15 korrik 2005.

⁷⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me Iain Smailes, Prishtinë, 6 dhjetor 2005.

II. PROTAGONISTËT

Vendimi për statusin final do të jetë përpjekje që të krijohet një Kosovë që do të kënaqë dëshirat e të tre protagonistëve kryesorë – Prishtinës, Beogradit dhe bashkësisë ndërkombëtare. Por, Prishtina është ajo që ka fjalën kryesore. Ajo kërkon pavarësi për shumicën dërmuese shqiptare. Ka, gjithashtu mjaft të vërtetë në atë që thotë Beogradi se komunitetet tjera të Kosovës nuk janë asgjë më tepër se dekor në atë që do të jetë shteti i dytë shqiptar. Sidoqoftë, bashkësia ndërkombëtare kërkon multi-etnicitet të qëndrueshëm, në dukje dhe në përmbajtje. Ndryshe, arsyetimi për ruajtjen e kufijve ekzistues, me territoret e banuara me serbë, nuk do të mund të qëndroj. Në imponimin e agjendës së vet, bashkësia ndërkombëtare mezi ka gjetur format e pranuar të multi-etnicitetit, qoftë nëpërmjet standardeve apo decentralizimit, përballë ngurtësisë, ambicies dhe pasigurisë së shqiptarëve të Kosovës.

Prishtina dhe Beogradi mbesin të shurdhër ndaj këtyre thirrjeve. Shqiptarët ende përtacë, supozojnë se punët do të kryhen vetë dhe se në fund Amerika do t'i shpëtojë nga përgatitjet e pamjaftueshme. Serbia refuzon ta pranojë fjalën që fillon me "P", duke këmbëngulur në argumentet legaliste dhe duke shpresuar të shpëtojë diçka me anë të ndarjes, duke mos pranuar se trajtimi i tmerrshëm që u ka bërë shqiptarëve gjatë viteve 90-ta ka bërë që ta humbë Kosovën.⁷⁹

A. BASHKËSIA NDËRKOMBËTARE

Në fillim, bashkësia ndërkombëtare kishte zgjedhur që të garantojë multi-etnicitetin duke shtyrë IPVQ-në dhe shoqërinë shqiptare që t'i përmbahen një programi të standardeve demokratike. Edhe pse shqiptarët në fillim e shihnin procesin e standardeve si pengesë për aspiratat e tyre, shumë serbë e kritikuan këtë politikë si diçka që u mundësonte shqiptarëve që të vënë një fasadë multi-etnike që shumë shpejt mund të hiqej pas pavarësisë.⁸⁰ Trazirat e marsit 2004, bënë që të humbet besimi i bashkësisë ndërkombëtare se shqiptarët ishin të përkushtuar që të ndërtonin një shoqëri tolerante. Këshilli i Sigurimit dhe Grupi i Kontaktit u përgjigjen me kërkesat për decentralizim dhe delegim të pushtetit te komuniteti serb, sinjal ky i humbjes së besimit në

institucionet qendrore të IPVQ-së. Dy vite më pas, bashkësia ndërkombëtare ende nuk e ka tërhequr vijën mes ndërtimit të qeverisjes qendrore nëpërmjet standardeve dhe mbrojtjes së komuniteteve pakicë nëpërmjet decentralizimit. Numri i komunave të reja me shumicë serbe, niveli i kompetencave që do të kenë dhe lidhjet e tyre me Beogradin mbeten ende të vendosen.

Grupi i aktorëve që janë përgjegjës kryesorë për arritjen e zgjidhjes, përkundër disa ngjashmëri, dallon prej grupit të aktorëve që do të mbajë barrën kryesore të marrjes me Kosovën pas përcaktimit të statusit. Sekretariati i OKB-së, SHBA-ja dhe Rusia do të kenë rol të rëndësishëm në arritjen e zgjidhjes, implementimin e të cilës sipas të gjitha gjasave do ta bëjë BE-ja dhe vendet e saj anëtare. Mbetet esenciale që procesi i zgjidhjes së statusit t'ia bëjë të mundur popullit të Kosovës që të japë pëlqimin e vetë për rezultatin, e jo që këta të mbeten pranues pasiv të një rezolute të re të Këshillit të Sigurimit.

1. Si të arrihet deri te zgjidhja

Grupi i Kontaktit "po e merr shtruar dhe me qetësi"⁸¹ gjetjen e zgjidhjes për Kosovën dhe është pozicionuar mirë, aq sa mund të shpresohet të bëhet kjo, për atë që do të sjellin muajt në vijim. Këshilli i Sigurimit i OKB-së si dhe Sekretariati i OKB-së kanë luajtur rol konstruktiv. I pari ka mandatuar fillimin e procesit dhe ka miratuar Parimet Bazë të Grupit të Kontaktit, ku Rusia ka qenë pjesëmarrëse aktive ndërsa Kina nuk ka treguar interes në pengimin e procesit. Emërimet me radhë të skandinavëve nga ana e Sekretariatit, së pari e Jessen-Petersenit si shef i UNMIK-ut, pastaj e Eides si i dërguar për vlerësimin e standardeve, dhe së fundi Ahtisaarit si i dërguar për ndërmjetësim, kanë kontribuar që procesi të fillojë mbarë.

Prapa skene, të gjitha vendet e Grupit të Kontaktit tani pajtohen se pavarësia e kushtëzuar është i vetmi rezultat i mundshëm. Në mbledhjen e mbajtur në dhjetor 2005, në Paris, "tabuja rreth rezultatit që rrezuar krejtësisht... të gjithë flisnin për pavarësinë, edhe para syve të rusëve. E këta nuk kundërshtonin".⁸² Në të vërtetë, që nga tetori, Rusia ka dhënë shenja se do të pranojë pavarësinë e kushtëzuar.⁸³ Konkludimi dymendjesh (ngurrues) i Italisë, se kjo është zgjidhja e vetme reale, ka ndihmuar që të bindet edhe Franca, vendi tjetër më i rezervuar ndër anëtarët e Grupit të Kontaktit.⁸⁴

Tani diskutohet për atë se nëse dhe kur duhet të bëhet publik qëndrimi i Grupit të Kontaktit për zgjidhjen. Disa

⁷⁹ Grupi i Kontaktit ia tha qartë këtë Beogradit, në deklaratën e 31 dhjetorit 2006: "Politikat shkatërrimtare të së kaluarës janë në thelb të problemeve të tashme".

⁸⁰ Politikani serb i Kosovës, Dragisha Kërstoviq, frikohet se "mund të përfundojmë me një territor që në dukje është multi-etnik, por që është vënë në rrugë drejt zhdukjes së serbëve". Intervistë e Grupit të Krizave, Leposaviq, 23 qershor 2005.

⁸¹ Intervistë e Grupit të Krizave me një diplomat britanik, Londër, 10 janar 2006.

⁸² Intervistë e Grupit të Krizave, Paris, 6 janar 2006.

⁸³ Intervistë e Grupit të Krizave, Moskë, 13 tetor 2005.

⁸⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, Paris, 6 janar 2006.

ndihen të ngjuar në një labirinth: “Nëse themi që në fillim se Kosova do të jetë e pavarur, Serbia mund të largohet nga procesi... (por) nëse Grupi i Kontaktit vazhdon të thotë se të gjitha opcionet janë ende në tavolinë, Prishtina nuk do të bëjë koncesione. E tërë kjo është mjaft dekurajuese”.⁸⁵ Në anën tjetër, Mbretëria e Bashkuar është në favor të qartësisë të hershëm të kësaj çështje ashtu që vëmendja të përqendrohet në vet procesin.⁸⁶ Por, jo të gjithë pajtohen me teorinë e MB-së se shqiptarët do të jenë më zemërgjërë në dhënien e koncesioneve, nëse ata janë të sigurtë që caku i fundit është pavarësia. Disa thonë se, përkundrazi, ata nuk do të ndiejnë më nevojë që të ofrojnë diç më shumë në çështjen e decentralizimit apo në aranzhmanet tjera për akomodimin e pakicave në kuadër të institucioneve qendrore. Për më tepër, një paralajmërim i pavarësisë që në fillim, mund të sillte më shumë se sa vetëm zemërgjërësinë e shqiptarëve pasi serbët, në panik, do të ndërmerren, për shembull, eksod masiv.

Vendet e Grupit të Kontaktit, tradicionalisht më të afërta me Serbinë, duhet të luajnë rolin e tyre në bindjen e liderëve të saj, që të kuptojnë se duhet ta shfrytëzojnë procesin që ta përmirësojnë gjendjen e serbëve të Kosovës e jo të mundohen të rimarrin një territor, që de facto e kanë humbur. Franca ka marrë hapin e parë pasi kah fundi i vitit 2005, privatisht u ka thënë se nuk do të përkrahë argumentet e tyre legaliste kundër pavarësisë dhe se ata duhet të pranojnë realitetin.⁸⁷ Edhe Rusia raportohet t’ia ketë bërë me dije Beogradit se nuk do të vëjë veto në rezolutën e re të Këshillit të Sigurimit që do të trasonte rrugën për pavarësinë që paraqet rezultatin përfundimtar të procesit.⁸⁸

Disa vende të vogla, që nuk janë të angazhuara drejtpërdrejtë, siç është Zvicra, që nga mesi i vitit 2005 filloi publikisht të shprehen në favor të pavarësisë të Kosovës, ndërsa anëtarët e Grupit të Kontaktit vetëm sa i afroshin gjithnjë e më shumë këtij qëndrimi. Kah fundi i muajit dhjetor 2005, ministri i jashtëm i Italisë, Fini, i ka deklaruar televizionit serb BK-TV se pavarësia e kushtëzuar do të jetë tema kryesore e bisedimeve. Në

janar 2006 ai shkroi se “statusi i Kosovës mund të gjindej si një formë e pavarësisë së kushtëzuar në kuadër të garancave evropiane, derisa pret integrimin në institucionet e BE-së”.⁸⁹ Mesazhi i MB-së, se pavarësia është opcioni i vetëm real bëri bujë më të madhe se sa kishte për qëllim, pasi në shkurt 2006 serbët e Kosovës dhe zyrtarë qeveritarë të Serbisë, të tronditur, zbuluan përmbajtjen e takimeve private në Prishtinë dhe në Beograd me drejtorin politik të Forejn-Ofisit, John Sawers. Më pas, politikanët serbë pohuan se i dërguari i BE-së, Stefan Lehne, u ka prezentuar atyre një zgjidhje mes pavarësisë së plotë dhe asaj të kushtëzuar për Kosovën.

Ky koncesus i arritur, në fakt, pranon të drejtën e shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje.⁹⁰ Nga tetori 2005, nën-sekretari i shtetit amerikan Burns ka folur për gjasat që “populli i Kosovës... të përcaktojë të ardhmen e vet”,⁹¹ duke nxitur reagimin plot pezëm të koordinatores për Kosovë të qeverisë së Serbisë, Sanda Rashkoviç-Iviq, e cila tha se Jugosllavia i ka definuar shqiptarët si “kombësi” e jo si “komb” apo popull konstituiv, kështu që atyre nuk u takon e drejta për vetëvendosje.⁹² Për më tepër, Komisioni i Badinterit⁹³ ua ka njohur të drejtën për vetëvendosje vetëm republikave. Edhe nëse Burns po i ndërronte rregullat e lojës, siç pretendonte ajo,⁹⁴ edhe të tjerët po e bëjnë këtë. PSSP Jessen-Petersen është shprehur: “...Më duket se është më se e qartë që bindja e fuqishme, pothuajse unanime, e popullatës shumicë në Kosovë duhet të jetë themeli i çfarëdo zgjidhjeje të qëndrueshme. Preferenca e tyre është e qartë”.⁹⁵ Deklarata e Grupit të Kontaktit e 31 janarit 2006 shkoi një hap më larg, duke e porositur Beogradin që të ketë parasysh se

⁸⁵ Ibid.

⁸⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, Londër, 10 janar 2006.

⁸⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, Paris, 6 janar 2006.

⁸⁸ Tabloidi beogradas *Kurir* pohonte se Ministri i jashtëm Lavrov, gjatë vizitës më 7 nëntor 2005, ia ka tërhequr vërejtjen qeverisë serbe se Rusia nuk do të hyjë në konfrontim me Perëndimin për shkak të Kosovës. Burimet diplomatike serbe ia kanë konfirmuar këtë Grupit të Krizave. Deklarata e kryetarit Putin e bërë në vigjilje të mbledhjes së Grupit të Kontaktit të mbajtur më 31 janar 2006, se vendimi për Kosovën duhet të jetë “universal” dhe të jetë i zbatueshëm edhe në konfliktet e ngrira në ish-Bashkimin Sovjetik, tregojnë për kalim nga një qëndrim negativ e defanziv në një qëndrim më tepër oportunist, që kërkon të përfitojë nga pavarësia në Kosovës.

⁸⁹ “Karota është anëtarësimi në BE”, *International Herald Tribune*, 17 janar 2006.

⁹⁰ Vetëvendosja dhe respektimi i integritetit territorial janë dy parime të përfshira në Aktin Final të Helsinkit të gushtit 1975. Për zbatimin e tyre si norma të ligjit ndërkombëtar shih: Richard Caplan, *Europe and the Recognition of New States in Yugoslavia* (Evropa dhe njohja e shteteve të reja në Jugosllavi), fq. 54.

⁹¹ Përfshirë në konferencën për gazetarë në Prishtinë, më 13 tetor 2005, si dhe në raportimin para Senatit amerikan, më 8 nëntor 2005.

⁹² Kushtetuta e Jugosllavisë, e vitit 1943, u jepte statusin e kombit popujve që atdheun e tyre e kishin në kuadër të Jugosllavisë, dhe statusin më të ulët të kombësisë atyre, si shqiptarët, që atdheun e kishin jashtë Jugosllavisë. Shih: Caplan, op. cit. fq. 138.

⁹³ Organ i arbitrazhit i themeluar nga Bashkimi Evropian (në atë kohë Komuniteti Evropian) më 1991, që të japë këshilla legale në lidhje me shpërbërjen e Jugosllavisë.

⁹⁴ Komente të Sanda Rashkoviç-Iviq sipas Përmbledhjes së lajmeve ditore VIP, 13 tetor 2005.

⁹⁵ Fjalimi në Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF) (Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura) Gjenevë, 1 dhjetor 2005.

zgjidhja “duhet të jetë e pranueshme për popullin e Kosovës”. Muajin që pasoi, përfaqësuesit e BE-së, SHBA-së dhe të MB-së ua përkujtuan liderëve të Serbisë se për shumicën shqiptare të Kosovës e vetmja zgjidhje e pranueshme është pavarësia.

Por, vendet e Grupit të Kontaktit dhe përfaqësuesit e OKB-së insistojnë se shqiptarët e Kosovës duhet ta meritojnë dhe fitojnë pavarësinë duke ndërmarrë iniciativa konkrete që të akomodojnë serbët dhe komunitet tjera pakicë, përfshirë edhe decentralizimin: “Aspiratat e tyre dhe statusi nuk do të vijnë automatikisht. Duhet bërë shumë punë”.⁹⁶ Në vizitën që ia bëri Kosovës dhe Serbisë, kah fundi i vitit 2005, Ministri i jashtëm i Francës theksoi se 90 për qind e banorëve të Kosovës duan pavarësi dhe se duhet qenë real, por se gjithashtu duhet kujdesur edhe për pakicën prej 10 për qind. Gjatë vizitës së njëjtë, homologu i tij italian u shpreh: “Kosova duhet të ketë karakter multi-etnik... Kosova kurrë nuk do të jetë e pavarur nëse nuk është multi-etnike”.⁹⁷ Burns ka mbajtur neutralitetin formal amerikan sa i përket zgjidhjes përfundimtare por në dëshminë e tij para Senatit, në nëntor, në dy faqe ka treguar se çfarë duhet të bëjnë shqiptarët e Kosovës që të fitojnë pavarësinë. Porosia e tij për serbët dhe Beogradin ka qenë shumë më e shkurtër: bashkëpunoni dhe jini kooperativë.

Në afat më të gjatë, Grupi i Kontaktit ka mjete me të cilat mund të detyrojë Serbinë, që ta pranojë formalisht humbjen e Kosovës. Integrimet e saj Evro-Antlantike do të bllokohen nëse ajo nuk e bën këtë. Burns u pat deklaruar gazetarëve se nuk mund të marrë me mend që Serbia do të pranohet në NATO pa zgjedhur më parë “kontestin e madh territorial që ka... të ardhmen e Kosovës”.⁹⁸ BE-ja nuk ka qenë kaq eksplicite dhe ka përmendur faktorët tjerë siç janë mungesa e bashkëpunimit me Hagën si pengesa për Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim.⁹⁹ Por, është kandidimi për anëtarësim ajo që bashkësia ndërkomëbtare e sheh si levën kryesore. Nëse Kosova, si shtet i pavarur, ecën drejt Evropës, ndërsa Serbia ende refuzon ta pranojë atë dhe ende qëndron mbrapa pretendimeve territoriale apo edhe përcaktohet për një prezencë zyrtare në veri, do të

shohë se kjo do të jetë një barrë tepër e rëndë për aspiratat e saj për anëtarësim në BE.

Por, duket se kjo letër e BE-së është pak e mbiçmuar kur është fjala për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Problemi qëndron tek koha. Statusi i Kosovës duhet të përcaktohet brenda një viti, ndërsa çështjes së anëtarësimit do t'i duhen vite të tëra për t'u “pjekur”. “Perspektiva evropiane” në Kosovë shpesh shihet si një qetësues që ofrohet në vend të shtetësisë; përpjekja për të mbajtur Kosovën e jo gjasat e largëta të anëtarësimit në BE është ajo që dominon politikën ditore në Serbi.

Angazhimi i Ahtisaarit mund të bëjë që pozicionet e Prishtinës dhe Beogradit të afrohen sado pak.. Rreth decentralizimit, qartazi humnera po ngushtohet (dallimet po afrohen). Por, vështirë se do të tejkalohet plotësisht brenda kohës që është në dispozicion, qoftë në këtë çështje qoftë në nën-çështjet siç është ajo e përfaqësimit serb në institucionet qëndrore, mbrotja e vendeve religjioze serbe dhe pretendimet pronësore. Për pavarësinë as të mos flasim. Çështjet e rendit të dytë mbeten peng i çështjes kryesore të statusit. Grupi i Kontaktit duhet të vendosë se kur dhe në çfarë forme do të imponohet si arbitër. Rusia është shprehur kundër imponimit dhe në përkrahje vetëm të asaj për të cilën do të dakordohen të dyja palët.¹⁰⁰ Në të vërtetë, asnjë nga vendet e Grupit të Kontaktit nuk dëshiron që të imponojë zgjidhjen pa së paku pranimin e heshtur të Beogradit. Heqja e sovranitetit të një vendi mbi një pjesë të territorit të vet është një hap tepër i madh për Këshillin e Sigurimit.¹⁰¹ Por, kjo nuk i pengon vendet e Grupit të Kontaktit që të imponojnë pikëpamjen se Kosova duhet të jetë e pavarur dhe se Serbia do të mbetet e izoluar nëse e kundërshton këtë.

Por, deri në çfarë shkalle duhet të imponohet kjo? Nëse qysh në fillim të procesit do të ketë shkarje nga imazhi i të qenurit të paanshëm, kjo mund të zvogëlojë gjasat që palët të zvogëlojnë dallimet mes tyre, veçanërisht sa i përket decentralizimit, dhe që përfaqësuesit e serbëve të Kosovës dhe ata të Kishës Ortodokse të angazhohen në nën-çështjet që vetvetiu do të gjenerojnë nevojën për përmbylljen e procesit. Ekziston shqetësimi se Beogradi do të tërhiqet dhe si rezultat i kësaj nacionalizmi në Serbi do të forcohet edhe më. Edhe pse koha e shkurtë që ka mbetur para se të shterojë durimi i shqiptarëve të Kosovës është faktori kryesor që përcakton orarin e punës (ndonëse politikanët e tyre janë mjeshtër për të zhagitur punët), disa nga Grupi i Kontaktit, gabimisht shohin dobi

⁹⁶ Albert Rohan në konferencën për gazetarë në Prishtinë, 14 dhjetor 2005.

⁹⁷ *Zëri*, 29 dhjetor 2005.

⁹⁸ “SHBA: Serbia nuk mund të hyjë në NATO, pa e zgjedhur qështjen e Kosovës”, Reuters, 8 nëntor 2005.

⁹⁹ “Rehn përmend mundësinë e suspendimit të bisedimeve për stabilizim-asociim, ndërsa autoritetet serbe pa reagim zyrtar”, përmbledhja e lajmeve të ditës VIP, 11 nëntor 2005. Çuditërisht, 57,5 për qind e respondentëve në një anketë të bërë me telefon nga revista serbe *Nin* më 12 nëntor 2005 thonë se rezultati i procesit për statusin final të Kosovës është faktori që më së shumti do të ndikojë integrimin e Serbisë në BE.

¹⁰⁰ Ministri i jashtëm Lavrov e nënvizoi këtë, gjatë vizitës së tij në Prishtinë dhe Beograd, 7 nëntor 2005.

¹⁰¹ Dy precedentët më të afërta janë ai i Bangladeshit (1971) dhe Eritresë (1993); por asnjëra nga këto nuk e fitoi vendin në OKB para se të njihej formalisht nga shtetet nga të cilat ishin ndarë (Pakistani, respektivisht Etiopia).

në shtyrjen e shkurtë të procesit nëse kjo do të thotë se zgjedhjet në Serbi do ta largonin nga skena, kryeministrin jo-fleksibil, Koshtunica, ndërsa do të forconin kryetarin Tadiq me orientim pro-perendimor, edhe nëse çmimi për këtë do të ishte forcimi i Partisë Radikale.¹⁰² Sidoqoftë, qeveria e tashme duket se gëzon përkrahjen e shumicës së anëtarëve të parlamentit dhe mund të qëndrojë në fuqi, në mënyrë bindëse, deri në fund të mandatit të saj (dhjetor 2007). Në të njëjtën kohë, kryetari Tadiq dhe pjesa tjetër e opozitës “reale” duket se nuk po u ngutet që të sfidojë Koshtunicën. Dalja në skenë e një blloku demokratik nuk duket të jetë asgjë më shumë se sa dëshirë e mirë e disa diplomatëve perëndimorë që nuk janë mirë të informuar.

Disa të tjerë nuk shohin dobi në përpjekjet për ta mikro-menaxhuar Beogradin¹⁰³ dhe konsiderojnë se largimi i Serbisë nga bisedimet jo vetëm që ka gjasa të ndodhë por edhe ndoshta është gjë e nevojshme për të krijuar rrethana të reja në të cilat, serbët e Kosovës do të angazhoheshin: “Nuk mund të lejojmë të na frikësojë Beogradi sepse kjo vetëm sa do t’i vështirësojë gjërat... ata duhet të pranojnë realitetin”.¹⁰⁴ Shqiptarët e Kosovës ka më shumë gjasa që të bëjnë koncesione në akomodimin e pakicës serbe nëse Grupi i Kontaktit do t’i vëjë negociatat me ta në thelb të procesit e jo të mbeten vetëm ndërmjetësues në një proces që nuk dihet kah shpie dhe në të cilin pritet që Prishtina e Beogradi të tejkalojnë dallimet.

Do të jetë e rëndësishme që edhe Grupi i Kontaktit të sigurojë shkallë të lartë të angazhimit e përkushtimit të liderëve të vet. Një zgjidhje e implementuar në ambientin e tanishëm që e karakterizon përkushtimi i mekur dhe i vakët politik e financiar i bashkësisë ndërkombëtare në Ballkanin Perëndimor mund të sjellë një paqe të vështirë që nuk do të garantonte stabilitet afatgjatë. Gjetja e një zgjidhjeje afatgjatë kërkon që liderët e BE-së të jenë më zemërgjërë dhe t’i ofrojnë Ballkanit Perëndimor një paketë që përfshinë liberalizimin e vizave, program arsimor më të gjërë, shlyerjen e borxheve dhe asistencë zhvillimore zemërgjërë.

Niveli i resurseve që bashkësia ndërkombëtare do të jetë në gjendje t’i vëjë në dispozicion do të ndikojë edhe në atë nëse do të realizohet përcaktimi se “nuk do të ketë ndarje”. Nëse nuk mund të vëjë një mision tranzitor në veri të Kosovës, të ngjashëm me Misionin e OKB-së në Sllavoninë Lindore në Kroaci gjatë viteve 1996-1998,¹⁰⁵

Kosova do të mbetet e fragmentarizuar dhe do të vazhdojë të gjenerojë jostabilitet rajonal. Gjasat për bashkim të veriut me Serbinë do të mbetet një mundësi tërheqëse për Beogradin dhe për liderët e serbëve të Kosovës, duke bërë që çështja e kufijve në rajon të mbetet çështje e hapur dhe atë jo vetëm mes Kosovës e Serbisë.

Synim i Grupit të Kontaktit është që nga të dyja palët të sigurojë nivel të mjaftueshëm të pajtimit të heshtur ashtu që zgjidhja të vihet në letër në formë të një rezolute të re të Këshillit të Sigurimit, që do të zëvendësonte Rezolutën 1244. Diplomatët e shohin këtë rezolutë të re – e jo pëlqimin e vendorëve – si burim të mandatit për misionin e ri ndërkombëtar që do të vijë pas UNMIK-ut, pasi që gjasat që Serbia të nënshkruajë çfarëdo që pranon pavarësinë e Kosovës janë të vogla e madje edhe mund të largohet nga procesi mu në fund të tij. “Ndoshta ata do të bëjnë aq sa mjafton për të marrë shpërblimin që u është ofruar”, thotë një diplomat.¹⁰⁶ Së paku, pranimi i misionit të ri nga ana e shqiptarëve të Kosovës do të ndikojë drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë e zgjidhjes, edhe pse edhe këtu prioritetet dhe orari i bashkësisë ndërkombëtare mund të ndeshet me pritjet e shqiptarëve të Kosovës për të realizuar vetëvendosjen. Bashkësia ndërkombëtare ende nuk e ka pranuar referendumin në Kosovë si mjet për të siguruar pëlqimin dhe zotimin për respektimin dhe implementimin e marrëveshjes për statusin final që do të mund t’ua lejonte disa kompetenca ekzekutive apo mbikqyrëse në duart e bashkësisë ndërkombëtare. Në vend të kësaj, vazhdon që, në mënyrë aspak kreative, të shohë referendumin si sfidim i autoritetit të Këshillit të Sigurimit.¹⁰⁷

2. Realizimi në praktikë i marrëveshjes

Pasi ka arritur pajtimin se pavarësia e kushtëzuar është e vetmja zgjidhje reale, Grupi i Kontaktit është i preokupuar së tepërmi me formën, shtrirjen dhe kompetencat e misionit ndërkombëtar që do të zëjë vendin e UNMIK-ut pasi ky i fundit të shkojë. Përgatitjet për të penguar Kosovën që të shkaktojë dëm, kërcënojnë që të lënë nën hije përgatitjet për të ndihmuar zhvillimin shoqëror, politik e ekonomik të Kosovës. Edhe pse pritet që BE-ja

në shtetin kroat, e cila ishte tema e raportit të parë të Grupit të Krizave *Sllavonia Lindore*, 27 mars 1996.

¹⁰² Intervistë e Grupit të Krizave, Londër, 10 janar 2006.

¹⁰³ Një diplomat kundërshton: “Nuk jemi këtu që të caktojmë fituesin. Edhe ashtu, çfarë ka bërë Tadiqi?”, Intervistë e Grupit të Krizave, 10 janar 2006.

¹⁰⁴ Ibid.

¹⁰⁵ Administrata Tranzitore (e përkohshme) e Kombeve të Bashkuara për Sllavoninë Lindore, Baran dhe Sirmiumin Perëndimor (UNTAES), që mbikëqyri ri-integrimin e territorit e Kosovës. Kjo duhet të vendoset në Këshillin e Sigurimit”.

¹⁰² Intervistë e Grupit të Krizave, 6 janar 2006.

¹⁰³ Një diplomat kundërshton: “Nuk jemi këtu që të caktojmë fituesin. Edhe ashtu, çfarë ka bërë Tadiqi?”, Intervistë e Grupit të Krizave, 10 janar 2006.

¹⁰⁴ Ibid.

¹⁰⁵ Administrata Tranzitore (e përkohshme) e Kombeve të Bashkuara për Sllavoninë Lindore, Baran dhe Sirmiumin Perëndimor (UNTAES), që mbikëqyri ri-integrimin e territorit

të marrë pjesën më të madhe të përgjegjësisë për misionin pasues, kapacitetet e saj që të ndikojë mbi proceset mbeten të kufizuara. Institucionet e BE-së e dijnë se mund të përfundojnë duke mbajtur në duar një foshnje të shëmtuar me prindër të panjohur.¹⁰⁸

25 vendet anëtare të BE-së, ka ma pak gjasa që të pajtohen rreth Kosovës se sa gjashtë vendet e Grupit të Kontaktit. Disa zëra në BE ende hezitojnë të shqyrtojnë pavarësinë e Kosovës si zgjidhje dhe fuqimisht e kundërshtojnë një mision të gjërë të BE-së me kompetenca ekzekutive, që do të trashëgonte UNMIK-un.¹⁰⁹ Institucionet e BE-së e dijnë mirë se çfarë duan dhe për çfarë kanë nevojë por nuk ndihen të obliguara që të shpalosin argumentet e tyre.¹¹⁰ Ato kërkojnë një ambient pune kooperativ e të sigurtë në Kosovë, e me këtë edhe një proces për statusin që do të prodhojë një zgjidhje të qartë e finale për shumicën shqiptare, e jo një marrëveshje të përkohshme. Atyre u nevojitet një Kosovë që do të mund të lidhë marrëveshje sepse kështu mund të fusin në përdorim mjetet e tyre të partneritetit e kushtëzimit. Dhe kanë nevojë për një strukturë qeverisëse funksionale në Kosovë që të mos kenë nevojë të rinegociojnë pas disa viteve kushtet për integrim në BE, siç po ndodh me Bosnën e Hercegovinën.

Me fjalë të tjera, Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian kanë nevojë për një Kosovë të pavarur, të pangarkuar me aranzhmane të tej-detajizuara për decentralizimin apo të ndarë në entite.¹¹¹ Dallimi në mes të interesit të madh të BE-së dhe kapaciteve të kufizuara për të artikulluar këtë interes mbetet çështje problematike. Edhe pse institucionet e BE-së kanë të dërguarin e tyre, Stefan Lehne, në ekipin e Ahtisaarit dhe luajnë një rol pozitiv në Grupin e Kontaktit, ata rezikojnë të bëhen pagues pasivë të arranzhmaneve të cilat nuk i kanë disajnuara ata vetë.

Pse prezencë ndërkombëtare? Ideja e një prezence ndërkombëtare edhe pasi të jetë zgjidhur statusi i Kosovës është një nga elementet e “pavarësisë së

kushtëzuar” që është duke qarkulluar për një kohë.¹¹² OKB-ja dhe Grupi i Kontaktit tanimë kanë qartësuar se çfarëdo që të jetë vendimi për statusin, në Kosovë do të ketë një prezencë ndërkombëtare civile. Parimet Bazë të Grupit të Kontaktit qartësojnë se një mbikqyrje e tillë do të jetë e nevojshme “për një kohë”, ndërsa Eide argumentonte se “fillimi i procesit për statusin nuk do të thotë të hyhet në fazën përfundimtare por vetëm hyrje në një fazë tjetër të prezencës ndërkombëtare”. Edhe pse përmendin vazhdimin e disa detyrave të UNMIK-ut siç është “të monitorojë dhe mbështesë autoritetet që këto të vazhdojnë të implementojë standardet”, Parimet Bazë nuk elaborojnë një strategji të ndërtimit të shtetit. Misioni duhet të dizajnohet duke pasur parim bazë mu këtë, ashtu që të shtohen deri në maksimum gjasat për bashkëpunim me akterët lokal në Kosovë si dhe një strategji dalëse koherente.

Edhe pse në përgjithësi pranohet se misioni post-statusit do të jetë më i vogël se UNMIK-u, i përqëndruar në shumë më pakë fusha të jetës dhe me më pak kompetenca të rezervuara, aktorët ndërkombëtarë kanë tendencë që të përpilojnë lista tepër të gjata të asaj se çfarë duhet të bëjë misioni i ri, çfarë duhet të mbikqyrë apo monitorojë. Dhe, edhe pse është me vend që të mbahen disa kompetenca, që të garantohet se Kosova i përmush obligimet e veta ndaj pakicave (siç ka sugjeruar një kohë të gjatë Grupi i Krizave), institucionet e Kosovës duhet të lejohen që të udhëheqin vet në shumicën e linjave të veprimit. Fundi i fundit, kostoja mund të shkurtojë ambiciet sepse buxheti i BE-së për vitet 2007-2013 (i miratuar në dhjetor 2005) është i vogël. Kështu, ekziston reziku që të gjitha apo gati të gjitha paratë e BE-së, që janë në dispozicion do të shpenzohen për misionin policor e jo në zhvillim.

Menaxhimi i pikëpamjeve lokale. Mungesa e një qendre, që do të bënte plane për nevojat e përgjithshme të Kosovës do të mund të kushtojë shumë. Nëse involvimi i BE-së në Kosovën e pas-statusit përqëndrohet më tepër në elementet e kontrollit, siç është një mision policor me 1.000 trupa, për të mbajtur një fuqi ekzekutive domethënëse dhe të mjaftueshme, gjyqtarë dhe prokurorë evropianë për rastet e ndieshme të profilit të lartë dhe një Përfaqësues Special të BE-së të paisur me “fuqitë e Bonnit” që të shkarkojë zyrtarë të Kosovës,¹¹³ ndërsa

¹⁰⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të Komisionit Evropian, 5 janar 2006.

¹⁰⁹ Intervista të Grupit të Krizave me diplomatë të vendeve anëtare të BE-së për zhvillimet në vitin 2005.

¹¹⁰ Dokumente të rëndësishme, të përbashkëta, për Kosovën janë përpiluar nga Sekretariati i Këshillit të BE-së dhe Komisioni Evropian, në qershor dhe dhjetor 2005, dhe u qarkulluan ndër vendet anëtare. Asnjë prej tyre nuk është bërë publik zyrtarisht.

¹¹¹ Intervista të Grupit të Krizave me personelin e Këshillit dhe të Komisionit, Prishtinë dhe Bruksel, 29 nëntor 2005 dhe 5 janar 2006. Dokumentet e përbashkëta, të papublikuara të Këshillit e Komisionit i përmbajnë disa nga këto argumente.

¹¹² Në raportet e Grupit të Krizave, tash së voni në Raportin për Evropë numër 161, *Kosova: Drejt Statusit Final*, 24 janar 2005, që përsëriste atë që është thënë në Raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 108, *Pas Milosheviqit: Agjendë praktike për Paqë të Qëndrueshme në Ballkan*, 1 prill 2001 dhe Raportin e Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën (Oxford University Press).

¹¹³ Mbledhja e Këshillit për Implementimin e Paqes, e mbajtur në Bonn në dhjetor 1997, i dha Përfaqësuesit të Lartë në Bosnjë të drejta të mëdha të intervenimit, përfshirë të drejtën që të imponojë legjislacion apo të shkarkojë cilindo zyrtar,

duke mos qenë njësoj zemërgjërë në fondet për ndihmë në zhvillim, atëherë kjo do të bëjë që BE-ja të shihet më pak si partner e më tepër si një sundimtar gjysëm-kolonialist. Liderët e Kosovës do të mund të shfrytëzonin këtë pikëpamje të vendorëve nëse do të viheshin nën hetime nga BE-ja për korrupsion dhe krim të organizuar apo do të shkarkoheshin në bazë të fuqive të Bonnit.

Potencial për këtë ka edhe për shkak të zhgënjimit me atë që ka bërë shtylla e BE-së e UNMIK-ut, përgjegjëse për zhvillimin ekonomik dhe për shkak të mosbesimit latent, tradicional, që shqiptarët ndiejnë për Evropën. Injorimi i ekonomisë së Kosovës që nga viti 1999 është turp i vërtetë që i mveshet, me apo pa të drejtë, BE-së. Në këtë është reaguar me përpjekjet për t'u distancuar nga Shtylla e BE-së e UNMIK-ut, pasi qysh në vitin 2004 zyrtarët e Komisionit Evropian patën kërkuar të quhet vetëm shtylla e financuar nga BE-ja.¹¹⁴ Ata tani thonë: "Shtylla IV e UNMIK-ut, e cila nuk do të jetë bërthama e prezencës së ardhshme evropiane në Kosovë". Brukseli dëshiron që të gjitha përgjegjësitë e shtyllave t'i dorëzohen qeverisë së Kosovës kur të zgjidhet statusi.¹¹⁵ Shqiptarët e Kosovës i konsiderojnë shumicën e vendeve anëtare të BE-së si pro-serbe (për dallim nga SHBA-ja¹¹⁶) e madje ende janë të hidhëruar për vendimin e vitit 1913 të fuqive evropiane që të lënë Kosovën nën Serbi.¹¹⁷

Një faktor tjetër i rëndësishëm për të siguruar partneritetin në mes shqiptarëve të Kosovës dhe BE-së në çështjet e policisë, drejtësisë dhe misionit të përfaqësuesit special do të jetë shkalla e bashkëpunimit që do ta tregojë bashkësia ndërkombëtare, me NATO-n në krye, në përkrahjen e aspiratave për një ushtri – sado simbolike, e vogël dhe irelevante për nevojat imediate të jetë – pasi që NATO planifikon që të mbajë një kontingjent të konsiderueshëm të trupave të saj në Kosovë për disa vite. Nëse NATO

trajnon një forcë mbrojtëse të vogël, të specializuar, që mund t'i bashkohet Partneritetit për Paqe e dikur ndoshta edhe vet organizatës, atëherë gjasat që shqiptarët të shohin prezencën e BE-së si pjesë të partneritetit ndërkombëtar do të jenë më të mëdha. Nëse bashkësia ndërkombëtare vendos se Kosova nuk ka "nevojë" për ushtri dhe e gjykon këtë si kompromis të nevojshëm për të siguruar pajtimin e Serbisë me vendimin përfundimtar, atëherë shqiptarët e Kosovës do të interpretojnë këtë si disfatë ushtarake dhe trajtim të Kosovës si vend më pak i civilizuar se sa vendet fqinje. Atëherë ka gjasa që prezenca evropiane të shihet si forcë e huaj okupatore.

Profilizimi i prezencës ndërkombëtare. Është duke u arritur pajtimi, në mes Grupit të Kontaktit dhe BE-së, se një personalitet i vetëm duhet ta marrë në dorë timonin e prezencës ndërkombëtare pas statusit. Sikurse në Bosnjë e Hercegovinë, ky person mund të jetë "dy-krerësh", Përfaqësues Special i BE-së dhe Përfaqësues i Lartë i autorizuar nga një rezolutë e Këshillit të Sigurimit (dhe/ose mundësisht në pajtim me Kosovën). Roli i dytë do të ofronte mandat më të gjërë se sa atë që BE-ja, si entitet rajonal, do të mund të ofronte. Ky person do t'i raportonte një këshilli më të gjërë ndërkombëtar, përfshirë SHBA-në, si dhe aktorët tjerë të rëndësishëm që nuk janë pjesë e BE-së. Mendimi për gjërësinë dhe thellësinë e kompetencave ekzekutive e të rezervuara që ai/ajo do të mund të kishte sille në atë mes "Sarajevë minus, Shkup plus",¹¹⁸ që do të thotë se do të jetë diçka në mes të kompetencave që ka Përfaqësuesi i Lartë në Bosnjë, që madje të shkarkojë tërë qeverinë dhe asaj të një roli këshillëdhënës e monitorues që realizohet me ftesën e autoriteteve vendore. Më pak vëmendje po i kushtohet kushteve për largimin e këtij misioni, edhe pse këto sigurisht do të jetë në lidhura në ndonjë mënyrë me procesin e integritit të Kosovës në BE.

Institucionet e BE-së deklarojnë se misioni në Kosovë, pas statusit, "nuk mund të jetë EUMIK" – vazhdim i një misioni me mandat të gjërë, të pakufizuar në kohë e i dalë nga Rezoluta 1244. Por, mund të ndodhë të pajtohet me diçka që i ngjan kësaj.

BE-ja ka hedhur poshtë kërkesat e OKB-së që të marrë mbi vete disa pjesë të UNMIK-ut derisa 1244-shi është ende në fuqi.¹¹⁹ UNMIK-u ka caktuar aktorët, nga sektorë të ndryshëm, në disa grupe që të përpilojnë aspektet teknike të aranzhmaneve të ardhshme për ekonominë, sundimin e ligjit, të drejtat e pakicave dhe për sfera tjera. Nëpërmjet këtyre, personeli i UNMIK-ut tenton që të argumentojë zgjatjen e rolit të tyre, veçanërisht në sferën ekonomike të Shtyllës IV. Argumentet e tyre, që nuk

përfshirë edhe përfaqësuesit e zgjedhur, nëse gjykonte se këta po pengonin implementimin e marrëveshjes për paqe. Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 146, *Qeveritë Nacionaliste të Bosnjës: Paddy Ashdown dhe Paradokset e Ndërtimit të Shtetit*, 22 korrik 2003.

¹¹⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, Bruksel, 23 qershor 2004.

¹¹⁵ Dokumenti Solana-Rehn, op. cit.

¹¹⁶ Figurat kryesore të partnerit në koalicionin qeverisës LDK shprehin gatishmëri që ta kënaqin atë, që ata e mendojnë, të jetë agjendë amerikane, qoftë edhe duke mos përfillur normat evropiane për të drejtat e njeriut apo shqetësimet e shprehura nga Këshilli i Evropës. Njëri propozoi që të kapen ihtarët e islamizmit radikal dhe "të hedhen në det". Një tjetër ishte gati që të ofrojë Kosovën si qendër diskrete paraburgimi për të dyshuarit për terrorizëm, si njëfarë mini-Guantanamo. Intervista të Grupit të Krizave, Prishtinë, maj 2005 dhe janar 2006.

¹¹⁷ Gjeneratat e vjetra, nganjëherë, Evropën e quajnë "kurva e vjetër". Bindja se Evropa duhet të paguajë për mëkatet kundër shqiptarëve, shihet në tekstin të këngës "O Evropë, kthema borxhin" të këngëtarit nacionalist Ilir Shaqiri.

¹¹⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me stafin e sekretariatit të Këshillit të Evropës, Bruksel, 5 janar 2006.

¹¹⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, Bruksel, 5 janar 2006.

priten me simpati,¹²⁰ janë të ndikuara nga fërkimet e përditshme me qeverinë e përkohshme. Këta theksojnë se tërheqja e shpejtë ndërkombëtare, dikur kah fundi i vitit 2006, sjell rrezikun që trupat rregullative dhe ato që gjenerojnë të ardhura të bien në dorën e “miqëve” (në rastin më të mirë): “Një turmë e minjëve të uritur do të përfundojnë në shitoren më të madhe të djathit.”¹²¹ Edhe pse institucionet e BE-s po mundohen të injorojnë Shtyllën IV, megjithatë ndoshta do të jenë të detyruar që të mbajnë disa pjesë të saj që të mbajnë të hapur një derë nëpërmjet së cilës do të përcjellin qeverisjen ekonomike të Kosovës. Në sferën e policisë dhe të drejtësisë, BE-ja duhet të gjejë rrugëdalje nga një labirinth i iniciativave gjysëm të profilizuara, që përkohë njëra-tjetrën e madje edhe që kundërshtojnë njëra-tjetrën, siç janë ministrinë e sapothemeluara, ISSR dhe hetimet e papërfunduara për dyshime për keqpërdorime dhe mashtrime në nivelin më të lartë në IPVQ.

Disa nga Grupi i Kontaktit preferojnë një mision pasues më të madh.¹²² Por, një mision evropian më robust, policor e gjyqësor, vetëm sa do të dekurajonte SHPK-në dhe prokurorët e gjyqtarët vendorë që të merren me rastet e rënda dhe kështu të mos angazhohen në krijimin e kuadrove vendorë që do të merrnin këto çështje në duart e veta. Është fakt se puna e papërfunduar e UNMIK-ut në çrrënjosjen e krimit të organizuar dhe të krijimit të një kulture e të mekanizmave të përgjegjësive demokratike e bën të nevojshme që udhëheqësi i misionit të ardhshëm ndërkombëtar të ketë kompetenca të pushojë nga puna çdo zyrtar.¹²³ Por, UNMIK-u nuk ka shfrytëzuar këtë të drejtë asnjë herë gjatë këtyre gjashtë viteve; do të jetë e vështirë që kjo të fillojë të aplikohet në Kosovën e pavarur. “Më mirë do të jetë që t’u përshpëritet: ‘Harroni Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim nëse ende e keni atë ministër’, sugjeron një zyrtar i Komisionit Evropian, që favorizon çasjen: më pak kompetenca por më shumë kushtëzimeve.”¹²⁴

Ka dallime edhe në mes institucioneve evropiane, ndërsa kufiri mes përgjegjësive të Këshillit dhe Komisionit është ende i paqartë. Derisa stafi i Këshillit insiston se pa kompetencat e Bonnit, Përfaqësuesi Special i BE-së do të jetë “tigër pa dhëmbë”, ndërsa misioni policor do të jetë vetëm operacion monitorues, burime nga Komisioni

“hezitojnë të pranojnë diçka që do t’i ngjante kompetencave të drejtpërdrejta qeverisëse... (veçanërisht ato) të cilat ne nuk i kemi as vis-a-vis vendeve tona anëtare”.¹²⁵ Planifikimi i misionit duhet që çdoherë t’i kthehet çështjes së kompatibilitetit me shtetësinë e Kosovës së pavarur.

Edhe pse bërja bashkë e të gjitha shtyllave të BE-së në një aktor të vetëm duket ide tërheqëse, kjo çasje ka edhe mangësitë e veta. Do të krijonte probleme edhe në negociimin e integritit të Kosovës në BE, edhe në përcaktimin e kualifikimit të saj si kandidat për pranim. BE-ja, në të njëjtën kohë do të mbante disa kompetenca ekzekutive në Kosovë dhe do të përipiqej të negocionte me qeverinë e saj, pikat e monitorimit dhe kushtëzimit me të cilat përgatiten vendet kandidat për anëtarësim. Kjo metodë do të ishte sidomos problematike pasi BE-ja sipas të gjitha gjasave do të mbajë funksionet ekzekutive në sferën e sundimit të ligjit, që është kyçe në kushtet e Kopenhagës për demoraci dhe të drejtat e njeriut, që duhen t’i përmbushin aplikantët për në BE.¹²⁶

Problem tjetër është përvoja e kufizuar e BE-së në disa sfera të nevojshme, siç është gjyqësia. Në këtë fazë përgatitore, UNMIK-u është duke u përpjekur që të angazhojë prokurorë dhe gjyqtarë evropianë, por institucionet e BE-së nuk kanë kapacitet që të mbështesin këtë angazhim. Sa i përket mbikëqyrjes apo monitorimit së çështjeve civile, “cilido prefekt francez do ta bënte këtë më mirë se ne”, thotë një zyrtar i BE-së.¹²⁷ Skenari më i keq do të ishte vënia e një misioni të BE-së me shumë kompetenca të huaja dhe të panjohura për institucionet e saj, që do të tejkalonin kufijt e traktateve themelore të organizatës, të cilat do ta bënin atë të pa aftë për ta sjellë Kosovën më afër kritereve për anëtarësim.

Shkalla e decentralizimit. Raporti i Eides i gjysmës së dytë të vitit 2005 flet për decentralizim të thellë. Ai parasheh që komunat me shumicë serbe duhet të kenë “kompetenca të shtuara në sferat siç janë policia, drejtësia... kompetenca speciale që shkojnë përtej atyre që u jepen komunave tjera”. Propozimi i tij për lidhjet horizontale mes komunave me shumicë serbe dhe lidhjet speciale me Beogradin sugjeronin një anashkalim gati të

¹²⁰ Intervista të Grupit të Krizave me personel të Këshillit të Evropës, FMN-në, Bankës Botërore dhe UNMIK-ut, nëntor dhe dhjetor 2005.

¹²¹ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, 14 dhjetor 2005.

¹²² Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të Komisionit Evropian, Bruksel, 5 janar 2006.

¹²³ Intervistë e Grupit të Krizave, Londër, 10 janar 2006.

¹²⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të Komisionit Evropian, Bruksel, 5 janar 2006.

¹²⁵ Intervista të Grupit të Krizave, Bruksel, 5 janar 2006.

¹²⁶ Mbledhja e Këshillit të Evropës e mbajtur në Copenhagen më 1993 ka caktuar tri kritere për t’u përmbushur nga kandidatët për BE: i) stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave; ii) ekonomi tregu funksionale si dhe kapacitetet për t’u përballur me presionin e konkurrencës dhe të forcave të tregun përbrenda Bashkimit (Evropian); dhe iii) aftësia për të marrë mbi vete obligimet që sjellë anëtarësimi, përfshirë ndjekjen e synimeve politike, ekonomike dhe monetare të Unionit.

¹²⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, Bruksel, 5 janar 2006.

plotë të Prishtinës dhe institucioneve qendrore kosovare. Prishtina qe habitur me këtë, ndërsa Serbia duke u nisur nga këto ide ndërtoi projektin e saj për krijimin e më shumë komunave me shumicë serbe dhe shkrirjen e tyre në një entitet serb të lidhur me Beogradin. Kjo tregon kufirin për decentralizimin. Nëse shkohet tepër larg, bëhet bazë për ri-përqëndrimin e zonave serbe nën kontrollin e Beogradit.¹²⁸

Shqiptarët e Kosovës i shohin me dyshim kompetencat e shtuara në polici dhe gjyqësi për komunat me shumicë serbe. Reagimi i një politikani tregon sa i rrezikshëm mund të jetë në terren ajo që duket kompromis, sipas Eides: “Pasi mosbesimi mes dy komuniteteve është aq i madh, dëshirojmë një polici komunale aq të fortë sa të jetë në gjendje të miratojë, refuzojë apo mos të lejojë hyrjen e policisë nga qendra në Prishtinë në enklava”.¹²⁹ Disa vende të Grupit të Kontaktit, siç janë SHBA-ja dhe Gjermania, e pëlqejnë idenë e themelimit të policisë komunale, që do të ishte shtesë e SHPK-së.¹³⁰ Në shikim të parë, kjo do të ishte në pajtim me kërkesën e Beogradit që serbët ta kontrollojnë policinë në rajonet e tyre derisa do të mbahej SHPK-ja mbarë-kosovare. Por, në rrethanat e tanishme, kjo vetëm sa do ta degradonte unitetin në SHPK e me këtë edhe kualitetin e policisë.

Serbët sigurisht do të lëshonin krejtësisht SHPK-në që të hynin në forcën e re komunale, duke i mundur Beogradit që t'i bëjë bashkë me qindra anëtarë të ministrisë së vetë të brendshme (MUP), që tanimë heshtur veprojnë në zonat me serbë.¹³¹ Kjo do të ishte recetë për përlëshje të dhunshme mes serbëve e shqiptarëve, që të gjithë këta të armatosur nga bashkësia ndërkombëtare dhe shteti. Komisionari i Policisë së UNMIK-ut Vittrup me të drejtë thotë: “Nuk mund të

ndërtoni një forcë policore me kompromise politike. Në një vend të vogël si Kosova duhet të ekzistojë vetëm një forcë policore”.¹³² Rregullorja e UNMIK-ut për policinë, e dhjetorit 2005, ofron një zgjidhje më të mirë, që nisët nga formula e Marrëveshjes së Ohrit në Maqedoni, që u jep kuvendeve komunale mundësinë të zgjedhin në mes tre kandidatëve për shef të policisë lokale nga lista e propozuar nga komisionari i policisë.¹³³

Derisa bashkësia ndërkombëtare mendon si ta bëjë Kosovën vend funksional, gjërat mund të kthehen në të mirë të institucioneve qendrore. Siç vëren një zyrtar i BE-së: “Sa më tërheqës politikisht të jetë për pakicat modeli i decentralizimit, aq më pak i qëndrueshëm do të jetë”.¹³⁴ Zëvendësi i Ahtisaarit, Rohan, mendoi dhe ishte më i qartë për atë se si të realizohen lidhjet horizontale mes komunave me shumicë serbe “ashtu që të mos paraqesë ndarje apo diçka të tillë. Kjo nuk është ajo që ne dëshirojmë”. Duke folur për gjasat për më shumë komuna me shumicë serbe, ai e kujtoi përvojën e Maqedonisë: “Nuk mund të rritni në pakufi numrin e komunave sepse kjo do të ishte krejtësisht jofunksionale... kjo duhet të jetë edhe financiarisht e qëndrueshme”.¹³⁵ I pyetur, pse bashkësia ndërkombëtare duhet të fragmentarizojë policinë në Kosovë kur në të njëjtën kohë po mundohet të centralizojë atë në Bosnjë, një diplomat britanik theksoi nevojën që “këto ide ende fillestare duhet të hedhen poshtë. Nëse ndërtoni barriera institucionale në mes komuniteteve, atëherë vetëm sa do ta zmadhoni problemin”.¹³⁶

Duket se nëse shqiptarët e Kosovës do të prezentojnë një plan të arsyeshëm të decentralizimit, që do të implementohej brenda disa viteve, bashkësia ndërkombëtare do të jetë e gatshme ta pranojë atë. “Beogradi po dëshiron një Dayton. Ne dëshirojmë një Ohër”, vëren politikani Veton Surroi.¹³⁷ Marrëveshja është duke u negociuar në kohën kur po formohen dy apo tri komuna me shumicë serbe: Graçanica e madhe në Kosovën qendrore, Parteshi dhe fshatrat serbe përreth në Kosovën juglindore, dhe Mitrovica Veriore (e bashkuar ndoshta me Zveçanin) mbi lumin Ibër. Është inkurajuese sepse duket se Prishtina dhe Beogradi kanë filluar të afrojnë pozicionet. Shqiptarët e Kosovës janë të mendimit që të ofrojnë vetëm Graçanicën dhe Parteshin.¹³⁸ Këta e shohin pjesën veriore të Mitrovicës si nën-njësi të

¹²⁸ Shih raportin për intervistën e Slobodan Samarxhiqit dhënë TV stacionit të serbëve të Kosovës *MIR: “Këshilltari i Koshtunicës: Bisedimet për decentralizimin synojnë vënien e lidhjeve të drejtpërdrejta Beograd-serbët e Kosovës”*, VIP, 14 shkurt 2006.

¹²⁹ Rada Trajkoviç e cituar nga Jeta Xharra dhe Artan Mustafa, “Përçarjet shqiptare mund të pengojnë bisedimet për Kosovën”, BIRN, 14 tetor 2005. Shih: www.birn.eu.com

¹³⁰ Komunikata e lëshuar pas takimit në Prishtinë të Grupit të Kontaktit, mbajtur më 2 shtator 2004, thotë: “UNMIK-u dhe IPVQ-ja duhet të marrin parasysh fushat tjera të përgjegjësiive lokale siç është policia komunale”. Raporti i Eides i vitit 2004, rekomandon: “Involvimi i komunave si dhe përgjegjësitë e tyre sa i përket policisë duhet gjithashtu të merren në konsideratë... policia mono-etnike duhet të evitohet. Megjithatë, policia komunale është një koncept i dëshmuar dhe mund të jetë kontribut i vlefshëm në dhënien e garancive dhe fitimin e besimit të komunitetit serb”.

¹³¹ Ministri i brendshëm serb i kishte thënë UNMIK-ut se, ministria e tij ka personel prej 1,000 personash në Kosovë, disa nga ta në poste administrative. Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të lartë të UNMIK-ut, 31 gusht 2005.

¹³² Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 20 dhjetor 2005.

¹³³ Rregullorja numër 2005/54, “Mbi kornizën dhe parimet udhëheqëse të Shërbimit Policor të Kosovës”, 20 dhjetor 2005.

¹³⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, Bruksel, 5 janar 2006.

¹³⁵ Konferencë me gazetarë, Prishtinë, 14 dhjetor 2005.

¹³⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, Londër 10 janar 2006.

¹³⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 30 janar 2006.

¹³⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me Ministrin e qeverisjes lokale, Lutfi Hazirin, Prishtinë, 12 janar 2006.

Mitrovicës e jo komunë në veti. Kërkesa e Beogradit për komuna të reja me shumicë serbe është përqëndruar në katër zona: pjesa veriore e Mitrovicës, Kosova qendrore (Graçanica), Anamoravë (Kosova juglindore) dhe Dukagjini (Metohija) (Kosova Perëndimore).¹³⁹ Por, serbët janë të pakët në numër dhe tepër ruralë në këto dy lokacionet e fundit, që të mund të krijojnë komuna të qëndrueshme.

B. SHQIPTARËT E KOSOVËS

Shqiptarët e Kosovës janë të bindur se procesi ofron të vetmin rast për pavarësi dhe të heqin qafe Serbinë. Ata besojnë se më në fund, fuqitë e mëdha janë të gatshme që ta korrigojnë vendimin e marrë në Konferencën e Londrës më 1913 që la Kosovën dhe një pjesë të konsiderueshme të territoreve të banuara me shqiptarë jashtë kufijve të shtetit të ri shqiptar dhe nën sundimin e fqinjëve sllavë e ortodoks. Liderët e tyre nuk do të kenë guximin të pranojnë ndonjë zgjidhje që nuk quhet pavarësi apo që me lehtësi të pranojnë ndonjë aranzhman të përkohshëm apo pavarësi të paqartë në një paket me anëtarësimin në BE, pas një dekade. Arritja dhe marrja e attributeve simbolike të pavarësisë është e një rëndësie të madhe për shqiptarët, ndoshta edhe më e rëndësishme se sa atributet funksionale. Liderëve të tyre u nevojiten trofetë siç janë pranimit dhe ulësja në OKB, ambasadat si dhe ekipet kosovare në garat sportive ndërkombëtare.

Çasja ndaj negociatave për statusin është pothuajse një unilateralizëm paksa i maskuar. Politikanët janë zotuar se nuk do të negociojnë kërkesën për pavarësi. Ata kërkojnë që procesi të pranojë së pari sovranitetin e pastaj të kalohet në çështjen e decentralizimit dhe çështjet tjera të akomodimit të pakicave dhe e shohin me dyshim agjendën e imponuar të decentralizimit. Ata i frikësohen një ndarje të modelit të Bosnjës, që do ta lente një pjesë të territorit nën kontrollin e politikanëve serbë lokalë, lojalë ndaj Beogradit.

Koncepti i shqiptarëve të Kosovës për qeverisjen është defensiv, nostalgjik për vitet e 70-ta të Jugosllavisë dhe i centralizuar, pa një vizion konstruktiv për çështjen e decentralizimit që tani gëzon përkrahjen ndërkombëtare, veçanërisht pas trazirave të marsit 2004. Derisa Beogradi mundet që deri në një masë, të argumentojë se propozimet e Eides janë në përputhje me idenë e tyre për ndarjen administrative mes zonave serbe e atyre shqiptare,¹⁴⁰ shqiptarët e Kosovës nuk e kanë vënë ndonjë

lidhje në mes propozimit të tyre për decentralizim me rekomandimet e Eides.

Gjatë pjesës më të madhe të shekullit njëzet, identiteti i shqiptarëve të Kosovës është farkëtuar si rezistencë kundër serbëve, luftë kjo e cila ende nuk ka përfunduar. Projekti i tyre për Kosovën është projekt për një shtet të dytë shqiptar, jo për një shtet multi-etnik. Me lehtësi ata mund të thirren në përkrahjen e pakicave jo-serbe. Turqit, boshnjakët, goranët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët nuk mund të ledhatohen, nëse nuk rreshtohen përkrah shumicës shqiptare, edhe nëse kjo do të thotë se në fund të rrugës i pret asimilimi, ndërsa shqiptarët menjëherë i vënë ata në plan të dytë apo i përjashtojnë krejtësisht. Përkundër kërkesave të liderëve të tyre,¹⁴¹ pakicave jo-shqiptare, nuk iu ofrua një vend në ekipin negociator të shqiptarëve të Kosovës. Në vend të kësaj, ky ekip ka themeluar një nën-komision për të marrë opinionet dhe sugjerimet e përfaqësuesve të pakicave. Të detyruar që të bëjnë lëshime për serbët, shqiptarët duket se nuk do t'u kushtojnë vëmendje komuniteteve tjera.

Shqiptarët e Kosovës nuk tregojnë gatishmëri, që të ofrojnë për serbët diçka më tepër se programi i standardeve, implementimin e të cilave, OKB-ja e vlerëson çdo tre muaj. Ata në mënyrë rutinore i akuzojnë serbët se janë marioneta të Beogradit, por nuk bëjnë hapa që do t'i inkurajonin këta të fundit që të bëhen më të pavarur. Dialogu i brendshëm dhe vizitat e liderëve bërë komunitetit serb që synojnë të fitohet besimi, kanë filluar të ndodhin në kontekste të ndryshme, qoftë për të biseduar për standardet, decentralizimin apo në nën-komisionet për pakica të ekipit negociator, por kjo nuk ka rezultuar me një agjendë më të gjërë, ku do të bëheshin bashkë të gjitha këto përpjekje.

Pa vizion për të ardhmen e serbëve në Kosovë, dikush mund të dyshojë se, fshehurazi, shqiptarët shpresojnë se në fund ata do të shesin çfarë kanë dhe do të largohen. Çfarëdo propozimesh që vijnë nga shqiptarët apo që pranohen nga shqiptarët e Kosovës kanë nënkuptuar jo më tepër se garanci kushtetuese por jo edhe garanci institucionale apo diskriminim pozitiv, e të mos flasim për garanci territoriale.¹⁴² Arsyetim për këtë, sipas tyre, është se Kosova duhet të organizohet përgjatë vijave qytetare e jo etnike. Ideja e përgjithshme e shqiptarëve të Kosovës

Raportin e Grupit të Krizave: *Kosova: Drejt Statusit Final*, op. cit., fq. 16-17.

¹⁴¹ Kërkesë e Vatani, *Koha Ditore*, 17 janar 2006.

¹⁴² Në mars 2005 "Public International Law and Policy Group" i profesorit Paul Williams prezantoi draftin e kushtetutës, të autorizuar nga partitë e shqiptarëve të Kosovës. Në shtator 2005, një grup i studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës prezantoi një propozim të tyre sipas të cilit ombudpseroni do të ishte shtylla kryesore e mbrojtjes së të drejtave të pakicave.

¹³⁹ Pjesë të platformës të ekipit negociator të Serbisë, botuar në *Vecernje Novosti*, 9 janar 2006.

¹⁴⁰ Siç thuhet për shembull, në planin e prillit 2004: "Plani për zgjidhjen politike të gjendjes në Kosovë e Metohi". Shih

është se serbët “duhet të na besojnë” neve. Por, disa dëshirojë hakmarrje për vitet e nëntëdhjeta: “Ata atëherë na dhanë vetëm të drejta në letër; tani ne duhet t’ua bëjmë të njëjtën atyre”.¹⁴³ Sidoqoftë, shqiptarët e kuptojnë se serbët do të jenë realitet i Kosovës. Mosgatishmëria për të bërë koncesione tani rrjedh më tepër nga frika se do të rezultojnë me institucione jofunksionale, e jo nga ambiciet për pastrim të mëtutjeshëm etnik.

Kualiteti artificial dhe i përkohshëm i kësaj retorike për “standardet” ka penguar zhvillimin e një dialogu më kuptimplotë mes liderëve dhe opinionit publik. Ekziston një humnerë në mes të gjuhës zyrtare dhe asaj jozyrtare. Shprehjet dhe sjelljet në publik kanë tendencë të jenë të ngurta e hipokrite. Tani që shqiptarët e Kosovës kanë bërë mjaft në fushën e standardeve sa të mund të fillojnë bisedimet për statusin, serbët e Kosovës frikësohen se shqiptarët më nuk do të jenë të motivuar që të sillen mirë me ta.¹⁴⁴ Liderët e shqiptarëve të Kosovës japin një përshtypje se nuk kanë kuptuar plotësisht gjësimin që vjen nga poshtë në shoqërinë e tyre dhe për këtë shkak nuk janë edhe aq bindës për t’u besuar se do të kenë kontroll shtetëror mbi dhunën.¹⁴⁵ Kërkesa e liderëve të shqiptarëve të Kosovës për një orar më të shkurtër të procesit për statusin final tregon edhe këtë nervozë por edhe kërkon që të instrumentalizojë mu këtë. Përkundër zotimeve se dhuna nuk ka vend në proces, rreziku i përsëritjes së trazirave të marsit 2004 është një xhoker që shqiptarët e Kosovës nuk do ta hedhin nga dora.

Repertuari politik i shqiptarëve të Kosovës është shumë i kufizuar. Mbizotëron një shpresë e fshehur se kërkesat dhe vëmendja e bashkësisë ndërkombëtare mund të mos merren parasysh dhe pastaj të qiten në harresë. Klasa politike nuk tregon iniciativë që të bëjë projekte për zgjidhjen e sfidave të mëdha që kanë para vetes. Për shembull, ende ka një hezitim për t’u marrë me çështjen e Mitrovicës. Më tepër preferohet që të jenë spektator apo kritik i propozimeve të palës së tretë, përfshirë këtu edhe Grupin e Krizave.¹⁴⁶ Ideja e përgatitjes së opsioneve për ti

akomoduar serbët e Kosovës apo për ta bërë më të lehtë për Serbinë të kapërdijë humbjen e Kosovës e me këtë t’ia bëjë më të lehtë bashkësisë ndërkombëtare që të bëjë Beogradin kokëfortë që ta pranojë pavarësinë e Kosovës, nuk është zhvilluar në një mendim të qartë politik. Ka pasur shumë pak përpjekje të sinqerta për të kontaktuar me serbët apo madje edhe me njëri-tjetrin. Mungesa e përvojës administrative dhe niveli i arsimit, bëjnë që ky problem të haset edhe në nivelin komunal. Një përfaqësues komunal i UNMIK-ut vëren se kthimi dhe siguria e serbëve më tepër pengohen nga pazotësia dhe pasiviteti i zyrtarëve komunalë shqiptarë se sa nga dëshira për të bërë keq.¹⁴⁷ Një tjetër thotë se është mungesa e ekspertizës ajo që prodhon sjelljen e vrazhdë me pjesëtarët më të cenueshëm të shoqërisë.¹⁴⁸

Shqiptarët e Kosovës aq shumë janë mësuar që të mbajnë maskë saqë bashkësia ndërkombëtare ka filluar ta pyes veten nëse e kanë të qartë se mos maskat tani janë bërë fytyrat e tyre të vërteta. Disa janë të zemëruar me ndalesën e Grupit të Kontaktit që të bëhet bashkimi me Shqipërinë,¹⁴⁹ diçka që ka në vete një sentiment popullor ndonëse gëzon pak përkrahje të partive.¹⁵⁰ Por, me shtimin e ndërveprimit mes dy shoqërive shqiptare, inferioriteti i Kosovës në aspektin arsimor, kulturor e gjuhësor vetëm sa po bëhet më i qartë.¹⁵¹ Shqiptarët e Kosovës e konsiderojnë flamurin shqiptar si të tyrin dhe shumica prej tyre sigurisht do t’i trajtojnë simbolet e reja si imponim të pakëndshëm.¹⁵² Veteranët e luftës kanë grumbulluar dhe i kanë djegur publikisht flamujt e bërë sipas propozimit të Presidentit Rugova e

¹⁴⁷ Intervistë e Grupit të Krizave me Xavier Blais, Lipjan, 10 tetor 2005.

¹⁴⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me Anthony Thomson, Pejë, 9 dhjetor 2005.

¹⁴⁹ Moslejimi i ndërrimit të kufijve në Kosovë është një nga kushtet e avokuara gjatë, nga Grupi i Krizave dhe të tjerë, në kontekst të pavarësisë së kushtëzuar. Shih Raportin e Grupit të Krizave, *Kosova: Drejt Statusit Final*, op. cit., dhe Raportin e Grupit të Krizave, *Pas Milosheviqit*, op. cit.

¹⁵⁰ Dy suksese të skenës së pop muzikës – kënga rep “Albanian” në vitin 2005 dhe “Ethet e të premtës mbrëma” në të cilat u prezantuan këngëtarë të qyteteve nga hapësira shqiptare sikur kjo të mos kishte kufij – tregojnë një masë të përkrahjes popullore, por anketat e shtatorit 2005 tregojnë se ndonëse përkrahja për bashkimin me Shqipërinë është dyfishuar në periudhën tremujore, ajo është në shkallën vetëm 10 për qind. Shih: “Early Warning System Fast Facts”, UNDP, numër 11. <http://www.kosovo.undp.org/publications/publications.asp>.

¹⁵¹ Programet e TV kanaleve private të Shqipërisë shikohen nga shqiptarët e Kosovës por jo edhe anasjelltas. Shqiptarët e Kosovës ndihen më inferiorë sa i përket gjuhës: dialekti i tyre dallon dukshëm nga gjuha shqipe e standardizuar, të cilën jo të gjithë e shkruajnë në mënyrë të përgjegjshme.

¹⁵² Intervista të bëra në rrugë nga KTV kah mesi i nëntorit 2005, dhe debati në internet “Vakti i flamurit tu Kosovës”, në: <http://groups.google.com/group/prishtina-team/>.

¹⁴³ Pikëpamjet e një administratori në moshë të mesme, Prishtinë, rast i raportuar Grupit të Krizave, dhjetor 2005.

¹⁴⁴ E dhënë e dalë nga disa hulumtime në lokacione specifike të bëra nga CDA, për të vlerësuar programin e ndërtimit të paqes në Kosovë, prezantuar në një seminar në Prishtinë, 16-17 nëntor 2005.

¹⁴⁵ Ata kështu dallojnë nga elitat e shumë vendeve në tranzicion, që “nuk japin përshtypjen se i frikësohen shoqërisë civile të tyre”. Observim i Bruce Jackson, kryetar i Project of Transitional Democracies (Projekti i Demokracive Tranzicionale), që krahason liderët e shqiptarëve të Kosovës me liderët e Ukrainës dhe Gjeorgjisë. Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 25 nëntor 2005.

¹⁴⁶ Shih komentet e Augustin Palokajt, korrespondent nga Brukseli i gazetës *Koha ditore*, bërë për këtë çështje në filmin dokumentar të BIRN-it “A ka dikush një plan?”

të cilët komuna e Prishtinës, e kontrolluar nga LDK-ja, i kishte vendosur së bashku me flamujt shqiptarë me rastin e festës së 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, në vitin 2005. Shtetësia nuk është ende koncept krejtësisht i qartë për shqiptarët e Kosovës. Shumica ende nuk e kanë bërë hapin e kalimit nga dëshira për “pavarësi” tek nevoja për të punuar për të ndërtuar shtetin e ri.

Të ftuar që të bëjnë kompromis në kërkesat maksimaliste, në çerekun e fundit të vitit 2005, politikanët formuluan frazën “kompromisi ynë është pavarësia”. Me këtë dëshirohej të thuhet se kërkesë maksimale do të ishte ajo për bashkim me Shqipërinë. Përkundër kushtit paraprak për negociatat se Kosova “nuk do të ketë pretendime ndaj një territori përtej kufijve të saj si dhe nuk do të merret me pretendimet ndaj territorit të saj”, që nga nëntori 2005, Veton Surroi ka kultivuar kërkesat për autonomi të shqiptarëve në Luginën e Preshevës në Serbinë Jugore, si mjet për të penguar bashkësinë ndërkombëtare e njëkohësisht edhe Beogradin, që të kërkojnë tepër shumë autonomi për serbët në veri të Kosovës. Ky aktivitet rrezikon me hapjen e Kutisë së Pandorës të pretendimeve për territore të ndryshme në tërë Ballkanin. Kur miratuan deklaratën e tyre politike, më 14 janar 2006, shqiptarët e Luginës së Preshevës së paku nuk votuan për propozimin që Lugina të quhet përsëri “Kosovë Lindore”. Megjithatë, kërkuar bashkim me Kosovën nëse komunat veriore të Kosovës i bashkohen Serbisë.¹⁵³

Reagimet e ftohta të Prishtinës ndaj propozimeve të Grupit të Krizave për zgjidhjen e problemit të Mitrovicës, tregojnë çasjen “gjithçka ose asgjë” në lidhje me ri-integrimin e territorit gjysmë-të-ndarë e të dominuar nga serbët në veri të Kosovës.¹⁵⁴ Shumë shqiptarë më me dëshirë do të hiqnin dorë nga një pjesë në veri të Kosovës se sa të negociojnë gjatë një marrëveshje me serbët, që sipas të gjitha gjasave, megjithatë do t’u japë atyre një autonomi praktike nëse jo edhe formale. Heqja dorë nga veriu mund të shikohet si prelude e mjaftueshme për bashkimin e më vonshëm me territoret fqinje të banuara me shqiptarë. Megjithatë, reagimi i Prishtinës është më pak shprehje e militantizmit e më shumë është shprehje e bezdisë me përmendjen e çështjes së Mitrovicës. Problemet e mëdha më me dëshirë anashkalohen.

Më 17 nëntor 2005, partitë politike të shqiptarëve të Kosovës i unifikuan qëndrimet e tyre rreth pavarësisë

kur Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi “Rezolutën për Rikonfirmimin e Vullnetit Politik të Popullit të Kosovës për Kosovën Shtet të Pavarur e Sovran”. Rezoluta njeh kontributin e rezistencës pasive të udhëhequr nga LDK-ja si dhe luftën e udhëhequr nga UÇK-ja, përmend referendumin për pavarësi të vitit 1991 dhe premtion një referendum të ri. Varrimi i Presidentit Rugova më 26 janar ka shënuar afrim tjetër të LDK-së e UÇK-së. Trupat Mbrojtëse të Kosovës, të dala nga UÇK-ja, bënë edhe rojën e nderit edhe përshëndetën me të shtëna gjatë ceremonisë së varrimit.¹⁵⁵

Kërkesat politike të shqiptarëve të Kosovës eskalojnë në ide maksimaliste e joreale sa herë që formulat e bashkëpunimit ndër-partiak dështojnë. Kjo u pa qartë kah fundi i vitit 2005, para themelimit të grupit negociator. Politikanët u shprehën se pavarësia “e kushtëzuar” ishte e tejkualuar dhe e pamjaftueshme,¹⁵⁶ përkundër mesazheve të qarta nga bashkësia ndërkombëtare se UNMIK-u duhet të pasohet nga një mision tjetër. Të gjithë nxituan, kush më i pari, që të shpallin në Kuvend pavarësinë e Kosovës, derisa SHBA-ja dhe UNMIK-u nuk i bindën, që të pajtohen me rezolutën e përmendur më lartë.¹⁵⁷ Në anën tjetër, kur ekipi negociator u bë bashkë dhe ia filloi punës pengesat dhe mosmarrëveshjet filuan të eliminohen. Në dhjetor 2005 e janar 2006, atmosfera ndryshoi (qetësua) dhe u vërejt një gatishmëri më e madhe për kompromis. Dallimet mes qëndrimeve publike e atyre private tani kanë filluar të ngushtohen. Zgjedhja e shpejtë dhe e qetë e Fatmir Sejdiut, për të zëvendësuar Presidentin Rugova, e pasuar me vazhdimin e përgatitjeve në një atmosferë pune, për takimin e 20 shkurtit 2006, premtion progres të mëtutjeshëm.

¹⁵⁵ Kjo nuk kaloi pa pakënaqësi të ish-luftëtarëve. Garda ceremoniale e TMK-së, e udhëhequr nga Nuredin Lushtaku nga Drenica, refuzoi që të marrë pjesë në ceremonitë mortore. Veteranët e UÇK-së protestuan duke thënë se Rugova nuk e meriton të prehet në varrezat e martirëve. Disa i trazuan punëtorët që po përgatitnin varrin. Pas funeralit, veteranët diskutuan mundësinë e zhvarrimit të të rënëve të UÇK-së dhe varrimin e tyre në një lokacion tjetër.

¹⁵⁶ Më së shumti u dallua lideri i PDK-së Thaçi i cili hoqi dorë nga të qenurit i hapur për pavarësinë e kushtëzuar duke favorizuar “pavarësinë e plotë”. Akuzat plot pezëm u dëgjuan në tërë Kosovën kur Ministri i jashtëm i Shqipërisë, Besnik Mustafaj, kah fundi i shtatorit u shpreh se zgjidhja më e mirë do të ishte pavarësia e kushtëzuar. Blerim Shala, koordinator i grupeve punuese të negociatave për statusin, qe akuzuar se nuk është mjaft patriot kur foli për këtë temë. Ai u mbrojt në një TV intervistë më 30 tetor, duke shpjeguar se pasi të gjitha palët janë në favor të vazhdimit të prezencës së KFOR-it dhe përdorimit të Euros, kjo e bënë të qartë se Kosova nuk do të ketë pavarësi të plotë.

¹⁵⁷ Madje edhe partia (ORA), zëdhënësi i të cilës, shprehu dyshime për rezolutën tha se do të votonte për të që të mos shihet si “pengesë”.

¹⁵³ Paragrafi i fundit i dokumentit të miratuar deklaroi: “në mbështetje të parimeve të Grupit të Kontaktit në lidhje me statusin e Kosovës, këshilltarët janë të obliguar që nëse këto parime nuk respektohen dhe kufijtë e saj ndërrohen, të punojnë për unifikimin e Luginës së Preshevës me Kosovën”.

¹⁵⁴ Shih raportin e Grupit të Krizave, *Zgjidhje për Mitrovicën, jo ndarje të Kosovës*, op. cit.

Vera e vonë dhe vjeshta e hershme e vitit 2005 dhanë një ide se çfarë efektesh anësore do të shkaktonte mosfunksionimi në nivel qëndror. Në pjesë të ndryshme të vendit, grupe të ndryshme të armatosura, të reja, paraqiteshin gati çdo dy javë. Edhe pse të dobëta dhe të përbëra nga ekstremistë dhe kriminelë, atmosfera e paqartë ua bëri më të lehtë që të tërheqin vëmendjen e opinionit. Në Prishtinë dhe në qytetet tjera, VETËVENDOSJA e Albin Kurtit¹⁵⁸ i bëri për vete mediat me platformën e tij se nuk duhet të ketë negociata, se Kosova duhet të dëbojë UNMIK-un e KFOR-in me demonstrata gjithë-popullore.¹⁵⁹ Në muajin gusht, lideri i PDK-së, Hashim Thaçi, shkurtazi u muar me idenë që t'i "hipë këtij kali" dhe të thërrasë demonstrata për referendum për pavarësinë.¹⁶⁰

Shqiptarët e Kosovës nuk e kuptojnë mirë nevojën që ta argumentojnë qëndrimin e tyre dhe ku ta bëjnë këtë. Këta besojnë se pretendimet e tyre kundër Serbisë për prona, asete dhe dëme të luftës janë evidente, vetvetiu. Deri në dhjetor 2005, detyra e mbledhjes së këtyre të dhënave i ishte dhënë një njësie të injoruar të Ministrisë së Financave, stafi i të cilës nuk fliste as gjuhën angleze e as nuk ishte në gjendje të ndërtonte një aktakuzë.¹⁶¹ Me mungesë të kulturës gjyqësore, shqiptarët e Kosovës kanë deponuar vetëm disa akuza individuale për dëme të luftës, derisa serbët, të inkurajuar nga Beogradi, kanë depozituar mbi dhjetë mijë raste nëpër gjyqet e Kosovës.¹⁶² Kjo i ka vënë shqiptarët në pozitë të palakmueshme edhe ndoshta të cënuar jo nga një invazion i ri serb, jo nga tanket por nga ankesat gjyqësore.

C. BEOGRADI

Në Beograd, politikanët vazhdojnë të trajtojnë Kosovën, si pronë të tyre që do ta ndajnë në pjesën serbe dhe atë shqiptare duke mbajtur për vete sa më shumë që të jetë e mundur nga trashëgimia kulturore e religjioze, ose si armë për luftën e brendshme politike. Rrallë merren parasysh nevojat e vërteta të serbëve të Kosovës. Çasja shtet-centrikë shihet në përbërjen e ekipit negociator të Serbisë, që ka shumë analistë të Beogradit dhe vetëm dy nga ta

janë serbë të Kosovës.¹⁶³ Edhe këta dy kanë lidhje të afërta me Beogradin; që të dytë jetojnë në veri të Ibrit në pjesën me shumicë serbe dhe nuk përfaqësojnë shumicën e serbëve të Kosovës që jetojnë në jug të lumit, nëpër enklava të izoluar. Përfaqësimi më i gjërë i është deleguar nën-komisioneve për trashëgiminë kulturore, ekonomi, kthime dhe decentralizim.

Pasi ka pranuar të jetë pjesë e procesit, Beogradi shpreson që të ndikojë që vendimi i Këshillit të Sigurimit të jetë sa më minimal dhe shumëvalent, që të mos e përmend pavarësinë si dhe të shfrytëzojë negociatat që të shpëtojë fytyrën e që të evitojë problemin që brenda të shihet si humbës, derisa të gjejë një mënyrë ose të vonojë në afat të pa caktuar, pavarësinë ose që ta nxjerrë nga binarët krejtësisht. Politikanët e Beogradit duket se janë të gatshëm që ta pranojnë një vetëqeverisje praktike për shqiptarët e Kosovës nëse kjo e eviton pavarësinë formale, siç thotë edhe parulla e paqartë "më shumë se autonomi, më pak se pavarësi". Megjithatë, qeveria nuk e ka përkthyer këtë në propozime specifike, gjë të cilën, ministri i jashtëm rus, Lavrov, në nëntor 2005, u kërkoi atyre ta bënin.¹⁶⁴ Në negociata, Beogradi do të mundohet të nxjerrë territoret që i interesojnë, përfshirë kishat e manastiret, nga kontrolli direkt shqiptar dhe të bëhet titullar i sa më tepër pronave, asetëve dhe resurseve që të jetë e mundur. Por, pa marrë parasysh se çfarë koncesione ofrohen, politikanët e Beogradit nuk ka gjasa që nënshkruajnë ndonjë rezolutë që i jep Kosovës pavarësi, të çfarëdo forme qoftë.

Një këshilltar i kryetarit Tadiq vëren se dinamika "çështje pas çështje" do të shfrytëzohet nga bashkësia ndërkombëtare që ta shpallë "pranimin e kërkesave tona individuale, siç është decentralizimi... si kompensim për pajtimin me pavarësinë e kushtëzuar".¹⁶⁵ Ministri i jashtëm Drashkoviç avokon nënshkrimin e marrëveshjeve një nga një për secilën çështje që diskutohet, e jo në paketë, dhe me këtë të mbajë pavarësinë jashtë ekuacionit.¹⁶⁶ Ndonëse nuk vërehet në shikim të parë, kjo do t'i mundësonte Serbisë që të mbetet e involvuar në proces në pjesën më të madhe dhe të largohet vetëm kah fundi, kur do të imponohet çështja e statusit. Atëherë nuk do të ketë nevojë që ndonjë politikan të marrë mbi vete nënshkrimin për dhënien e Kosovës ndërsa ndarja me bashkësinë ndërkombëtare do të minimalizohet e përfitimet nga procesi negociues do të ishin maksimale.

Bashkësia ndërkombëtare duket se është e vetëdijshme për kufizimet politike të Beogradit dhe shpreson që ta

¹⁵⁸ Lider studentor karizmatik, i arrestuar më 1999 dhe i mbajtur në burg në Serbi deri në dhjetor 2001.

¹⁵⁹ Kjo lëvizje urbane e të rinjve është bërë lajm falë aksioneve provokuese: shkrimi i grafitëve në ndërtesa dhe në veturat e UNMIK-ut; gjuajtja me vezë e vizitorëve nga Serbia dhe e selisë së UNMIK-ut; derdhja e ngjyrës së kuqe në hyrjet në Kuvendin e Kosovës për të penguar deputetët; duke i ftuar hakerët që të sulmojnë veb-sajtin e KFOR-it apo duke ua shfrytëzuar gomat veturave të UNMIK-ut.

¹⁶⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 31 gusht 2005.

¹⁶¹ Intervistë e Grupit të Krizave me Adil Fetahun, sekretar i Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve, Prishtinë, 24 gusht 2004.

¹⁶² Shqiptarët kanë bërë jo më shumë se 3.000 ankesa.

¹⁶³ Marko Jakshiq dhe Goran Bogdanoviç.

¹⁶⁴ "Lavrov: Serb, bëhuni konkret", *Kurir*, 8 nëntor 2005.

¹⁶⁵ Leon Kojen, i cituar nga *Blic*, 2 dhjetor 2005.

¹⁶⁶ Komente të cituara nga *Tanjug*, 24 dhjetor 2005.

mbajë atë në negociata sa më gjatë që të jetë e mundur, që të sigurohet pjesëmarrje dhe kontributi sa më i madh i Serbisë në rezultatin final. Grupi i Kontaktit dhe Ahtisaari dëshirojnë që Beogradi ta shfrytëzojë procesin që ti përmirësojë kushtet e jetës për serbët në Kosovë si dhe shohin rol për Serbinë në çështjen e madhësisë, mandatit dhe kompetencave të misionit të ardhshëm ndërkombëtar, duke supozuar se ajo do të preferonte një prezencë ndërkombëtare më të gjatë, më gjithëpërfshirëse dhe më të fuqishme. Megjithatë, Ahtisaari dhe ekipi i tij kanë bërë të ditur se synojnë një marrëveshje të vetme e jo një meny nga e cila Serbia mund të porosisë çfarë dëshiron.

1. Çfarë statusi?

Çdo ambicje e Beogradit, që të sundojë drejtpërdrejt mbi shqiptarët e Kosovës është zhdukur, por në shtator 2005 kryetari Tadiq insistonte se Serbia nuk mund t'ua kthejë shpinën 100.000 serbëve, që jetojnë në Kosovë e as territorit të vet historik.¹⁶⁷ Po të njëjtin muaj, koordinatori për Kosovë, Rashkoviç-Iviç, propozoi që Serbia të mbajë sovranitetin, kontrollin e kufijve të Kosovës, të ketë një mbikëqyrje të lehtë mbi politikën doganore dhe fiskale dhe kompetenca në mbrojtje dhe përfaqësim ndërkombëtar, ndërsa Kosova të ketë të gjitha atributet tjera ekzekutive e legjislativ me sistemin e vetë gjyqësor.¹⁶⁸ Kah mesi i nëntorit 2005, Ministri i jashtëm Drashkoviç sugjeroi që shqiptarët të kenë “pavarësi të brendshme”, “forca të armatosura, polici, legjislativ, taksa dhe çfarëdo force tjetër”, anëtarësim të plotë në organizatat ndërkombëtare përveç OKB-së, por po në FMN, Bankën Botërore dhe Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit – por që kufijtë e jashtëm të Serbisë të mos preken.¹⁶⁹

Muajin pasues, burime nga qeveria lansuan idenë e përcaktimit të një autonomie të gjerë për Kosovën, me garanci ndërkombëtare: “Këto garanci do të siguronin që ne nuk do të mund të heqim këtë autonomi, por se edhe shumica shqiptare nuk mund të kërkojë pavarësi”.¹⁷⁰ Në këtë mënyrë, Beogradi do të përpiquej që të largonte frikën e shqiptarëve të Kosovës nga përsëritja e heqjes së dhunshme të autonomisë siç kishte bërë Milosheviqi. Megjithatë, sa më shumë attribute praktike të shtetësisë që Beogradi t'i pranojë për Kosovën, që realisht edhe duhet të bëjë, aq më vështirë do të jetë të arsyetohet

mbajtja e frenave të fundit, siç janë ministria e jashtme me ambasadat si dhe ulësen në OKB.¹⁷¹

Qëndrimi i Beogradit kundër pavarësisë është i dominuar me argumente legaliste e në dëm të funksionalitetit dhe zhvillimit të Kosovës. Më 24 tetor 2005, kryeministri Koshtunica para Këshillit të Sigurimit u shpreh se “të copëtosh një shtet demokratik... kundër dëshirës së tij... do të... ishte rast i paprecedent në ligjin ndërkombëtar dhe në praktikën e Kombeve të Bashkuara”, që do të cenonte ligjin ndërkombëtar të ndërtuar mbi parimin e moscenueshmërisë territoriale të shteteve sovraane e të barabarta. Këtu, si edhe në rezolutën e Kuvendit të datës 21 nëntor, Serbia kërkonte nga Këshilli i Sigurimit që, siç e ka për detyrë, t'ia garantojë integritetin territorial. Por, ajo nuk ka marrë parasysh kërkesat që dalin mu nga elementi i sovranitetit (siç është “përgjegjësia për të mbrojtur” e artikulluar nga Komisioni Ndërkombëtar për Intervenime dhe për Sovranitetin e Shteteve,¹⁷² i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në shtator 2005) në situatat si ajo në Kosovë, kur lidhja mes qytetarëve dhe shtetit është shkëputur aq qartë nga ky i fundit.

Edhe pse thotë se Serbia-Mali i Zi është shtet demokratik, Beogradi nuk ia del të tregojë se si në praktikë do të integronte Kosovën në këtë demokraci: qoftë si anëtare e tretë e Unionit shtetëror Serbi-Mali i Zi, që edhe ashtu është duke i kaluar afati, me përfaqësim proporcional në postet kryesore; qoftë duke iu bashkuar një politike në të cilën Partia Radikale Serbe, e egër dhe anti-shqiptare, gëzon mbështetjen e gati 40 për qind të opinionit. Beogradi është treguar i paafte edhe që të merret me historinë destruktive të viteve 90, shembull ky i amnestisë kolektive që vetëm sa shton frikën e shqiptarëve.

Strategjia e re e bashkësisë ndërkombëtare, karrotës dhe shkopit, duke shfrytëzuar integrimin evropian, që ta shtyjë Serbinë që ta pranojë pavarësinë e Kosovës është e bazuar në kalkulime të dyshimta, se opinionit dëshiron këtë integrim me çdo kusht. Por, 71 për qind e deputetëve të parlamentit të Serbisë vijnë nga partitë që ose janë haptazi armiqësore kundër Evropës apo në rastin më të mirë janë euro-skeptikë. Një politikan beogradas mendon se vetëm rreth 100.000 votues të regjistruar janë të motivuar me integrimet evropiane.¹⁷³

¹⁶⁷ “Serbia nuk mund ta braktis Kosovën, thotë Tadiq”, Raporti ditor i lajmeve, VIP, 23 shtator 2005.

¹⁶⁸ Intervistë në *Danas*, “Serbisë sovraniteti, Kosovës pushteti ekzekutiv, legjislativ e gjyqësor”, 22 shtator 2005.

¹⁶⁹ Intervistë e *Frankfurter Rundschau*, 16 nëntor 2005.

¹⁷⁰ *Vecernje Novosti*, 16 dhjetor 2005.

¹⁷¹ Shih Judy Batt, *The Question of Serbia*, (Çështja e Serbisë) “Chaillot Paper” numër 81, gusht 2005, për një elaborim më të gjerë të etjes së Serbisë që të mbajë Kosovën si territor ndërsa duke mos i pranuar obligimet ndaj popullatës së saj shumicë.

¹⁷² Shih raportin e dhjetorit 2001, në <http://www.iciss.ca/report-en.asp>.

¹⁷³ Intervistë e Grupit të Krizave me një politikan serb, Beograd, shkurt 2006.

Qëndrimet dhe politika e Serbisë në raport me Kosovën janë të thelluara në një ambient në të cilin nuk pinë ujë ideja e “karotës dhe e shkopit” e bashkësisë ndërkombëtare. Pasi kishte dëgjuar ministrin Rus Lavrov, i cili u shpreh kundër zgjidhjeve të imponuara, Koshtunica nxitoi të konkludonte se “shpresat për pavarësi të kushtëzuar janë të kota... fati i Kosovës është më së shumti në duart tona”.¹⁷⁴ Kryetari Tadiq insistonte se “Kosova nuk është në shitje. Është e paimagjinueshme se një vend demokratik duhet të hyjë në BE nën këto kushte”.¹⁷⁵ Kur Ministri i jashtëm i Sllovenisë, Rupel apo ai rus, Lavrov, thonë se nuk mund të ketë zgjidhje të përhershme pa pajtimin e Serbisë, Beogradi e interpreton këtë si leje që të mos pajtohet fare.

Tensioni që e shkakton mënyra se si shkruhet për Kosovën në mediat e Serbisë është terren i frytshëm për aleancën joformale të DSS-së me partnerë nga koha e Milosheviqit, SPS dhe SRS, si dhe me organet e sigurisë por edhe me grupin votues më të madh. Por, edhe nëse Kosova është kthyer përsëri në vëmendjen e opinionit,¹⁷⁶ tani emocionet janë krejt tjera nga ato në vitet 90-ta. Njerëzit janë lodhur me fjalimet për Kosovën ndërsa kanë filluar të lodhen edhe me idenë se Kosova mund të humbet. Gati gjysma e atyre që janë anketuar në nëntor 2005 e shihnin pavarësimin e Kosovës si rezultat më të mundshëm të negociatave për statusin. Vetëm 21 për qind preferonin të luftonin për të mbajtur Kosovën, ndërsa 45 për qind preferojnë që Kosovës ti lejohet të ndahet nga Serbia.¹⁷⁷ Një organizator i një ankete të tillë thotë se përpjekjet e qeverisë që të “ringjallë... shpresën se Kosova mund të shpëtohet” ishin kundër-produktive pasi që do të jetë vështirë të arsyetohet humbja e saj.¹⁷⁸

Edhe pse duket se nën sipërfaqe ekziston dëshira për normalizim të jetës, integrim në Evropë dhe për zhvillim ekonomik, politikanët mendojnë se ndjenjat nacionaliste që janë më të dukshme në sipërfaqe, i obligojnë ata që të marrin qëndrim më të skajshëm në raport me Kosovën dhe të mbajnë sa më shumë që të jetë e mundur nga ajo që ka pasur Serbia në vitet e nëntëdhjeta. Një diplomat perëndimor vëren se Serbia mund të ketë nevojë për një

katarzë më të dhimbshme – të humbjes së Kosovës – që të mund të ndryshojë drejtimin (të këndjellit).¹⁷⁹ Por, disa politikanë serbë këmbëngulin se formula “territor në këmbim të zhvillimit” nuk do të pranohet kurrë dhe se përpjekjet për ta imponuar atë do ta kthejnë vendin kundër Evropës përgjithmonë.¹⁸⁰

Edhe pse kryetari Tadiq ka tërhequr vërejtjen, në tetor 2005, se zgjidhja mund të imponohet nga jashtë, spektri nacionalist ende mendon se e drejta legale për të refuzuar të pajtohet me pavarësinë është një nga letrat më të forta. Rezoluta e Parlamentit të Serbisë, e përpiluar dhe e miratuar nga DSS, SRS dhe SPS, pak para fillimit të bisedimeve, thotë se Serbia do të shpallte çfarëdo zgjidhje të imponuar “jo legjitime, ilegale dhe të pavlefshme”, duke u vënë përkrah qëndrimin të patriarkut Pavle të Kishës Ortodokse Serbe, se një akti tillë i “marrjes së territorit” do të ishte okupim.¹⁸¹ Sekretari i përgjithshëm i SRS-së, Aleksander Vuçiq, është i mendimit se mospajtimi do të “mbante gjallë gjasat që statusi i Kosovës të diskutohet pas pesë, njëzet apo 30 vite, në rrethana tjera më të volitshme”.¹⁸² Por kjo në të njëjtën kohë do të inkurajonte eksodin e serbëve nga Kosova dhe do ta bënte më të vështirë për bashkësinë ndërkombëtare, që ti bindë liderët e shqiptarëve të Kosovës t’u japin më tepër serbëve të Kosovës.

Në ditët pas raporteve për atë se çfarë ka deklaruar Sawers, drejtori politik i MB-së, gjuha e Beogradit në raport me Kosovën vetëm sa u bë edhe më e rëndë. Nënkryetari i Partisë Radikale, Tomislav Nikoliq, më 10 shkurt 2006 deklaroi se është dakorduar me Koshtunicën që nëse Kosova bëhet e pavarur, “Parlamenti kombëtar i Republikës së Serbisë do të miratojë një rezolutë, e cila menjëherë do ta shpallte pavarësinë, si okupim të një pjese të territorit të Serbisë dhe do t’i ngarkonte të gjithë ata që kanë detyrë kushtetuese ta mbrojnë integritetin dhe territorin e Republikës së Serbisë që të mbrojnë Serbinë me të gjitha mjetet”.¹⁸³ Qeveria nuk e komentoi këtë deklaratë për dy ditë, e pastaj lëshoi një deklaratë të paqartë që nuk prekte interpretimin e Nikoliqit, gjatë bisedës me Koshtunicën, por në vend të kësaj kritikonte ata që thonë se Kosova është humbur duke thënë se po përhapin disfatizëm.¹⁸⁴ Deklarata e Nikoliqit është kritikuar nga një numër i politikanëve opozitarë si dhe

¹⁷⁴ “Fati i Kosovës ‘në duart tona’, thotë Kryeministri”, B-92, 10 nëntor 2005.

¹⁷⁵ Intervistë në *Rossiyskaya Gazeta*, 17 nëntor 2005.

¹⁷⁶ Për shembull, një anketë e zhvilluar nga *NIN*, më 12 nëntor 2005, ka treguar se Kosova ka dalë nga pothuajse harresa totale, dhe nga 43,5 për qind e respondentëve, konsiderohet si çështja më e rëndësishme kombëtare, para ekonomisë (10 për qind) dhe anëtarësimit në BE (4,5 për qind).

¹⁷⁷ *Ibid.* Gjatë bombardimeve të NATO-s në mars 1999, gati 70 për qind e respondentëve të anketave ishin në favor të mbrojtjes së Kosovës e vetëm 18 për qind ishin për atë që të hiqet dorë nga ajo, përmbledhja e lajmeve ditore, *VIP*, 18 nëntor 2005.

¹⁷⁸ Sociologu Srećko Mihajlović, i cituar nga Raporti ditor *VIP*, 25 nëntor 2005.

¹⁷⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, Londër, 10 janar 2006.

¹⁸⁰ Intervistë e Grupit të Krizave me Marko Jakshiq, veri i Mitrovicës, 3 shkurt 2006.

¹⁸¹ Deklaratë e bërë nga Sinodi i Shenjtë i Peshkopëve të Kishës Ortodokse Serbe, 6 nëntor 2005, në përkrahje të kryeministrit Koshtunica, pas adresimit të tij Sinodit.

¹⁸² Deklaratë e botuar në *Vecernje Novosti*, 3 nëntor 2005.

¹⁸³ “Serbinë ta mbrojmë me të gjitha mjetet”, *B92*, 10 shkurt 2006.

¹⁸⁴ “Qeveria e tha fjalën e vet”, *B92*, 12 shkurt 2006.

nga Ministri i jashtëm Drashkoviç, dhe të gjithë këta e quajtën këtë kthim në retorikën dhe politikën e viteve 90-ta. Një nga politikanët e dalluar të Serbëve të Kosovës, Oliver Ivanoviç, i quajti fjalët e Nikoliqit si joproductive për serbët e Kosovës.¹⁸⁵

Nikoliq është lider i partisë më të madhe parlamentare në Serbi, popullariteti i të cilës i afrohet shkallës 40 për qind dhe përkrahja e së cilës është qenësore për mbijetesën e qeverisë së Koshtunicës. Komentet e tij paraqesin mendimin popullist, emëruesin më të ulët të përbashkët të shumicës së elektoratit. Që prej atëherë, ai ka bërë thirrje që Serbia të tërhiqet nga negociatat nëse shihet se statusi i Kosovës është caktuar paraprakisht.¹⁸⁶ Këshilltari për Kosovë i Koshtunicës, Aleksandar Simiq, ka reaguar në deklaratat e Nikoliqit dhe të Sawersit duke thënë se Serbia kurrë nuk do të pranojë pavarësinë e Kosovës dhe nëse ajo bëhet e pavarur do të ruante të drejtën që një ditë “të kthejë atë që ilegalisht e ka humbur”.¹⁸⁷ Ai gjithashtu ka bërë thirrje që, nëse do të jetë e nevojshme, Serbia të mbajë një referendum për pavarësinë e Kosovës, ide që është përkrahur nga kryesuesja e Qendrës Koordinuese, Rashkoviç-Iviç.¹⁸⁸ Një referendum i tillë nuk do të bënte asgjë më tepër se sa të jepte hapësirë publike për të shprehur pikëllimin dhe frustrimin.

Lajm i mirë është se Serbia zyrtare nuk shih dobi në përdorimin e dhunës, së paku në këtë kohë¹⁸⁹ dhe ka përfunduar fuqishëm çfarëdo intervenimi ushtarak në veri të Kosovës. Aktualisht, armata është e dobët, më së shumti falë problemeve buxhetore dhe marrjes së shumëanshme me prokurime të dyshimta. Edhe pse Nikoliq ka përsëritur deklaratën e tij për të mbrojtur Serbinë me të gjitha mjetet, ai gjithashtu thotë se nuk ka bërë thirrje për luftë.¹⁹⁰ Ai ka tërhequr paralele mes Kosovës dhe teritoreve të okupuara palestineze.¹⁹¹ Grupet militante nacionaliste, jo-zyrtare, në lidhje me shërbimet e sigurimit dhe me Partinë Radikale, ende kanë kapacitet që të shkaktojnë trazira, veçanërisht në Kosovën veriore dhe

në Sanxhakun aty afër.¹⁹² Megjithatë, në pjesën më të madhe, zhurma politike e bërë në javët e fundit mund të mos jetë asgjë më tepër se rrahje gjoksi dhe shtëngim i dhëmbëve, që do ta shoqërojnë të kuptuarit dalë-ngadalë se Kosova vërtetë është humbur dhe nuk do të mbetet nën sovranitetin e Serbisë.

Vërejtjet e vazhdueshme që vijnë nga liderët në Beograd se pavarësia e Kosovës do të destabilizonte rajonin janë më tepër kërcënime të tërthorta se sa analiza reale. Me këtë, mendohet të thuhet se do të shtohet radikalizmi në Serbi (“SRS do ta marrë pushtetin”) si dhe shtim i apetitit të Serbisë për të aneksuar Republikën Serbe në Bosnjë.¹⁹³ Deklarata e kryetarit Tadiq e bërë në fillim të janarit 2006 është tipike: “Pavarësia... do të mund të destabilizonte jo vetëm Serbinë e Malin e Zi, por edhe tërë rajonin. Unë jam kundër destabilizimit të vendeve tjera”.¹⁹⁴ Por, për dallim nga këto deklaratat, fqinjët tjerë të Kosovës – Mali i Zi, Maqedonia dhe Shqipëria – kanë thënë publikisht se nuk u pengon pavarësia. Protestat diplomatike, që u ka adresuar këtyre vendeve pasi pozicioni i tyre ndaj Kosovës ka evoluar, tregon se Beogradi nuk është në hap me zhvillimet në rajon.¹⁹⁵ Edhe ashtu Serbia ishte vonuar që ti njohë shtetet e dala nga ish-Jugosllavia, duke e bërë këtë, vetëm dhe atë me vite të tëra, pasi këtë e kishte bërë bashkësia ndërkombëtare.

Maqedonia vazhdimisht ka përsëritur se pranon çdo zgjidhje që nuk e kërcënon sovranitetin dhe integritetin e saj territorial dhe që respekton normat ndërkombëtare.¹⁹⁶ Shqipëria meriton lavdata për

¹⁸⁵ “Pa reagime të qeverisë” B92, 11 shkurt 2006.

¹⁸⁶ Deklarata të Tomislav Nikoliqit në TV emisionin me shikueshmëri të lartë “Upitnik” në RTS1, 14 shkurt 2006.

¹⁸⁷ “Këshilli i Sigurimit për Kosovën”, B92, 14 shkurt 2006.

¹⁸⁸ Deklarata të Sanda Rashkoviç-Iviç në “Upitnik”, 14 shkurt 2006.

¹⁸⁹ Një editorial në revistën *MIV*, më 3 nëntor 2005, pandeh se “Serbët nuk janë në Kosovë, në numër të mjaftueshëm për të bërë atë që bëjnë shqiptarët (të kërcënohen me dhunë). Vetëm në Republikën Serbe serbët ishin në gjendje që të bëjnë presion në bashkësinë ndërkombëtare ashtu siç bëjnë shqiptarët me sukses në Kosovë, Maqedoni e Serbi jugore”.

¹⁹⁰ “Qeveria e tha fjalën e vet”, B92, 12 shkurt 2006.

¹⁹¹ “Nuk e japim Kosovën: Intervistë me Toma Nikoliq, Partia Radikale Serbe”, *Press*, 15 shkurt 2006.

¹⁹² Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 162, *Sanxhaku i Serbisë: Ende i haruar*, 8 prill 2005.

¹⁹³ RTS raportonte se koordinatorja e Serbisë për Kosovën, Sanda Rashkoviç-Iviç, është shprehur se nëse Kosova bëhet e pavarur “ky do të jetë sinjal për shqiptarët në vendet fqinje që të kërkojnë të njëjtën, si dhe sinjal për serbët në Bosnjë e Hercegovinë dhe Kroaci, gjë që na kthen në vitet e nëntëdhjeta, e me këtë përsëri hapet kutia e Pandorës”, 5 dhjetor 2005.

¹⁹⁴ Intervistë e publikuar në *Wiener Zeitung*, 5 janar 2006. Gjatë vizitës në Moskë, më 15 nëntor 2005, kryetari Tadiq tërhoqi vërejtjen se “kjo mund të shpijë drejt dezintegritit të shteteve tjera si Maqedonia (dhe) Bosnja e Hercegovina”. “Kryetari rus dhe ai serb, diskutojnë në Moskë për Kosovën”, *RIA Novosti*.

¹⁹⁵ Në vjeshtë 2005, Serbia papritur anuloi vizitën e planifikuar të kryetarit sloven Dërnovshek, pasi ai propozoi rrugën tranzitore për Kosovën drejt pavarësisë. SMZ bojkotoi Asambleenë Parlamentare të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi që u mbajt në Tiranë më 22 nëntor, në shenjë proteste për përkrahjen e Shqipërisë për pavarësinë. Një takim i kryeministrave të rajonit i planifikuar që të mbahet në nëntor 2005 thuhet se është anuluar që të mos zemërohet Beogradi.

¹⁹⁶ Megjithatë mbetet një çështje e hapur. Zyrtarët maqedonas mbesin të trazuar me faktin që një pjesë e vogël e kufirit me Kosovën nuk është caktuar qartë. Vështirë se kjo do të bëhet para se të zgjidhet statusi i Kosovës. Shih Brifingun për Evropë

ndikimin e saj të moderuar në relacion me Kosovën. Ministri i jashtëm Mustafaj që kritikuar nga Prishtina që ishte shprehur në favor të pavarësisë së kushtëzuar e jo të pavarësisë së plotë. Kryeministri Berisha i ka kushtuar kohën më të madhe paraqitjes së tij në një dokumentar televiziv, në janar 2006, çështjes se si do të trajtohen minoritetet.¹⁹⁷ Mali i Zi është tërhequr nga shprehja hapur e simpatisë për pavarësinë e Kosovës, që të mos i acarojë marrëdhëniet me Serbinë në vitin kur do të mbajë referendumin për pavarësinë e vet.

Ndërsa liderët e Beogradit vazhdojnë të flasin për domino-teorinë e pan-shqiptarizimit, duke thënë se pavarësia e Kosovës do të shpiejë në copëtimin e vendeve fqinje ku jeton pakica shqiptare. Ministri i jashtëm Drashkoviç në janar 2006 ka thënë se pavarësia do të pasohet me kërkesat për ndarje të territoreve në jug të Serbisë, në Mal të Zi, Maqedoni e Greqi¹⁹⁸ – sikur Serbia e di më mirë se cilët janë interesat e këtyre shteteve se sa vet qeveritë e tyre.

Ndonëse të gjithë politikanët e Beogradit duket se kanë të përbashkët dëshirën, që të mbajnë njëfarë sovraniteti mbi Kosovën dhe që ta ndajnë de facto mes shqiptarëve e Serbëve, janë partitë nacionaliste DSS, SPS dhe SRS ato që janë dukshëm më negative. SRS dhe SPS refuzojnë që të bëhen pjesë e ekipit negociator duke parë dobi politike në këtë dhe duke insistuar që rezultati i negociatave të vihet në referendum në Serbi. Në anën tjetër, kryetari Tadiq mundohet të tërheqë vërejtjen se pavarësia është e mundur dhe se Serbia duhet që së paku të nxjerrë ndonjë gjë (fitim) nga kjo: “Politika ime... shikon se çfarë dëshiron Serbia në Kosovë. Kjo është mënyra e vetme që të parandalohet një zgjidhje e diktuar. Nëse vazhdojmë të flasim vetëm për atë se çfarë nuk dëshirojmë, atëherë i shtojmë gjasat që zgjidhja të na imponohet”.¹⁹⁹ Duke vazhduar atë që ka thënë lideri i DS-së, Gjingjic,²⁰⁰ gjatë vizitës në Moskë, në nëntor 2005, Tadiq propozoi që Kosova të ndahet në dy entite përbërëse. Duke e absorbuar konceptin e Tadiqit për entitet dhe duke e bërë pjesë të platformës së vet,

të Grupit të Krizave numër 37, *Maqedonia: Ende në mjegull*, 25 shkurt 2005.

¹⁹⁷ Në “A dikush një plan?”, film dokumentar i BIRN, premiera e të cilit u shfaq në rajon në janar dhe shkurt 2006. Shih www.birn.eu.com.

¹⁹⁸ Shih përmbledhjen e lajmeve ditore VIP, 16 janar 2006. Më 20 dhjetor 2005, në një konferencë në Beograd, këshilltari i Koshtunicës Aleksandër Simiq, tërhoqi vërejtjen se pavarësia e Kosovës do të shpiejë në bashkimin e saj me Shqipërinë, gjë që do të rrezikonte stabilitetin në Ballkan e madje “do të ishte shkak i luftërave të reja”.

¹⁹⁹ Intervistë në revistën *NIN*, 1 dhjetor 2005.

²⁰⁰ Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 143, *Dilema etnike e Kosovës: Nevoja për kontratë civile*, 28 maj 2003, për një përshkrim të idesë së Gjingjicit për dy entitete.

Beogradi ka bërë që kjo të duket vetëm reflektim mbi propozimet për decentralizim të Eides e jo të synojnë ndarjen.²⁰¹ Diplomtatët perendimorë nuk janë të bindur²⁰² ndërsa diskutimet e mëhershme të Tadiqit me zëvendëskryeministrin Labus, avokat i hershëm i idesë së ndarjes, tregon lidhjen e propozimit të tij me idetë e partisë G17+ që “pas pesë vitesh, entiteti Serb t’i takojë Serbisë, ndërsa pjesa shqiptare të bëhet e pavarur”.²⁰³

Pikëpamjet e sotme të Beogradit sinjalizojnë se qeveria ndoshta do të marrë pjesë në bisedime derisa në tavolinë të vihet pavarësia, ndoshta kah mesi apo fundi i vjeshtës së vitit 2006. Në këtë pikë, delegacioni i Beogradit do të tërhiqej, dhe është e mundur se qeveria e Koshtunicës, në shenjë proteste, do të jepte dorëheqje dhe do të thirrte zgjedhjet parlamentare, që të mos fajsohet për pavarësimin e Kosovës. Nuk mund të përjashtohet as mbajtja e një referendumi në Serbi për pavarësinë e Kosovës.

2. Decentralizimi

Beogradi ende e sheh projektin e bashkësisë ndërkombëtare për decentralizim në Kosovë si mjet për të rimarrë nën kontroll një pjesë të territorit të Kosovës e jo si mënyrë për të siguruar mbrojtjen institucionale për serbët dhe pakicat tjera në Kosovën e pavarur. Agjenda ndërkombëtare ka lëvizur shumë në favor të decentralizimit pas marsit 2004, duke kulmuar me propozimet e Eides. Ministri i jashtëm Drashkoviç argumenton se që të arrihet një shkallë e tillë e mbrojtjes së serbëve në Kosovë çfarë do ta kënaqte edhe Beogradin, “mjafton që të kërkohet implementimi i pakusht i rekomandimeve të bëra nga Kai Eide”.²⁰⁴ Siç u tha më herët, kryetari Tadiq i ka parë propozimet e Eides si mjaft të gjëra sa të akomodojnë zgjidhjen e afruar nga ai, “me dy entitete”. Pasi kanë futur Serbinë në proces, propozimet e Eides tani më nuk po përmenden, gjë që mund të bëjë Beogradin që të ankohet. Sido që të jetë, Serbia sigurisht do të refuzojë të pranojë pavarësinë e Kosovës në këmbim të decentralizimit.²⁰⁵

Në çasjen e Beogradit ndaj decentralizimit vërehen dy veçori, që janë të lidhura me njëra tjetrën dhe që shfaqen vazhdimisht: mosnjohja e të drejtës apo e kapaciteteve të

²⁰¹ Pjesë nga platforma e Beogradit, e publikuar në fillim të janarit 2006.

²⁰² Intervistë e Grupit të Krizave, Paris, 6 janar 2006.

²⁰³ Anëtari i kryesisë i G17+, Çedomir Antiq, në një intervistë në Blic, 21 nëntor 2005.

²⁰⁴ Intervistë në *Vecernje Novosti*, 10 nëntor 2005.

²⁰⁵ Marko Jakshiq ka paralajmëruar se, për të dëshmuar këtë, serbët e Kosovës madje mund të bojkotojnë edhe zgjedhjet komunale, të parapara të mbahen në fund të vitit 2006, intervistë e Grupit të Krizave, pjesa veriore e Mitrovicës, 3 shkurt 2006.

shumicës shqiptare që të udhëheqin me tërë Kosovën dhe dëshira që të ri-centralizojnë administratën e serbëve të Kosovës nën Beogradin. Me fjalë të tjera, Serbia, si e tillë, nuk është e interesuar për decentralizim. “Për Beogradin zyrtar, “Mitrovica Veriore” është model i mbijetesës së serbëve në Kosovë, me disa përmirësime... Për këtë, ata po e shtyjnë përpara një plan për njësi territoriale nëpër Kosovë që do t’i mbronte serbët”, është shprehur Rashkoviç-Iviç.²⁰⁶ Një ide që përmendet shpesh është që Prishtina duhet t’u japë të njëjtën shkallë të autonomisë serbëve të Kosovës sa Beogradi t’i japë Kosovës.

Në raportet me Kosovën, Beogradi preferon që të gjitha çështjet t’ia adresojë ekskluzivisht UNMIK-ut, sikur IPVQ-ja nuk ekziston. Duke u shprehur se decentralizimi është “mënyra e vetme që të sigurohet mbijetesë e serbëve”, planet e ndryshme për Kosovën që i ka prezantuar Serbia i trajtojnë zonat e banuara dhe të qeverisura nga shumica shqiptare si shkretëtira armiqësore, të ndaluara e që do të anashkalohen apo nëpër to do të kalohet nëpërmjet korridoreve speciale që do të negociohen. Përveç se e cilëson Kosovën shqiptare si një stallë të krimit të organizuar e terrorizmit islamik, ajo mundohet që pa të drejtë të paraqesë kampin e jo-shqiptarëve tjerë në anën e saj, duke mos përfillur përkrahjen e turqve, boshnjakëve, romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve për pavarësinë e Kosovës.²⁰⁷ Serbia nuk po mund ta pranojë faktin se minoritetet tjera jo serbe anojnë kah shqiptarët²⁰⁸. Ata vazhdojnë të flasin për pjesën veriore të Mitrovicës, të kontrolluar nga serbët, si qytetin e vetëm multi-etnik në Kosovë.

Qeveria e Serbisë e kontrollon komunitetin e përçarë të serbëve të Kosovës nëpërmjet strukturave paralele²⁰⁹ dhe këtë e shfrytëzon për t’ia mohuar legjitimitetin UNMIK-ut dhe IPVQ-së. Duke mbështetur bojkotimin e pjesërishtëm nga ana e serbëve të IPVQ-së, Beogradi ka forcuar pushtetin mbi serbët e Kosovës. Duke diskutuar për propozimin e një OJQ-je serbe për decentralizimin në

një takim ndërkombëtar, koordinatori për Kosovë Rashkoviç-Iviç ka hedhur poshtë nevojën për një grup punues për decentralizimin të serbëve të Kosovës, duke insistuar se kjo çështje do të negociohet nga ministria gjegjëse e Serbisë.²¹⁰ Qendra e saj koordinuese (QKK) ka bërë thirrje, që serbët e Kosovës të lëshojnë vendet e punës në UNMIK dhe IPVQ dhe të orientohen kah institucionet shtetërore të Serbisë pasi “nuk mund t’u shërbehet dy zotërinjve”. Po ashtu ka inkurajuar serbët e Kosovës që të vazhdojnë të mos ia paguajnë KEK-ut faturat për energjinë elektrike të shpenzuar.

Kjo mohon njohjen e autoritet të UNMIK-ut dhe IPVQ-së dhe i jep peshë kërkesës së Qendrës Koordinuese, që UNMIK-u t’ia dorëzojë menaxhimin e energjisë elektrike në vendbanimet serbe kompanisë shtetërore energjetike të Serbisë. Në ditët kur mbretëronte moti i ftohtë, Serbia e bllokoj transportimin e energjisë në Kosovë nga vendet fqinje²¹¹ ndërsa i ofronte UNMIK-ut që ti furnizojë me energji nga rrjeti i vet, zonat serbe dhe jo-shqiptare. Kurrfarë marrëveshjeje nuk u arrit dhe si shqiptarët ashtu edhe serbët vuajtën reduktime të mëdha të energjisë elektrike.²¹² Beogradi i quajti reduktimet në fshatrat serbe shenjë e diskriminimit shqiptar dhe përpjekje për pastrim etnik, edhe pse në të vërtetë shqiptarët ishin më të pafavorizuar se serbët.

Plani i ndryshuar i decentralizimit, që ekipi negociator i Beogradit e ka përgatitur për bisedimet në Vjenë, e hedh poshtë idenë e bashkimit të zonave serbe me korridore tokësore. Ky është më realist se sa propozimi i prillit 2004 dhe vazhdimisht citon raportin e Eides. Në vend të lidhjeve territoriale, komunat me shumicë serbe do të kishin “lidhje funksionale”, që do të mbaheshin nga organet e reja të themeluara për të administruar autonominë kulturore, financiare, ekonomike dhe shërbimet sociale/shëndetësore, si dhe nga lidhjet e drejtpërdrejta me Beogradin. Të vëmendshëm për shqetësimet e shqiptarëve dhe ndërkombëtarëve për fragmentarizmin e mundshëm në sferën e sundimit të ligjit, propozimi nuk duket se kërkon kompetenca të

²⁰⁶ Adresuar në konferencën “Mitrovica 1999-2005, pjesa veriore”, Mitrovicë veriore, 23 shtator 2005.

²⁰⁷ Kryetari Tadiç ka propozuar që zonat e banuara me pakicë jo-serbe të përfshihen në entitetin serb. Deklarata të bëra pas takimit me ministrat e jashtëm të dhjetë vendeve të Evropës Jug-Lindore, mbajtur në Beograd, më 7 dhjetor 2005.

²⁰⁸ Tregues i rreshtimit të këtyre pakicave jo-serbe në anën e shqiptarëve të Kosovës është radhitja pothuajse identike me ta e tri problemeve më të rëndësishme që shihet në anketat tremujore të UNDP-së: (1) papunësia, (2) paqartësia rreth statusit final të Kosovës, dhe (3) varfëria. Në anën tjetër, për serbët e Kosovës, më të rëndësishmet janë: (1) siguria publike e personale, (2) marrëdhëniet ndër-etnike, dhe (3) papunësia.

²⁰⁹ Shefi i QKK-së, Rashkoviç-Iviç, flet për “shpirtin vertikal të komunitetit tonë, por në këtë shpirt nuk ka vend për jotolerancë”. Fjalim në konferencën “Mitrovica 1999-2005, pjesa veriore”, Mitrovicë e veriut, 23 shtator 2005.

²¹⁰ Seminar i Asamblesë parlamentare të NATO-s “Kosova: Decentralizimi si çelës i negociatave për statusin e ardhshëm”, Romë, 28 tetor 2005.

²¹¹ Intervistë e Grupit të Krizave me PSSP Soren Jessen-Petersen, Prishtinë, 1 shkurt 2006.

²¹² Shih: “ZPSSP Ruecker fton Beogradin për bashkëpunim në frymën e Traktatit të Komunitetit për Energji”, komunikatë për shtyp e UNMIK-ut, 3 shkurt 2006. Pasi hodhi poshtë komentet e udhëheqëses së QKK-së, UNMIK-u ftoi, “Beogradin që të ofrojë më shumë detaje rreth ofertës së tyre për furnizim me energji, që të përcaktohej nëse implementimi i kësaj oferte do të shpinte drejt forcimit të strukturave paralele ilegale apo do të ishte mjet efikas që të përmirësohet gjendja e sektorit ekonomik. (UNMIK) shprehu rezerva ndaj ofertës për ndihmë, e cila nuk ishte në përputhje me kornizën kushtetuese të Kosovës”.

ngjashme të nivelit të entitetit edhe për policinë dhe drejtësinë. Këto do të mbeteshin në nivelin komunal dhe, siç lihet të kuptohet, do të ishin lirshëm të lidhura me hierarkitë qëndrore policore e gjyqësore të Kosovës. Numri i saktë i komunave të reja me shumicë serbe që kërkon Beogradi nuk është i qartë por propozimi përmend katër zona më të mëdha gjeografike në të cilat do të mund të krijoheshin këto komuna. Rashkoviq-Iviq thotë: “Është qenësore që të formohen pesëmbëdhjetë apo më tepër komuna jo-shqiptare”.²¹³ Beogradi dëshiron që të ndërtojë administratë lokale me zyrtarët e vetë dhe këtë mund ta shfrytëzojë si kundër-argument në shqetësimet e shqiptarëve dhe ndërkombëtarëve se një numër i madh i komunave të vogla do të ishin administrativisht e financiarisht të paqëndrueshme.

Propozimi i Beogradit parasheh që zona tokësore e entitetit serb do të shtrihej deri tek lokacionet e Kishës Ortodokse Serbe dhe zonat e mbrojtura rreth tyre dhe dëshiron që mbrojtja e trashëgimisë ortodokse të jetë pjesë e bisedimeve për decentralizimin, e jo çështje e ndarë.²¹⁴ Kthimin e mundshëm të pronës së madhe tokësore Kishës Ortodokse Serbe e sheh si një mjet tjetër me të cilin do të zgjeronte entitetin serb. Edhe pse rangjet e larta të Kishës mund ta shohin këtë si rrjedhojë e rreshtimit të tyre krahas me qeverinë në çështjen e statusit të Kosovës, disa pjesëtarë të tjerë të klerit nuk ndjehen mirë që kishat dhe manastiret po vihen në shërbim të pretendimeve territoriale.²¹⁵

Beogradi, për një kohë të gjatë mbështet kthimin e serbëve të zhvendosur në vendbanimet me popullatë kompakte serbe e jo në ambientet me shumicë shqiptare: në fshatrat dhe komunat e reja me shumicë serbe, e jo në qytete.²¹⁶ Deri kah mesi i vitit 2005, UNMIK-u ishte i gatshëm që të bisedojë për “zgjidhje për zhvendosurit e jo për kthim”.²¹⁷ Kjo gjeti vend edhe në rekomandimin e Eides “që të mbështet kthimi i njerëzve aty ku dëshirojnë të jetojnë e jo vetëm aty ku kanë jetuar”. Numri joreal i të kthyerve potencial për të cilin flasin zyrtarët serbë e shton frikën e shqiptarëve nga “rikolonizimi” serb dhe bën që

IPVQ-ja ti kundërshtojë edhe më shumë politikat më fleksibile të kthimit e të lidhura me decentralizimin, gjë që u pa në fund të vitit 2005. Në deklaratën e vet të 31 janarit 2006, Grupi i Kontaktit cakton: “Decentralizimi mund... t’i japë shtytje kthimit e personave të zhvendosur të cilët duhet të kenë të drejtë të zgjedhin se ku do të jetojnë në Kosovë”. Beogradi dëshiron që ta orientojë kthimin kolektiv kah zonat që shpreson që t’i marrë nën kontroll. Në anën tjetër, UNMIK-u po mundohet t’i shtyjë autoritetet e komunave me shumicë shqiptare që të bëjnë më tepër dhe t’i ndihmojnë kthimet vullnetare individuale.²¹⁸

Liderët e Beogradit do të dëshironin që të formalizonin dhe zgjerorin ndikimin vertikal të infrastrukturës shtetërore serbe. Ideale do të ishte që të vihen lidhje të drejtpërdrejta institucionale me komunat me shumicë serbe që në sa më shumë të jetë e mundur ta eliminojë nevojën që këto komuna të bashkëpunojnë me Prishtinën. I këshilluar nga qeveria franceze, që të jetë më realist sa i përket pavarësisë, kryetari Tadiq insiston që lidhja konstitucionale (kushtetuese) dhe legale mes komunave serbe dhe Beogradit të jetë minimumi.²¹⁹ Sipas të gjitha gjasave, Serbia do të insistojë në këtë gjatë procesit për statusin, derisa Prishtina do të kërkojë të negociojë marrëdhëniet jashtë kontekstit të formimit të shtetit të Kosovës. Prishtina do të mundohet të sigurojë edhe atë, që të gjitha lidhjet të kalojnë përmes institucioneve qëndrore të Kosovës. Derisa i fuqishmi i veriut të Kosovës Marko Jakshiq këmbëngulë se serbëve të Kosovës nuk u duhet leja e shqiptarëve apo ndërkombëtarëve që të mbajnë lidhje me Beogradin,²²⁰ UNMIK-u qysh tash u ka dhënë leje institucioneve të Kosovës, që të fillojnë shpërbërjen e infrastrukturës paralele serbe të telekomunikimit në Kosovën qëndrore.²²¹

3. Prona

Marrja e pronës dhe asetëve në Kosovë ka prioritet të lartë për Serbinë. Ajo dëshiron që të përfitojë nga trashëgimia e Milosheviqit e konfiskimit dhe përvetësimit të pronës në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme nga fundi i viteve 80-ta dhe gjatë viteve 90-ta, dhe refuzon ta pranojë diskriminimin dhe shkatërrimin, që u ka bërë shumicës në

²¹³ “Argumentet e Serbisë në negociatat për Kosovën e Metohinë”, *Nova Srpska Politicka Misao*, 5 dhjetor 2005.

²¹⁴ Shih komentet e këshilltarit të Tadiqit, Dushan Batakoviq, VIP, 28 dhjetor 2005.

²¹⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, 2 shkurt 2006.

²¹⁶ Intervistë e Grupit të Krizave me zyrtarin e UNHCR-së Mishko Mimica, Prishtinë, 6 nëntor 2003. Serbët që kthehen në qytete përballen me pasiguri. Shih “Rrëfimi për përpjekjen e dështuar për kthim”, B-92, 8 shkurt 2006, për të mësuar për përpjekjet e Zoran Stanishiqit që të ringjallë biznesin e tij në Prishtinë: vazhdimisht i plaçkitur dhe i penguar, ai tani është zhvendosur në Graçanicë.

²¹⁷ Intervistë e Grupit të Krizave me koordinatoren për kthime të UNMIK-ut, Kilian Kleinschmidt, 12 korrik dhe 12 dhjetor 2005.

²¹⁸ Ibid.

²¹⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, Paris, 6 janar 2006.

²²⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, Mitrovicë veriore, 6 janar 2006.

²²¹ Në janar 2006, Agjencioni Rregullativ i Telekomunikacionit, çmontoi transmetuesit e Mobtelit në qytete, e pastaj, ka filluar të bëjë këtë edhe në enklavat serbe, duke hequr edhe rrjetin telefonik tokësor të mirëmbajtur nga PTT-ja serbe. Pas gjashtë viteve të neglizhimit të zonave serbe, PTK-ja njoftoi në muajin shkurt se do të ofrojë shërbimet e veta edhe në këto pjesë.

Kosovë. Në vend të kësaj, Serbia thotë se Kosova është zhvilluar falë saj: “Kjo është pronë e jona, shteti Serb ka investuar këtu për 50-60 vjet”.²²²

Zyrtarët serbë duken më të aftë që të flasin për vete se sa shqiptarët e Kosovës. Ata kanë publikuar sajimet se borxhi i jashtëm i Kosovës është 1 miliard dollarë ndërsa në fillim të shkurtit 2005, kryesuesi i ekipit të tyre ekonomik për Kosovë ishte duke lobuar në SHBA derisa homologët e tij në Kosovë nuk kishin përgatitur as raporte për këtë çështje. Megjithatë, pozicioni Serb paraqet një interpretim në esencë kolonialist të marrëdhënieve me Kosovën gjatë periudhës së Jugosllavisë. Ata pretendojnë se kanë të drejta në resurset minerale dhe xehe por harrojnë se fondi federal jugosllav për rajonet e pazhvilluara, nga i cili përfitonte Kosova, ishte krijuar kryesisht që ti kompensojë çmimet e ulëta, të kontrolluara nga shteti për prodhimet minerale dhe energjinë e Kosovës dhe se pjesa me e madhe e këtyre parave vinte nga Kroacia dhe Sllovenia. Serbia nuk ka shfaqur pretendime të këtilla në raport me Bosnjën e Hercegovinën apo Maqedoninë.²²³

Serbia e ka kundërshtuar programin e privatizimit të UNMIK-ut në çdo hap dhe do të kërkojë në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë dhe Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë të drejtën e kompanive të saj mbi qindra ndërmarrje shoqërore (NSH), duke shpresuar që të hedhë poshtë argumentimet e dobëta legale që OKB-ja me gjysmë-gojë dhe gjysëm- zemër ia ka krijuar dhe aprovuar. Të qenët titullar legal dhe me pjesën më të madhe të dokumentacionit larg duarve të UNMIK-ut dhe IPVQ-së, Serbia është e armatosur mirë. Shpërfillës për çështjet e titullarit, shqiptarët kanë blerë prona në mënyrë joformale, për t’u ikur tatimeve edhe para se Serbia të ndalonte me ligj blerjen e pronës serbe në vitet 90-ta. Derisa Serbia mund ti dokumentojë pretendimet e saj mbi pronat, shqiptarët duhet ta kundërshtojnë këtë me fatura bindëse.

Serbia mund të përfitojë edhe nga kthimi i pronës së konfiskuar pas Luftës së Dytës Botërore, që është bërë standard për kthimin e pronës në shumicën e vendeve ish-

komuniste të Evropës Lindore. Kisha Ortodokse Serbe, pretendimet e të cilës i mbështet Beogradi, ka humbur pjesë të mëdha të tokës në vitet 1940. Por, shqiptarët tregojnë për marrjen e tokës në epoka më të hershme: konfiskimi i tokave për kolonët serbë në vitet 1930 dhe dëbimi gjatë dhe pas Luftës së Parë Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore.²²⁴

Përveç mijëra kërkesave për kompensim të serbëve të Kosovës me të cilat zyrtarët e Beogradit i kanë vërshuar gjyqet e Kosovës, Ministri i punës Slobodan Laloviq ka njoftuar për synimin që të kërkohej kompensim për 6.500 serbët që kanë mbetur pa vendet e tyre të punës në atë që tash njihet si KEK.²²⁵ Megjithatë, këto janë ujëra të turbullta. IPVQ-ja ka bërë presedan kur është fjala për pagimin e dëmshpërblimit dhe kompensim duke rindërtuar shtëpitë serbe të djegura në trazirat e marsit 2004 dhe duke i dhënë nga 2.000 euro secilës familje të prekur. Serbia nuk ka ofruar kompensim për më tepër se 100.000 shqiptarët e punësuar në sektorin e shërbimit civil të përjashtuar nga puna në vitet 90, e të mos flasin për dhjetëra mijëra shtëpi të shkatërruara nga forcat e saj në vitet 1998 e 1999, për plaçkitjet dhe dëbimet e qindra mijëra shqiptarëve.

D. SERBËT NË KOSOVË

Serbët e Kosovës mendojnë se janë të rrezikuar. Shumë liderë të tyre kërcënojnë se do të shpërngulen nëse Kosova bëhet e pavarur, e disa sigurisht do të bëjnë këtë, veçanërisht ata nëpër enklava. Derisa politikanët e Këshillit Nacional Serb (KNS), të cilët do ta inkurajojnë këtë shpërngulje eventuale, kanë shtëpi edhe në Serbi, ndërsa shumica e serbëve tjerë në Kosovë nuk kanë ku të shkojnë. Edhe nëse vendosin të largohen, do t’u duhet që së pari t’i shesin shtëpitë e tyre ndërsa eksodi masiv do të bënte që të ulen çmimet e pronës. Pasi i kanë mbijetuar ditët e rënda të gjysmës së dytë të vitit 1999 dhe trazirat e marsit 2004, mund të ndodh që shumica të vendosin të qëndrojnë dhe të durojnë çfarëdo zgjidhjeje që do të vendoset. Qëndrimi i Beogradit dhe Kishës Ortodokse sigurisht se do të ketë ndikim në shkallën dhe intensitetin e çfarëdo eksodi: në rastin më të keq, qeveria do të mundohet të orkestrojë diçka të ngjashme me evakuimin e serbëve nga periferitë e Sarajevës në vitin 1996 edhe pse kisha sigurisht do ta kundërshtojë këtë.

²²² Komentet e shefit të grupit për ekonomi, të ekipit negociator të Serbisë, Nenad Popoviq, të bëra në B-92, 26 janar 2006. Një shembull tjetër: “Vetëm gjatë periudhës prej 1971 deri më 1985, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë ka investuar 15 miliard dollarë në Kosovë; Vetëm Republika e Serbisë ka investuar 9,6 miliard. Sot Serbia paguan borxhin e jashtëm të Kosovës në shumë prej 1,4 miliard; gjatë periudhës prej 2002 deri në nëntor 2005, janë paguar 130 milion dollarë”, Sanda Rashkoviç-Iviq, “Argumentet serbe në negociatat për Kosovën e Metohinë”, *Nova Srpska Politicka Misao*, 5 dhjetor 2005.

²²³ Fondi financohej nga kontributet në proporcion me zhvillimin e përgjithshëm kombëtar të njësive federale të Jugosllavisë, përfshirë këtu edhe Kosovën.

²²⁴ Pasardhësit e shumë familjeve shqiptare të dëbuar me dhunë nga Nishi dhe pjesët tjera në jug të Serbisë në vitet 1877-1878 ende posedojnë tapitë osmane të tokave.

²²⁵ Raport në RTS, 14 dhjetor 2005.

1. Bërja komunitet

Komuniteti i serbëve të Kosovës është gjeografikisht dhe politikisht i fragmentuar, vështirë mbahet, nuk ka qendër gravituese politike dhe varet nga Beogradi. Qendra e vet urbane, pjesa veriore e Mitrovicës, është tmerrsisht e pasigurt, me një numër të madh të refugjatëve. Elementi i saj më i madh rural është më i rrënjosur dhe më stabil²²⁶ por e ka të vështirë të gjenerojë një elitë politike. Mes Beogradit imponues e manipulues dhe Prishtinës neglizhente e indiferente, shumë serbë të Kosovës janë të humbur. Tash vonë, Prishtina filloi të kundërshtojë zgjerimin e rrjetit tokësor telefonik serb në lindje të Kosovës, ndërsa vetë nuk u ofronte këtë infrastrukturë pasi që këtë e bënte Serbia. Shërbimet siç janë KEK-u, PTK-ja e aeroporti punësojnë shumë pak serbë ndërsa asgjë nuk e obligon sektorin privat të shqiptarëve të Kosovës që t'i marrë në punë ata. Por, përpjekjet e menaxherëve ndërkombëtarë të KEK-ut që të negociojnë marrëveshjet për furnizimin me rrymë të fshatrave serbe tregojnë se në përjashtimin e tyre ka gisht edhe Beogradi: “Ne do të arrinim një marrëveshje me banorët lokalë. Por, atëherë do të përzihet QKK-ja dhe do t'i frikësonte ata duke i kërcënuar se nuk do të merrnin ndihmat nga Serbia, se do të jenë serbë të këqij, etj”.²²⁷ Fushata e qeverisë së Serbisë kundër vëllezërve Kariq, në fillim të vitit 2006 i dha fund bashkëpunimit të rrjetit të tyre telefonik Mobtel me magnatin shqiptar Ekrem Lluka, që rezultoi me shkyçjen e Mobtelit në pjesën më të madhe të Kosovës, duke izoluar serbët e Kosovës edhe më tutje, të cilët e perdorin atë shërbim.

Në punët e përditshme, serbët e Kosovës përfitojnë shërbime dhe punësim edhe nga qeveria serbe edhe nga UNMIK-u/IPVQ-ja. Politikisht, lojaliteti ndaj Beogradit është esencial. Instruksionet e KNS-së, që të bojkotohen zgjedhjet e Kosovës u respektuan pasi që përkraheshin nga qeveria serbe. Këmbëngulës në kundërshtimin e pavarësisë, liderët e KNS-së siç është Marko Jakshiq nuk tregojnë gatishmëri që të negociojnë forma të reja institucionale, në të cilat do të mbanin pushtetin që edhe ashtu de fakto e kanë.²²⁸ Ai dallohet ndër nacionalistët e zjarrtë, duke e ruajtur *status quo*-në në emër të Beogradit. Në një mbledhje në nëntor 2005, Jakshiq lehtë e hodhi poshtë propozimin e një pjesëmarrësi që Asociacioni i Komunave Serbe i KNS-së të shpallë

veten trup ligjvënës, për të kundërshtuar UNMIK-un dhe IPVQ-në.²²⁹ Me përkrahje elektorale të mohuar për shkak të bojkotit të kryesuar nga KNS-ja, Oliver Ivanoviq më i moderuar dhe Lista Serbe për Kosovë e Metohi e tij lobuan pa sukses në Beograd për të marrë dritën e gjelbër për të marrë vendet në Kuvendin e Kosovës. Jakshiq është pjesë e ekipit negociator të Beogradit, ekip i cili ia pamundësoi Ivanoviqit edhe propozimit të tij, për një ekip të veçantë të serbëve të Kosovës (edhe pse Ahtisaari dhe ndërkombëtarët tjerë ende takohen me Ivanoviqin edhe ashtu).

Derisa Jakshiqi dhe njerëzit e tij ndoshta do të largohen nga Kosova pasi të vendoset statusi, Ivanoviqi duket se do të qëndrojë dhe të bashkëpunojë. Ai i thotë Beogradit: “na nevojiten njerëz, të cilët do ta implementojnë marrëveshjen”.²³⁰ Ivanoviqi e njeh mirë politikën e Prishtinës dhe ka apetit të jetë pjesë e saj, i trajton shqiptarët e Kosovës si audiencë të denjë dhe është mjaft karizmatik. Por, asnjë politikan serb, pa marrë parasysh sa ambicioz të jetë, nuk mund t'ia lejojë vetes që të bashkëpunojë më afër me Prishtinën para se të përcaktohet statusi e për këtë edhe mundësitë për të bërë diçka për serbët e Kosovës shumë të vogla. Disa individë mendojnë për themelimin e një partie të serbëve të Kosovës menjëherë pasi të përcaktohet statusi. Në nëntor 2005, vizita dhe ligjëratat e politikanit serb nga Kroacia, Milorad Pupovac u dha disa homologëve të tij ide të reja. Ai është në koalicion me HDZ-në dhe kolegëve serbë në Kosovë u tregoi se arritja e të drejtave të plota është proces më i gjatë dhe se ndikimi i komunitetit të tij në Kroaci rritet sa më shumë që vendi i afrohet anëtarësimit në BE, dallim ky tepër i madh me pozitën dëshpëruese në të cilën ishin para një dekade.²³¹ Ka shenja se këshilla e tij dhënë serbëve të Kosovës, që të angazhohen në mënyrë aktive dhe të përfaqësojnë vetëveten mund të pranohet nëse procesi për statusin përfundon me një paketë në të cilën janë të përfshira disa koncepte që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave, siç preferon Ahtisaari, edhe nëse Beogradi largohet nga bisedimet.²³² Një segment i rëndësishëm i këtij procesi duhet të jetë që të zhvillohet më tej shoqëria civile ndër serbët e Kosovës, jashtë institucioneve zyrtare e paralele

²²⁶ Shih raportin e ESI-t, “Parimet e Lozanës: Multi-etniciteti, territori dhe e ardhmja e serbëve të Kosovës”, 7 qershor 2004, për një diskutim rreth strukturës së popullatës serbe në Kosovë. Mund ta gjeni në www.esiweb.org.

²²⁷ Intervistë e Grupit të Krizave me drejtorin komercial të KEK-ut, Sean McGoldrick, nga kompania irlandeze ESBI, Prishtinë, 7 dhjetor 2005.

²²⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, veri i Mitrovicës, 3 shkurt 2006.

²²⁹ Intervistë e Grupit të Krizave me gazetarin Petar Miletiq, 22 nëntor 2005. Mbledhja është mbajtur në pjesën veriore të Mitrovicës, më 17 nëntor 2005, si kundërpërgjigje ndaj miratimit të rezolutës për pavarësi të Kuvendit të Kosovës.

²³⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, veri i Mitrovicës, 3 shkurt 2006.

²³¹ Intervista të Grupit të Krizave me një zyrtar të OSBE-së, Prishtinë, 20 janar 2006, dhe me një politikan serb të Kosovës, shkurt 2006.

²³² Intervistë e Grupit të Krizave me një politikan serb të Kosovës, shkurt 2006.

të qeverisjes, ndërsa donatorët ndërkombëtarë duhet të jenë të gatshëm të ndihmojnë.

Disa diplomatë frikësohen se pavarësia do ta nxisë popullatën serbe të shpërngulet nga Kosova qëndrore drejt veriut. Beogradi i pabindur mund ta forcojë kontrollin mbi territorin përtej lumit Ibër duke ndërprerë pagat, pensionet dhe pagesat tjera për serbët që jetojnë në Kosovën qëndrore.²³³ Një kombinim i mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës nga Serbia dhe refuzimi i KNS-së që të negociojë së paku një lidhje formale të institucioneve me qeverinë qëndrore në Prishtinë mund ta bindë bashkësinë ndërkombëtare të pavendosur që të vendosë një administratë të re tranzitore në veri. Por, një çasje vetëm pak më e butë se kjo, do ti zvoglojë shancat për lidhje insitucionale me Prishtinën, duke ua mundësuar serbëve të Kosovës që të konsolidojnë pushtetin e tyre në veri të Ibrit për disa vite.

Beogradi vazhdon të besojë në mitin se janë 200.000 serbë të Kosovës të zhvendosur; me gjasë numri real është më pak se gjysma e këtij.²³⁴ Nga këta, mes 20.000 dhe 50.000 dëshirojnë të kthehen, ndërsa deri më sot këtë e kanë bërë vetëm disa mijëra. UNMIK-u beson se “sezona e kthimeve këtu do të fillojë vetëm pas statusit” dhe në ndërkohë duhet përqëndruar në krjimin e kushteve për këtë: siguri dhe punë.²³⁵ Duke punuar me shoqatat e serbëve dhe romëve të zhvendosur, UNMIK-u synon të rimendojë politikën e kthimit, gjatë një seminari në Prishtinë, që do të mbahet diku në javët e ardhshme, për ta sjellur atë në një nivel më praktik, në të cilin luajnë rol të gjithë, por që politika ka më pak ndikim.²³⁶ Pas një fillimi të ngadalshëm, Habitatit ka shpallë vendimet dhe ua ka kthyer shumicën e banesave të uzurpuara pronarëve të tyre, edhe pse shumë nga këto u janë shitur shqiptarëve. Ndonëse me vonesë, mandati i tij është zgjeruar për të përfshirë edhe pretendimet mbi tokën, të bëra pas vitit 1999. Megjithatë, mbesin 10.000 shtëpi të shkatërrura që janë lënë në harresë, ku shumica e tyre kanë edhe tokë.²³⁷

²³³ Intervistë e Grupit të Krizave, Paris, 6 janar 2006.

²³⁴ “Parimet e Lozanës”, op. cit.

²³⁵ Intervistë e Grupit të Krizave me PSSP-në Jessen-Petersen, Prishtinë, 30 gusht 2005.

²³⁶ Intervistë e Grupit të Krizave me koordinatoren e UNMIK-ut për kthime, Kilian Kleinschmidt, Prishtinë, 12 dhjetor 2005. Ministria për kthim dhe komunitete, e kryesuar nga kontraversi, Slavisha Petković, kryesisht vetëm bën sehir. Orientimi i dobët i ministrit, prioritetet e çuditshme dhe menaxhimi i dobët me fonde nuk i kanë mundësuar ministrisë që të marrë rolin që është dashur ta ketë. Në tetor 2005, Beogradi refuzoi që të nënshkruajë protokollin e ri për kthim me UNMIK-un, duke e vlerësuar atë si “tepër praktik, teknik por jo mjaft politik, më saktësisht, ata kërkonin që të theksohet dështimi i UNMIK-ut në çështjen e kthimit”. Ibid.

²³⁷ Intervistë e Grupit të Krizave me zyrtarin e “Habitatit” David Chillaron-Cortizo, Prishtinë, 14 dhjetor 2005.

Nuk janë ndërmarrë masa për rindërtim dhe kjo politikë e pavolitshme e kthimeve ka lënë mijëra familje, kryesisht serbe, ende të zhvendosura. Bashkësia ndërkombëtare duket më e përkushtuar në parim se sa në praktikë: nevojiten edhe 30 milionë euro vetëm për të plotësuar nevojat e tanishme.²³⁸

2. Kisha Ortodokse në Kosovë

Djegëja e kishave dhe manastireve ortodokse në mars 2004, ka ngritur çështjen e mbrojtjes së tyre si një nga çështjet kryesore në procesin e statusit. Raporti i Eides i ka kushtuar vëmendje të madhe ndërsa vala e diplomatëve që kanë vizituar Manastirin e Deçanit që nga atëherë konfirmon daljen në skenë të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si grup i veçantë në bisedimet për statusin. Duke pasur parasysh këmbënguljen në vijën kundër pavarësisë që ndiqet nga maja e hierarkisë së Kishës dhe nga Peshkopi Artemije i Graçanicës, ndoshta ishte befasi që në nëntor 2005, Sinodi i shenjtë i dha mandatin peshkopit të ri, më fleksibil, Peshkopit Teodosie të Lipjanit, që vjen nga Manastiri i Deçanit që është më i prirë për reforma, dhe që ta prezantojë Kishën Ortodokse të Kosovës në proces. Por, ka shenja të një çarjeje edhe brenda kishës sa i përket Kosovës. Disa nga kleri japin deklaratat të ashpra, siç ishte rasti me Artemien i cili përsëriti deklaratën e liderit të Partisë Radikale Nikoliq, që Serbia duhet ta konsiderojë Kosovën territor të okupuar.²³⁹ Dokumenti me Parimet Bazë i përpiluar nga Kisha në shkurt 2006, jep propozime konstruktive dhe nuk shprehet me pompozitet kundër pavarësisë. Edhe pse pohon se qëndrimet e veta janë “krejtësisht komplementare me planin e Qeverisë serbe për Kosovën”, ajo “përkrah me gjithë zemër” vetëm përpjekjet e Beogradit që të sigurojë aranzhmane për decentralizimin që do të mbronin interesat vitale të serbëve të Kosovës.²⁴⁰

Në dokumentin e Parimeve Themelore, Kisha nuk përkrah dëshirën e ekipit negociator të Beogradit që ti bëjë bashkë çështjen e entitet serb të propozuar dhe atë të tokës së Kishës. Ajo dëshiron një regjim të veçantë të mbrojtjes së lokacioneve të veta. “Mënyra e mbrojtjes dhe madhësia e zonës së mbrojtur do të varej nga rëndësia e manastirit dhe nëse ai ndodhet në pjesën e provincës me shumicë shqiptare apo me shumicë serbe”.²⁴¹ Një

²³⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me koordinatoren për kthime në UNMIK, Kilian Kleinschmidt, Prishtinë, 12 dhjetor 2005.

²³⁹ “Qeveria e tha fjalën e vet”, B92, 12 shkurt 2006.

²⁴⁰ “(në këtë kontekst) Kisha Ortodokse Serbe i jep mbështetje me plot zemër, ekipit për bisedimet politike për statusin e ardhshëm të Kosovës, që do të përfaqësojë interesat e popullit dhe shtetit serb”.

²⁴¹ “Parimet Themelore të Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Serbe dhe Bordi i Kuvendit të Shenjtë të Peshkopëve

përfaqësues i Kishës Ortodokse në Kosovë vëren se, Parimet Bazë të Grupit të Kontaktit u çasen ndaras decentralizimit dhe mbrojtjes së lokacioneve religjioze dhe e sheh të rëndësishme që shqiptarët e Kosovës të mos e shohin Kishën si “kalë të Trojës”.²⁴² Shqiptarët e shohin ringjalljen e Kishës në vitet 1980 e 1990, të lidhur me ngritjen e Milosheviqit dhe falltoret e ndërtuara në këtë periudhë në Kosovë i quajnë “kisha politike”. Disa politikanë shqiptarë në Kosovë gati sa nuk arsyetojnë shkatërrimin e tyre në trazirat e marsit 2004, kinse vetëm këto kishat e reja ishin sulmuar.²⁴³ Sipas kësaj, nëse Kisha Ortodokse dëshiron të jetë e pranuar në Kosovë, duhet të heqë dorë nga infrastruktura e epokës së Milosheviqit ashtu që të shfaqet identiteti i saj shpirtëror i vërtetë.

Ati Sava i Deçanit kundërshton duke thënë se para viteve 80-ta, Kisha nuk gëzonte favore zyrtare dhe ndërtimi i kishave të reja ishte diktuar nga nevoja e ndryrë me vite.²⁴⁴ Kisha dëshiron që çfarëdo zgjidhje që arrihet për statusin të “mundësojë rindërtimin e plotë të të gjitha kishave dhe manastireve ortodokse që janë shkatërruar apo dëmtuar që nga viti 1999”.²⁴⁵ Megjithatë, disa nga kleri në Kosovë janë të shqetësuar nga imponimi i ndërtimit të katedrales në pronën e universitetit mu në qendër të Prishtinës, punimet e të cilës nuk kanë përfunduar, në pronën e universitetit. Ky rast mund të jetë material për kompromis për identitetin e Kishës Ortodokse në Kosovë dhe për trashëgiminë e viteve 90.

Kisha dëshiron që zona e mbrojtur rreth manastirit të Deçanit, me një vendim të UNMIK-ut në prill 2005, të zbatohet edhe në lokacione tjera “jo si rrethojë për ndonjë republikë të priftërinjve, por si mbrojtje për manastirin... vendin”.²⁴⁶ Urdhëri ekzekutiv i UNMIK-ut, që ripërtihet çdo gjashtë muaj, ndalon ndërtimin dhe prerjen e drunjve në grykën e Deçanit, duke i obliguar të gjithë pronarët dhe shfrytëzuesit e tokave që t’u përmbahen rregullave të UNESCO-s për ruajtje dhe mbrojtje.²⁴⁷ Përkundër faktit që ishin të nxitur nga udhëheqësi i veteranëve të UÇK-së, Abdyl Mushkolaj, popullata shqiptare, ndonëse e pakënaqur, e pranoi zonën mbrojtëse rreth Deçanit. Kisha do të dëshironte të ketë mbrojtje ushtarake ndërkombëtare

rreth lokacioneve për sa më shumë vite që të jetë e mundur, si dhe lehtësime në pagesat e doganave dhe taksave, si dhe lidhje të papenguara me sinodin e Kishës Ortodokse Serbe dhe administratën në Beograd. Ajo e sheh kthimin e tokës së marrë në kohën e komunizmit jo si çështje të statusit por si një çështje afatgjatë që do ta ndjekë nën cilindo regjim ligjor “evropian” që Kosova do ta përpilojë për këtë çështje.

Kisha propozon krijimin e një trupi të veçantë në kuadër të misionit ndërkombëtar pas-statusit, që ti mbikëqyrë aranzhmanet (implementimin e marveshjes) për mbrojtjen e saj, e që do të përfshinin përfaqësuesit e BE-së, UNESCO-s, qeverisë së Kosovës, qeverisë së Serbisë dhe Kishës Ortodokse. Ajo kërkon një trup të ngjashëm apo identik që të marrë përsipër edhe detyrimet e marra mbi vete nga Ministria e kulturës e Kosovës ndaj trashëgimisë shpirtërore, kulturore e historike të saj.²⁴⁸ Serbët argumentojnë se përpjekjet për të krijuar dhe menaxhuar “trashëgiminë kosovare” nëpërmjet ministrisë janë gllabërim nga ana e shqiptarëve dhe “de-serbizim”. Kisha kërkon “rrethimin me tela me gjemba” të “trashëgimisë kulturore serbe në Kosovë e Metohi” me mekanizma specialë të nevojshëm për disa vite: “Kosova nuk ka treguar që të jetë kulturë gjithëpërfshirëse dhe e integruar ende”.²⁴⁹ Mosparaqitja e manastirit madhështor mesjetar në panoramat dhe publikimet e komunës së Deçanit tregon se, sikur uji me vajin, vlerat shqiptare e serbe nuk mund të bëhen bashkë në Kosovën e sotme. Por, me mbrojtjen dhe përshtatjen e të dyja palëve, shqiptarët e Kosovës në fund mund të zgjerojnë ndjenjën e tyre të identitetit dhe të pranojnë si pjesë të tyre edhe trashëgiminë historike serbe e ortodokse, veçanërisht nën ndikimin e kriterëve për anëtarësim në BE.

për Kosovën në Lidhje me Bisedimet e Ardhsme për Statusin e Ardhsëm të Kosovës”.

²⁴² Intervistë e Grupit të Krizave, shkurt 2006.

²⁴³ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 1 shkurt 2006. Shih edhe intervistën e kryeministrit Kosumi në filmin e BIRN-it “A ka kush një plan?”, op. cit.

²⁴⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, Manastiri i Deçanit, 2 shkurt 2006.

²⁴⁵ Dokumenti i Parimeve Bazë, op. cit.

²⁴⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, Manastiri i Deçanit, 2 shkurt 2006.

²⁴⁷ Shih: “Gryka e Deçanit shpallet zonë e mbrojtur (speciale)”, komunikatë për shtyp e UNMIK-ut, 25 prill 2005, në dispozicion në: www.unmikonline.org

²⁴⁸ Dokumenti i Parimeve Bazë, op. cit.

²⁴⁹ Intervistë e Grupit të Krizave me atin Sava Janjiq, Manastiri i Deçanit, 2 shkurt 2006.

III. KONKLUZION

Edhe pse me kalimin e kohës procesi do të ec apo shtyhet drejt arbitrazhit dhe imponimit, bashkësia ndërkombëtare ende rrezikon që të marrë vendim për Kosovën nëpërmjet një procesi të gabuar. Një marrëveshje e negociuar do të ishte ideale, por duke e vënë këtë si cak bashkësia ndërkombëtare bën që arritja e një marrëveshjeje të jetë prioritet më i lartë se sa garantimi i stabilitetit afatgjatë si dhe zhvillimi i Kosovës dhe rajonit. Imponimi i një pakete për pavarësinë, nëse duhet të vijë deri tek kjo, do të ishte më mirë se sa të punohet në tejkalimin e dallimeve mes Prishtinës dhe Beogradit me një zgjidhje ambiguoze apo me ndonjë tjetër me të cilën zgjidhja e çështjeve kryesore do të lihej për më vonë: do të kërkonte një angazhim më të madh të diplomacisë për një kohë të shkurtër por do të sillte dobi në afat më të gjatë. Të lihet Kosova, për shembull, pa ulëse në OKB apo pa një ushtri të veten, sado të vogël, do ta ngujonte atë në nivel më të ulët të pranimit dhe njohjes, se sa fqinjët e saj dhe kështu do të nxitte jostabiliteti.

Sido që të jetë, kjo nuk e largon përgjegjësinë e shumicës shqiptare të Kosovës, që duhet së pari të ofrojë dhe negociojë një paketë të drejtave për serbët dhe pakicat tjera në së paku tri sfera. Kushtet e përfshirjes dhe përfaqësimit në institucionet qendrore, me aranzhmanet për përfshirje të vendeve amëtare relevante në fushat siç janë kultura e arsimit dhe ndoshta më shumë duhet të bëhet jo vetëm për serbët por edhe për turqit, boshnjakët dhe të tjerët. Ekipi i Ahtisaarit duhet të arrijë pëlqimin për një marrëveshje bazë për decentralizimin, i dalë nga programet e prezentuara nga Prishtina dhe Beogradi në bisedimet e Vjenës, duke i dhënë përparësi Prishtinës me kusht që marrëveshja të jetë negociuar edhe me serbët e Kosovës. Më pas, rezultati do të mund të implementohej nën mbikqyrjen ndërkombëtare për tri vite, ngjashëm si me Marrëveshjen e Ohrit. Negociatorët e Prishtinës do të duhej që menjëherë të fillojnë edhe negociatat e drejtpërdrejta me Kishën Ortodokse Serbe në Kosovë për një paketë aranzhmaneve për mbrojtjen e saj dhe lokaliteteve të saj. Vetëm kur të jenë bërë këta hapa themelor, Grupi i Kontakti, në mënyrë të sinkronizuar, duhet të marrë hapat formal drejt njohjes së pavarësisë së Kosovës.

Paketa e pavarësisë për Kosovën rreth të cilës do të pajtohet bashkësia ndërkombëtare duhet që synim të parë të ketë zhvillimin, me mbrojtje të duhur të pakicave, po të jetë nevoja, edhe me intervenimin e misionit ndërkombëtar. Përpilimi i marrëveshjes duhet të jetë rast për BE-në dhe vendet anëtare të saj në veçanti që të shtojnë vëmendjen dhe resurset që ia kushtojnë Ballkanit Perëndimor. Një asistencë zemërgjërë për arsimin dhe liberalizimin e regjimit të vizave është më se e nevojshme. BE-ja nuk duhet të përfundojë duke

shpenzuar më tepër në misionin e saj post-statusit në Kosovë se sa për fondet për para-anëtarësim për shtetin e ri.

Përveç mbrojtjes së të drejtave të pakicave në tërë Kosovën, është edhe një fushë tjetër ku bashkësia ndërkombëtare duhet të shqyrtojë mundësinë për të pasur një mision më robust: në Kosovën veriore, veçanërisht në Mitrovicë. Strukturat paralele serbe e kundërshtojnë autoritetin e UNMIK-ut dhe IPVQ-së atje. Ta lësh qeverinë e Kosovës së re të mundohet të inkorporojë veriun do të thotë të kërkoshe sherr. Një autoritet ndërkombëtar tranzicional në veri është përgjigjja e vetme e mençur. Siç ka argumentuar Grupi i Krizave në shtator 2005,²⁵⁰ ky autoritet duhet të implementojë me sukses edhe këtu aranzhmanet për decentralizimin, që të përfshijnë apo të përmbajë në vete komunën e re me shumicë serbe në veri të Mitrovicës dhe një varg të institucioneve të përbashkëta mbikëqyrëse. Rezultati do të ishte substanca e entitetit serb në veri pa kushtetutën e vetë formale.

Shqiptarët e Kosovës do ta pranojnë një pasues të UNMIK-ut që do të mbajë një shkallë të së drejtës së vetos apo me aq pushtet sa të anulojë vendimet e marra nga institucionet e reja, nëse paketa e përgjithshme quhet “pavarësi”, veçanërisht nëse ju premtohet ulësja në OKB.²⁵¹ Nëse kjo nuk pranohet aq lehtë dhe pranimi duhet të sigurohet me një rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, bashkësia ndërkombëtare megjithatë duhet të sigurohet se zgjidhja e saj e imponuar është e bazuar në një marrëveshje me shtetin e ri të Kosovës. Grupi i Krizave ka propozuar një mekanizëm të mundshëm për këtë marrëveshje në janar 2005: që prerogativat e misionit ndërkombëtar të përfshihen në kushtetutën e Kosovës, që duhet të vihet në referendum.²⁵² Kufizimet kohore ndoshta nuk do ta lejojnë që ky proces t’i paraprijë misionit, por një aranzhman i tillë do të mund të futej në kushtetutën që do të miratohej në referendum dikur gjatë vitit 2007.

Prishtinë/Beograd/Bruksel, 17 shkurt 2006

²⁵⁰ Shih raportin e Grupit të Krizave, *Zgjidhje për Mitrovicën, jo ndarje për Kosovën*, op. cit.

²⁵¹ Në novelën magjepse të Veton Surroit, *Fluturimi i fundit i Azem Berishës në Kështjellë* (Prishtinë, 2005), një përshkrim fiktiv i negociatave për statusin e Kosovës, i treguar nga këndi i disa pjesëmarrësve, çështja e ulëses në OKB, bëhet çështja e fundit e madhe.

²⁵² Shih raportin e Grupit të Krizave, *Kosova: Drejt statusit përfundimtar*, op. cit.

SHTOJCA A

HARTË E KOSOVËS

Kosova / Kosovo

Produced by




The boundaries and names displayed on this map do not imply official recognition by the United Nations

Source: NIMA, WEU

SHTOJCA B

HARTË E PJESËS VERIORE TË KOSOVËS



SHTOJCA C

PËRMBLEDHJE E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, partia politike e Ramush Haradinajt
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, degë e shtyllës së BE-së në UNMIK, që menaxhon apo privatizon asetet ekonomike të Kosovës
ART	Agjencioni Regullativ i Telekomunikacionit
B-92	TV, radio dhe vebsajt i pavarur informativ në Serbi
BIRN	Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese
BK TV	Televizioni i vëllezërve Kariq në Serbi
BE	Bashkimi Evropian
CDA	Aksioni për Bashkëpunim për Zhvillim
DCAF	Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura)
DS	“Demokratska Stranka” (Partia Demokratike) e kryetarit serb Tadiq
DSS	“Demokratska Stranka Srbije” (Partia Demokratike e Serbisë) e kryeministrit Koshtunica
ESBI	“Electricity Supply Board International”, kompania irlandeze që menaxhon me KEK-un
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
G-17+	Parti politike në Serbi, pjesë e koalicionit qeverisës
GDP	“Gross Domestic Production” (Prodhimi i përgjithshëm kombëtar)
HDZ	“Hrvatska Demokratska Zajednica” (Bashkësia Demokratike Kroate), partia në pushtet në Kroaci, e udhëhequr gjatë viteve 1990 nga Franjo Tuxhman
HPD	“Housing and Property Directorate” (Drejtoria për strehim dhe prona) ose HABITAT-i
IHPSO	Instituti për Hulumtime Strategjike dhe të Opinioneve Publik, OJQ kosovare e kryesuar nga Ramë Maraj, gjerësisht e parë si shërbim inteligjent i LDK-së
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vet-Qeverisjes
ISSR	“Internal Security Sector Review” (Shqyrtimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme)
KEK	Korporata Elektro-energjetike e Kosovës
KFOR	Forca paqëruajtëse në Kosovë, e udhëhequr nga NATO
KNS	Këshilli Nacional Serb, organizatë-ombrellë politike e serbëve të Kosovës
KS i OKN	Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
KTV	Televizioni Koha, pronë e Veton Surroit
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës, partia politike më e madhe në Kosovë, e kryesuar nga i ndjeri Presidenti Rugova
MSA	Marrëveshja për Stabilizim-Asociim
MUP	Ministria serbe e punëve të brendshme
NATO	Organizata e Traktatit Veri- Atlantik (Aleanca Veri- Atlantike)
NSH	Ndërmarrjet shoqërore
OJQ	Organizatë joqeveritare

OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ORA	Parti politike në Kosovë e udhëhequr nga Veton Surroi
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PDK	Partia Demokratike e Kosovës, pasardhësi kryesor politik i UÇK-së dhe partia kryesore opozitare, e udhëhequr nga Hashim Thaçi
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, post ky të cilin aktualisht e mban Soren Jessen-Petersen nga Danimarka
PTK	Posta dhe Telekomoni i Kosovës
PTT	Kompania shtetërore e Telekomunikacionit në Serbi
QKK	Qendra Koordinuese për Kosovë, e qeverisë së Serbisë dhe e qeverisë së Unionit Shtetëror Serbi e Mali i Zi
ROSU	Njësitë përkrahëse operacionale rajonale, njësi speciale të policisë, të vendosura në stacionet kryesore rajonale të SHPK-së
RTS	Radio-Televizioni i Serbisë
SHIK	Shërbimi Informativ (Inteligjent) i Kosovës, i afërt me partinë PDK
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
SPS	Partia Socialiste e Serbisë, ish-Partia Komuniste, e kryesuar gjatë viteve 1990 nga Slobodan Milosheviqi
SRS	“Srbska Radikalna Stranka”, (Partia Radikale Serbe), e kryesuar në vitet 1990 nga Vojislav Sheshel
STM	Procesi për përcjelljen e Procesit të Stabilizim-Asociimit
SWAT	“Special Weapons and Tactics” (Njësi speciale e policisë së SHBA-së)
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës, strukturë e mbrojtjes civile, trashëgimtare e UÇK-së
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Organizim Kulturor
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara
UNTAES	Administrata e përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Sllavoninë lindore (Kroaci, 1996-1998)
ZPSSP	Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (të OKB-së)